

Dhjetor
2022

Universiteti “Eqrem Çabej”

RAPORTI VJETOR PËR
VEPRIMTARINË MËSIMORE ,
SHKENCORE DHE
FINANCIARE

VITI AKADEMIK
2021-2022
GJIROKASTËR



A. SENATI AKADEMIK

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë është një universitet i Akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.55, datë 16.12.2021 “Për akreditimin e parë të institucionit të Arsimit të Lartë, Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë me kohëzgjatje 4- vjeçare dhe aktualisht jemi në proces për akreditimin e të gjitha programeve të studimit për ciklin e parë, ciklin e dytë .

Raporti vjetor për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe financiare i Universitetit “Eqrem Çabej”, për vitin 2021-2022, ka për qëllim të prezantoj një tablo të arritjeve, të dobësive si dhe të synimeve që ka për të ardhmen institucioni. Në hartimin e raportit janë marrë për bazë analiza dhe vlerësime:

- Të rezultateve të veprimtarisë së kryer nga organet drejtuese si të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit si dhe nga të gjitha njësitë përbërëse të Rektoratit;
- Të veprimtarisë së kryer prej njësive bazë dhe tre fakulteteve;
- Të raportit financiar të institucionit për 2021-2022.

Krahas, sa më sipër në hartimin e raportit një ndihmesë ka dhënë ballafaqimi i rezultateve me veprimtarinë e pasqyruar në raportet e viteve të kaluara, pasqyrimi i rezultateve të marra drejtpërdrejtë përmes monitorimeve të realizuara nga ana e Rektoratit dhe e gjithë strukturave drejtuese të universitetit si dhe pasqyrimi i objektivave konkrete që ka Universiteti “Eqrem Çabej” për të ardhmen.


Në hartimin e raportit janë marrë parasysh legjislacioni në fuqi, vkm-të dhe udhëzimet e MASR-së, politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga MASR ,si dhe tendencat e përgjithshme zhvillimore socio-ekonomike si ato rajonale ashtu dhe ato kombëtare e më gjerë.

Në realizimin e raportit duhet vlerësuar ndihmesa dhe bashkëpunimi i strukturave drejtuese, i të gjithë trupës akademike e personelit ndihmës, dhe në veçanti puna e personelit që bëri të mundur dokumentimin e tij.

1. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raport i vlerësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
Raporti specifikon strukturat përgjegjëse


Raporti i veprimtarisë mësimore e kërkimore të UGJ-së, është hartuar bazuar mbi raportet e fakulteteve përkatëse, si dhe në ndjekjen e përditësuar të realizimit të procesit mësimor e kërkimor, në vëzhgime, në analiza dhe kontrolle, si dhe në vlerësimin e dokumentacionit ligjor nga strukturat drejtuese të universitetit.

Struktura e përgjithshme e funksionimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.



Universiteti “Eqrem Çabej” në përbërjen e tij funksionon me tre fakultete (Njësi Kryesore) me përberjen si mëposhte:


FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE



Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë	13	5	9
Departamenti i Gjuhës	7	0	0
Departamenti i Letërsisë	7	0	0
Departamenti i Gjuheve të Huaja	12	2	1
Departamenti i Edukimit dhe metodologjise se mesimdhenies	9	10	3
Departamenti i Gjuhes, Letersise dhe Qyteterimit Grek	8	0	0
Total FESHSH	106	17	13

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë	8	2	3
Departamenti i Gjuhës	2	5	
Departamenti i Letërsisë	2	4	1
Departamenti i Gjuheve të Huaja	3	6	3
Departamenti i Edukimit dhe metodologjisë së mesimdhënisë	-	5	4
Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qyteterimit Grek	1	1	6
TOTAL FESHSH	16	23	17

FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS




Personel akademik i aktivizuar pranë FSHN

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Dep. Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe ushqimit	8	2	2
Dep. Matematikës Informatikës dhe Fizikës	10	5	2
Dep. Infermierisë	11	14	0
TOTAL FSHN	29	21	4

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Dep. Biologji Kimisë	5	2	1
Dep. Matematikës Informatikës dhe Fizikës	3	5	2
Dep. Infermierisë	1	3	7
TOTAL FSHN	9	10	10

FAKULTETIN EKONOMIK.



Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Departamenti i Kontabilitet-Finance	7	5	7
Departamenti i Administrimit Publik	7	7	0
Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit	7	3	0
Total FE	21	15	7

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Dep. i Kontabilitet-Financës		7	
Dep. i Administrimit Publik		5	2
Dep. i Politikave Ekonomike dhe Turizmit	1	3	3
TOTAL FE	1	15	5

Senati Akademik i Universitetit “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës, duke u mbështetur në arritjet e deritanishme dhe me synimin e çuarjen më para të këtyre arritjeve, ka përcaktuar për vitin 2021-2022 objektiva dhe detyra konkrete në drejtim të rritjes së cilësisë së veprimtarisë mësimore e shkencore. Mbi bazën e këtyre objektivave, të tre fakultetet dhe departamentet e Universitetit tonë, gjatë vitit 2021-2022, e kanë përqendruar punën mësimore e shkencore në drejtimet e mëposhtme:

- Ristrukturimi dhe përmirësimi i programeve mësimore për të gjitha ciklet dhe format e studimit, si edhe i dokumentacionit universitar në përputhje me standartet akademike, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Statutit dhe Rregullores së Universitetit.
- Përmirësimi dhe zbatimi i modeleve dhe i teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si faktor i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për rritjen e cilësisë dhe performancës së procesit mësimor.
- Realizimin e plotë me cilësi e performancë të procesit mësimor, duke e shoqëruar me përditësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së ligjëratave dhe seancave praktike me të rejtat bashkëkohore të shkencës.
- Realizimin në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale dhe praktikave në terren të studentëve.
- Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
- Rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivite shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në procese kërkimi dhe botimi i arritjeve në fushën e kërkimit brenda dhe jashtë vendit, në revista dhe organe prestigjioze.
- Plotësimin, përgatitjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të domosdoshëm për mbarrëvatjen e procesit mësimor dhe shkencor.

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi dhe infrastruktura e laboratorëve.
- Marrjen e masave për minimizimin deri në eliminim e problematikave të konstatuara.
- Sigurimin e asistencës së nevojshme për të gjithë studentët dhe sidomos për mbarëvatjen e tyre në lidhje me tregun e punës dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.
- Organizimin e ditëve të informimit me maturantët, në lidhje me programet e studimit të ofruara nga institucioni për vitin akademik 2021-2022.
- Një mbështetje e veprimtarisë mësimore i është dhënë edhe nga aktiviteti kërkimor-shkencor i stafit akademik. Tashmë ky staf me kualifikimin e tij në rritje të vazhdueshme po e shndërron universitetin gjithnjë e më shumë në qendër kërkimore-studimore për Rajonin e Jugut. Moria e studimeve të konkretizuara përmes artikujve, kumtesave e referateve etj. kanë sjell risi si në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies ashtu në drejtim të thellimit të njohurive në fusha të ndryshme të shkencës.
- Realizimi i plotë dhe me cilësi i procesit mësimor.
- Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
 - a) Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare në shumicën e tyre në mjedisin virtual, nëpërmjet lidhjeve online.
 - b) Botime në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.
- Plotësimi i saktë dhe në kohë i dokumentacionit përkatës për mbarëvatjen e procesit mësimor dhe shkencor.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi (akademik dhe ndihmës) dhe infrastruktura e laboratorëve për studentët ka qenë në vazhdimësi si çdo vit. Marrja e masave për minimizimin e problematikave të konstatuara.
- Sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentët e diplomuar, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.
- Bashkërendimi i veprimtarisë mësimore midis Njësisë Bazë të Fakultetit dhe të universitetit.
- Intensifikimi i bashkëpunimit midis Njësisë Bazë në funksion të veprimtarive kërkimore ndërdisiplinare.
- Sigurimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit.
- Në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit me universitete perëndimore, Universiteti i Gjirokastrës ka ndërmarrë veprime konkrete. Përfaqësues të UGJ-së kanë marrë pjesë në takimet bilaterale midis grupeve të Universitetit tonë dhe Universitetit të Janinës (Greqi). Në këto takime (në Gjirokastrë dhe në Janinë) janë hedhur propozime konkrete bashkëpunimi: në lidhje me mundësinë e çeljes së programeve të përbashkëta të studimit; në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale; në lidhje me përfshirjen e studentëve dhe pedagogëve të Universitetit të Gjirokastrës në studimet e ciklit të

dytë ose të tretë pranë Universitetit të Janinës, gjithashtu janë hedhur hapat e parë me disa universitete Italiane për programe të përbashkëta studimi në kuadër të marrëveshjeve kuadër që ne kemi.

- Gjatë vitit akademik 2021-2022, stafi akademik i UGJ-së synim kryesor kishte realizimin plotësisht me sukses të procesit mësimor, synim i cili kërkoi angazhimin maksimal të stafit akademik të njësive bazë të fakulteteve.
- Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në UGJ, synon të mbështetet në zhvillimin në rang lokal, rajonale dhe kombëtar si dhe rritjen e cilësisë së arsimit mbarëkombëtar.
- Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

Nisur nga sa më sipër, në analizën dhe vlerësimin e punës së stafit akademik u vërejt se:

- a. Është punuar për të realizuar me sukses semestrin e parë dhe të dytë, të vitit akademik 2021-2022.
- b. Janë rinovuar dhe përmirësuar programet mësimore, për të dyja ciklet e studimit dhe gjithashtu në programet profesionale.
- c. Janë modernizuar edhe më tej metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre të mëtejshme.
- d. Është bërë përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike (*seminareve, laboratoreve etj*), me të reja bashkëkohore të shkencës.
- e. Është bërë udhëheqja e tezave të diplomës të studentëve, të programeve të studimit “*Master në mësuesi në AMU*” dhe “*Master profesional*” dhe “*Master i Shkencave*” në fushat e studimit, që ofrohen nga fakultetet respektive.
- f. Është kryer me përkushtim dhe seriozitet mbarëvajtja e praktikave mësimore në terren dhe praktikave mësimore profesionale si dhe janë bërë përpjekje për të bërë vlerësime sa më reale të studentëve, duke marrë në konsideratë jo vetëm vlerësimin gjatë kryerjes së praktikës, por edhe duke organizuar testime konform programit të praktikave. Organizimi dhe zhvillimi i praktikave pedagogjike është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në fakultete. Në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionet ku kryhet praktika mësimore. Marrja përsipër nga ana e departamenteve, të hartimit të librave për shkollat në gjuhën amtare të sistemit parauniversitar, ka siguruar një komunikim dhe një marrëdhënie me produktive dhe në efektivitetin e kryerjes së praktikës pedagogjike, por gjatë këtij viti, si rezultat i situatave të krijuara, janë zbatuar programe të veçanta, në bazë të kushteve të krijuara.
- g. Në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira dhe korrekte bashkëpunimi me institucionet dhe subjektet shtetërore, ku kryhen praktikat mësimore profesionale. Edhe gjatë këtij viti, si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit me organizmat drejtues të arsimit parauniversitar në rang qyteti apo bashkish, ato u zhvilluan normalisht.

- h. Kontrollat, vëzhgimet, diskutimet me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj., në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (*realizimin e orëve të programit mësimor*) ashtu edhe në aspektin cilësor.
- i. Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore në fakultet është karakterizuar nga përpjekje intensive dhe të vazhdueshme, të stafit akademik për të instaluar metoda dhe forma bashkëkohore, për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve, në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje, aftësi dhe kompetenca, që do t'ju duhen për të siguruar punë në të ardhmen.
- j. Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.
- k. Janë hartuar oraret mësimore dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimeve.
- l. Njësitë bazë janë plotësuar me stafin akademik të nevojshëm duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente, në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
- m. Çdo pedagog ka hartuar programet e lëndëve, mbi bazën e planit mësimor dhe janë bërë përpjekje maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor.
- n. Është bërë përmirësimi i materialeve mësimore, të disiplinave përkatëse nga çdo pedagog.
- o. Është punuar nga të gjithë pedagogët në vazhdimësi, për t'i pajisur studentët me materiale didaktike të shkruara, si tekste apo cikël leksionesh, në formë dispensash, në lëndët përkatëse.

Në kuadrin e organizimit të procesit mësimor, janë bërë kontrole të herëpashershme mbi disiplinën në punë, cilësinë e mësimdhënies etj. Në fund të semestrave është bërë ballafaqimi i planeve kalendare me orët e realizuara nga pedagogët si dhe plani për plotësimin e orëve të përcaktuara, për arsye të ndryshme (*festa zyrtare, shëndeti etj*).

- Vazhdoi funksionimi normal i programeve të reja mësimore, të Ciklit të Dytë “*Master Profesional*” dhe “*Master i Shkencave*” :

1. “*në Shkenca Infermierore*”, nga Departamenti i Infermierise.

2. “*Financë Kontabilitet*”, nga Departamenti i Kontabilitet Financës.

- Detyra të rëndësishme kanë qënë riorganizimi i njësive bazë, rishpërndarja e ngarkesave mësimore, përgatitja e planeve mësimore, rishikimi i planeve ekzistuese, pasurimi dhe përsosja e programeve mësimore, janë hartuar dhe miratuar orari i mësimave për sistemin me kohë të plotë; struktura e vitit akademik; planet kalendare dhe programet mësimore të çdo disipline mësimore; shpërndarja e ngarkesës mësimore, për çdo pedagog, konform Udhëzimit 20, dt. 09.05.2018, të MASH-it.
- Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor në rang fakulteti, duke filluar që nga ditët e para të mësimin, i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementet e tij.
- Është organizuar kontroll i vazhdueshëm lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog dhe mbi programet përkatëse të lëndëve, për një ecuri sa më normale të të gjithë procesit mësimor.

- Në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve janë zhvilluar mbledhje të rregullta dhe me protokoll për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë stafit akademik, të departamenteve të FESHSH, FSHN dhe FE.
- Edhe gjatë këtij viti akademik, ka vijuar përmirësimi i mëtijshëm i zhvillimit të procesit mësimor, ku janë vërejtur përdorimi më i gjerë i metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve (*përdorimi i TIK në mësim*). Sigurisht, përmirësimi i metodave të mësimdhënies nuk do të ndalet këtu. Për këtë edhe stafi akademik i departamenteve, në përbërje të fakulteteve në UGJ-së në tërësi, është i vetëdijshëm dhe punon për gjetjen e mundësive përmirësuese, në vazhdimësi, si në përdorimin dhe perfeksionimin e teknikave të mësimdhënies, ashtu edhe në zbatimin e mënyrave bashkëkohore të mësimdhënies.
- Në zbatim të Rregullores dhe udhëzimeve, janë zhvilluar mbledhje dhe analiza në rang njësisht bazë, për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë. Në tërësi njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UGJ-së , janë të plotësuara me kuadrin e stafit akademik të nevojshëm. Ngarkesa e pedagogeve efektive, ka qënë brenda parametrave normale. Është organizuar kontroll i vazhdueshëm, lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog (*programet përkatëse të lëndëve, regjistrat, etj*) për një ecuri sa më normale të gjithë procesit mësimor dhe shkencor.
- Për lëndët mësimore, që zhvilluan studentët, informacionet e marra u mbështetën në ciklet e leksioneve në formë dispence apo tekstesh. Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i teknologjisë së informacionit, në procesin mësimor, angazhimi i studentëve në hartimin e eseve, detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike etj, në disiplina të ndryshme, përfshirja e një pjese të studentëve të vitit të fundit në kryerjen e mikrotezave etj. Por gjithashtu, duhet theksuar se ka vend edhe mundësi, që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies, të përmirësohen dhe të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë.
- U miratuan planet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore si dhe dokumentacioni përkatës, u azhornuan me kërkesat e udhëzimeve të MASH dhe Rregullores së Universitetit dhe Fakultetit: orari i mësimeve; struktura e vitit akademik; programet e lëndëve në përputhje me planet mësimore; shpërndarja e ngarkesës mësimore për çdo pedagog etj.
- Një nga problemet, që është parë me prioritet dhe i është kushtuar një vëmendje e veçantë gjatë këtij viti akademik, është problemi i organizimit të punës së njësisht kryesore të UGJ-së dhe Sektorit të Shërbimeve Studentore (Këshillimi i Karrierës dhe ALUMNI), në lidhje me ditët e informimit të maturantëve të shkollave të mesme, kryesisht të Rajonit Jugor, duke siguruar një njohje të programeve, stafeve si dhe mjediseve; laboreve, bibliotekave etj.

- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive është realizuar si gjatë gjithë vitit akademik, ashtu edhe në fund të semestrave. Një nga komponentët më të rëndësishëm të përmbushjes me sukses të aktivitetit mësimor janë provimet, ndaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur.

Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur, *për tre momente kryesore të këtij procesi:*

Së pari, janë njohur pedagogët si dhe studentët, me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve, për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, në njësitë bazë është bërë kujdes për hartimin e tezave, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar zhvillimi i provimeve në të gjithë ecurinë e tij:

- *është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora dhe mjedisi i zhvillimit të provimit;*
- *janë ngritur komisionet për çdo provim;*
- *është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit;*
- *është ndjekur procesi i sekretimit , afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.*

Krahas ecurisë normale, duhet theksuar se ende vërehen mangësi të tilla si:

- Numri dhe niveli i ulët i studentëve të regjistruar në programet e studimit.
- Ka raste të frekuentimit të ulët të leksioneve nga ana e studentëve (*në disa raste lidhen me faktorë socio-ekonomik të vet studentëve, por edhe të neglizhencës të ndonjë anëtari të stafit akademik, për të rritur motivimin dhe nxitjen, për pjesëmarrje sa më aktive të tyre në orën e mësimit*).
- Nuk mungojnë rastet kur përgatitja dhe aktivizimi i studentëve në seminare dhe laboratore lë shumë për të dëshiruar, gjë që përbën pengesë për pedagogët për shfrytëzimin efektiv të kohës prej tyre;
- Gjithashtu objektiv mbetet modernizimi me pajisje dhe materiale të nevojshme, në mbështetje të zhvillimit me cilësi të lartë dhe me standarte bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo i detyron pedagogët që në disa raste të jenë më tepër teorikë sesa praktikë.
- Rritja sasiore dhe cilësore e mësimdhënies, me staf akademik mësimdhënës si me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme.

-

❖ *Praktika profesionale (pedagogjike)*

Organizimi dhe zhvillimi i praktikave pedagogjike është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në të gjitha programet e studimit, që mbulohen nga Fakultetet. Gjatë të gjitha viteve të studimit, për të gjitha programet, në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionet ku kryhen praktikat mësimore profesionale.

Futja e sistemit të “mentoreve”, si një përvojë e fituar nga projektet e përbashkëta me universitetet perëndimore, prej disa vitesh ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e këtyre praktikave. Praktika mësimore vëzhguese (*afatshkurtër*), zhvillohet në shkollën 9-vjeçare, të arsimit të mesëm të ulët “Koto Hoxhi” dhe kopshtet Nr. 6 “Rreze Drite”, “Cicërimat”, Nr. 4 “Dallëndyshet”, kopshti Nr. 7 “Buzëqeshja” etj.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, praktika aktive dhe pasive janë zhvilluar pranë institucioneve përkatëse për çdo student.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, e ka përqendruar punën mësimore e shkencore në disa drejtime:

- Përmirësimi i planeve dhe programeve mësimore, për të gjitha ciklet dhe format e studimit, si edhe i dokumentacionit universitar, në përputhje me udhëzimet e MASR dhe ndryshimeve, që janë bërë në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
- Përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike me të reja bashkëkohore të shkencës.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale të studentëve.
- Kualifikimi i vazhdueshëm individual profesional dhe shkencor i stafit akademik.
- Pjesëmarrja në aktivitete kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore e fakulteteve, gjatë vitit akademik 2021-2022, është përqendruar në përdorimin e metodave e formave bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që iu duhen për të ardhmen, në përshtatje me kontekstet e reja, ku u përfshi i gjithë sistemi arsimor.

Edhe për këtë vit akademik, puna ka nisur nga aspekti organizativ i veprimtarisë mësimore.

Kështu, nga i gjithë stafi akademik i UGJ-së, janë hartuar:

- Programe të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.
- Dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MASR-së dhe rregulloreve të Universitetit, Fakulteteve dhe programeve përkatës të studimit.
- Oraret e mësimave dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimit.
- Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.
- Departamentet janë plotësuar me stafin akademik të nevojshëm me kohë të plotë.

Sipas monitorimeve të realizuara nga ana e Rektoratit dhe e gjithë strukturave drejtuese të Universitetit si dhe bazuar në raportet e analizave të realizuara në nivel departamentesh dhe fakultetesh, veprimtaria mësimore e Universitetit “Eqrem Çabej” gjatë vitit 2021-2022. në tërësi është karakterizuar nga përpjekje intensive e të vazhdueshme të stafit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që ju duhen për të ardhmen.

Natyrisht edhe për këtë vit akademik, puna ka nisur nga aspekti organizativ i veprimtarisë mësimore.

Kështu nga të gjitha departamentet dhe grupet kërkimore – mësimore të Universitetit evidentohen disa nga veprimtaritë kryesore të realizuara prej tyre, siç janë:

Procesi Mësimor:

Nga analizat e kryera në rang departamentesh dhe më pas përgatitja e raportit vjetor për vitin akademik në rang fakultetesh (FSH, FESHSH dhe FE) në lidhje me procesin mësimor vihet re:

- Realizimi i plotë i procesit mësimor të vitit akademik 2021-2022 dhe përgatitja për realizimin pa probleme të procesit mësimor të vitit akademik 2022-2023.
- Hartimi i planeve kalendare sipas planifikimit kohor dhe përmirësimi i programeve lëndore për disiplinat përkatëse.
- Përmirësimi i materialeve mësimore të disiplinave sipas çdo programi për të qenë koherent me kërkesat e teknologjisë së prezantimit dhe të informimit sipas përmbajtjes.
- Hartimi i leksioneve, cikël leksionesh, maket tekstesh mësimore dhe laboratorike bashkëkohore në informacion dhe konceptim.
- Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
 - Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare
 - Botime në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.
- Hartimi i programit lendor dhe përmirësimi i programeve mësimore.
- Plotësimi i saktë dhe në kohë, si dhe ruajtja e dokumentacionit përkatës për mbarëvatjen e procesit mësimor e shkencor.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi dhe infrastrukturës së sallave të mësimi për studentët.
- Marrja e masave për minimizimin e problematikave të konstatuara.
- Puna me planet e veprimtarisë kërkimore.
- Sigurimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione të administratës publike dhe sektorit privat.
- Dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MASR dhe rregulloreve të Universitetit, Fakulteteve dhe programeve përkatës të studimit.
- Oraret e mësimave dhe struktura e vitit akademik
- Realizimi konform rregullores i provimeve dhe formave të tjera të kontrollit.
- Rekrutimi prej departamenteve me stafin akademik të nevojshëm duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente, në përputhje me Rregulloren e Statutin e Universitetit.
- Aktivizimi për nevojat e departamenteve me pedagogë me kohe të pjesshme, të cilët zhvillojnë kryesisht orë seminaresh apo ndjekje të praktikave pedagogjike e profesionale të studentëve. etj.
- Sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentet e diplomuar, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe kualifikimin e mëtijshëm të tyre.

- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale dhe mësimore sipas specifikave të programit dhe grupeve mësimore.
- Çdo pedagog ka hartuar programet lëndore mbi bazën e planit dhe programit mësimor dhe janë bërë përpjekje maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor. Kujdes është treguar edhe për përditësimin e pasurimin e ligjëratave me të reja bashkëkohore të shkencës, si dhe për aplikimin e metodave rezultative për kontrollin e dijeve.
- Hartimi dhe përmirësimi i leksioneve, cikël leksionesh, maket teksesh mësimore dhe laboratorike bashkëkohore në informacion dhe konceptim.
- Riorganizimi, diskutimi dhe miratimi i programeve mësimore, kryesisht të lidhura me programin e ciklit të parë dhe të dytë në zbatim të ligjit të IAL-se dhe udhëzimeve të MASR-së.
- Hapja e programit të ri në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave në Kontabilitet Financë” në Shkencat Infermiore pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
- Modernizimi i metodave dhe teknologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre.
- Shtimi i literaturës profesionale e shkencore në bibliotekën e universitetit.

Gjithashtu përmirësime të programeve mësimore janë bërë pothuajse në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë e të dytë që Universiteti ynë ofron.

Problematikat dhe përmirësimet që nevojiten në aspektin e mësimdhënies mbeten detyrë do të pasqyrohen në Rregulloren e re të Universitetit dhe Statutin e ri të UGJ-së, ku do të pasqyrohen aktet e reja nënligjore.

Natyrisht funksionimi normal i programeve të ndryshme të studimit lidhet ngushtë me numrin e studentëve të regjistruar.

NGA ANALIZA NË DEPARTAMENTET E FE NË LIDHJE ME PROCESIN MËSIMOR

VIHET RE :

- Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit, gjatë vitit akademik 2021-2022, personeli akademik i FE-së ka realizuar një sërë detyrash mbështetur në Urdhërat dhe Udhëzimet e MAS dhe Rektoratit. Në tërësi strukturat drejtuese dhe stafi akademik i FE-së e ka përqendruar punën e vet, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve në realizimin e procesit të mësimdhënies, rinovimit të planeve aktuale mësimore, punës për hapjen e programeve të reja sipas kërkesave të tregut të punës si dhe janë bërë analiza dhe planifikime, në aspektin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e MAS, Rregullores së Brendshme të Universitetit dhe Fakultetit Ekonomik. Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor shkencor, në Fakultet, duke filluar që nga ditët e para të mësimi i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementët e tij. Kontrollat, vëzhgimet, bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj, në

vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (*realizimin e orëve të programit*) ashtu edhe në aspektin cilësor. Kështu, p.sh. në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i TIK në mësim, angazhimi i studentëve në hartimin e projekteve në lëndë të ndryshme etj. Sigurisht ka vend dhe mundësi, që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë.

- Për të nxitur një përgatitje sistematike gjithëvjetore, në programet e të gjitha lëndëve, që zhvillojnë anëtarët e personelit akademik të FE-së, është parashikuar, që studenti duhet të sigurojë 20 pikë, nga përgatitja në seminarët, që zhvillohen gjatë vitit.

Më konkretisht fokusi u përqëndrua në:

- Ripunimin e planeve lëndore, të programeve të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor.
- Rinovimin e planeve mësimore, për programet e studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional. Në bazë të këtij strukturimi, u rishikuan lëndët mësimore të këtyre planeve në bazë të legjislacionit në fuqi dhe ruajtja e raporteve të drejta të orëve mësimore .
- Rishikimi i planit mësimor të hartuar i ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor” në Financë – Kontabilitet.
- Përgatitjen e teksteve apo cikleve të leksioneve, në formë përmbledhje dispensash.
- Zgjerimin e bashkëpunimit institucional dhe të stafeve si me universitetet brenda, por gjithashtu edhe me ato jashtë vendit.
- Pjesëmarrjen e stafit akademik (*sipas njërive bazë*) të fakultetit, në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Pjesëmarrje e stafit akademik dhe studentëve në mobilitete të ndryshme në kuadër të projektit Erasmus +.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, stafi akademik i FE synim kryesor kishte realizimin plotësisht me sukses të procesit mësimor, synim i cili kërkoi angazhimin maksimal të stafit akademik të njësive bazë të fakultetit.

Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në FE, synon të mbështetë zhvillimin në rang lokal, rajonal dhe kombëtar si dhe rritjen e cilësisë së arsimit mbarëkombëtar.

Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

Nisur nga sa më sipër, në analizën dhe vlerësimin e punës së stafit akademik u vërejt se:

- Është punuar për të realizuar me sukses semestrin e parë dhe të dytë, të vitit akademik 2021-2022.
- Janë rinovuar dhe përmirësuar programet mësimore, për të dyja ciklet e studimit.

- Janë modernizuar edhe më tej metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre të mëtejshme.
- Është bërë përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike (*seminareve, laboratoreve etj*), me tekste bashkëkohore.
- Është kryer me përkushtim dhe seriozitet mbarëvajtja e praktikave profesionale si dhe janë bërë përpjekje për të bërë vlerësime sa më reale të studentëve, duke marrë në konsideratë jo vetëm vlerësimin gjatë kryerjes së praktikës, por edhe duke organizuar testime konform programit të praktikave. Organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në Fakultetin Ekonomik. Në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira dhe korrekte bashkëpunimi me institucionet apo subjektet private dhe shtetërore, ku kryhen praktikat mësimore profesionale. Edhe gjatë këtij viti, si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit me subjekte private dhe shtetërore në rang qyteti apo bashkish, ato u zhvilluan normalisht.
- Kontrollët, vëzhgimet, diskutimet me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj., në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (*realizimin e orëve të programit mësimor*) ashtu edhe në aspektin cilësor.
- Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore në fakultet është karakterizuar nga përpjekje intensive dhe të vazhdueshme, të stafit akademik për të instaluar metoda dhe forma bashkëkohore, për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve, në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje, aftësi dhe kompetenca, që do t'ju duhen për të siguruar punë në të ardhmen.
- Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.
- Janë hartuar oraret mësimore dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimeve.
- Njësitë bazë janë plotësuar me stafin akademik të nevojshëm duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente, në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
- Çdo pedagog ka hartuar programet e lëndëve, mbi bazën e planit mësimor dhe janë bërë përpjekje maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor.
- Është bërë përmirësimi i materialeve mësimore, të disiplinave përkatëse nga çdo pedagog.
- Është punuar nga të gjithë pedagogët në vazhdimësi, për t'i pajisur studentët me materiale didaktike të shkruara, si tekste apo cikël leksionesh, në formë dispensash, në lëndët përkatëse.

Në kuadrin e organizimit të procesit mësimor, janë bërë kontrole të herëpashershme mbi disiplinën në punë, cilësinë e mësimdhënies etj. Në fund të semestrave është bërë ballafaqimi i planeve kalendare me orët e realizuara nga pedagogët si dhe plani për plotësimin e orëve të parealizuara, për arsye të ndryshme (*festa zyrtare, shëndeti etj*).

- Detyra të rëndësishme kanë qënë rishpërndarja e ngarkesave mësimore, përgatitja e planeve mësimore, rishikimi i planeve ekzistuese, pasurimi dhe përsosja e programeve mësimore, janë hartuar

dhe miratuar orari i mësimave për sistemin me kohë të plotë; struktura e vitit akademik; planet kalendare dhe programet mësimore të çdo disipline mësimore; shpërndarja e ngarkesës mësimore, për çdo pedagog, konform Udhëzimit 20, dt. 09.05.2018, të MAS.

- Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor në rang fakulteti, duke filluar që nga ditët e para të mësimin, i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementet e tij.
- Është organizuar kontroll i vazhdueshëm lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog dhe mbi programet përkatëse të lëndëve, për një ecuri sa më normale të të gjithë procesit mësimor.
- Në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve janë zhvilluar mbledhje të rregullta dhe me protokoll për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë stafit akademik, të njësive bazë të FE-së.
- Edhe gjatë këtij viti akademik, ka vijuar përmirësimi i mëtejshëm i zhvillimit të procesit mësimor, ku janë vërejtur përdorimi më i gjerë i metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve (*përdorimi i TIK në mësim*). Sigurisht, përmirësimi i metodave të mësimdhënies nuk do të ndalet këtu. Për këtë edhe stafi akademik i njësive bazë, në përbërje të FE-së në tërësi, është i vetëdijshëm dhe punon për gjetjen e mundësive përmirësuese, në vazhdimësi, si në përdorimin dhe perfeksionimin e teknikave të mësimdhënies, ashtu edhe në zbatimin e mënyrave bashkëkohore të mësimdhënies.
- Në zbatim të Rregullores dhe udhëzimeve, janë zhvilluar mbledhje dhe analiza në rang njësish bazë, për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë. Në tërësi njësitë bazë, janë të plotësuara me kuadrin e stafit akademik të nevojshëm. Ngarkesa e pedagogeve efektive, ka qënë brenda parametrave normalë. Është organizuar kontroll i vazhdueshëm, lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog (*programet përkatëse të lëndëve, regjistrat, etj*) për një ecuri sa më normale të gjithë procesit mësimor dhe shkencor.
- Për lëndët mësimore, që zhvilluan studentët, informacionet e marra u mbështetën në ciklet e leksioneve në formë dispence apo tekstesh. Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i teknologjisë së informacionit, në procesin mësimor, angazhimi i studentëve në hartimin e projekteve të ndryshme, detyrave të kursit, punëve laboratorike etj, në disiplina të ndryshme, etj. Por gjithashtu, duhet theksuar se ka vend edhe mundësi, që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies, të përmirësohen dhe të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë.
- U miratuan planet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore si dhe dokumentacioni përkatës, u azhurnuan me kërkesat e udhëzimeve të MAS dhe Rregullores së Universitetit dhe Fakultetit: orari i

mësimeve; struktura e vitit akademik; programet e lëndëve në përputhje me planet mësimore; shpërndarja e ngarkesës mësimore për çdo pedagog etj.

- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive është realizuar si gjatë gjithë vitit akademik, ashtu edhe në fund të semestrave. Një nga komponentët më të rëndësishëm të përmbushjes me sukses të aktivitetit mësimor janë provimet, ndaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur.

Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur, *për tre momente kryesore të këtij procesi:*

Së pari, janë njohur pedagogët si dhe studentët, me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve, për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, në njësitë bazë është bërë kujdes për hartimin e tezave, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar zhvillimi i provimeve në të gjithë ecurinë e tij:

- është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora dhe mjedisi i zhvillimit të provimit;
- janë ngritur komisionet për çdo provim;
- është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit;
- është ndjekur procesi i sekretimit , afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.

Krahas ecurisë normale, duhet theksuar se ende vërehen mangësi të tilla si:

- Duhet të punohet më shumë për modernizimin me pajisje dhe materiale të nevojshme, në mbështetje të zhvillimit me cilësi të lartë dhe me standarte bashkëkohore të mësimdhënies.
- Rritja sasiore dhe cilësore e mësimdhënies, me staf akademik mësimdhënës si me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme.

❖ *Praktika profesionale*

Organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në të gjitha programet e studimit, që mbulon Fakulteti Ekonomik. Gjatë të gjitha viteve të studimit, për të gjitha programet, në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionet private dhe publike ku kryhen praktikat mësimore profesionale.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, praktikat profesionale u kryen normalish prane institucioneve publike dhe private me të cilat kemi marrëveshje.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 FE, e ka përqendruar punën mësimore e shkencore *në disa drejtime:*

- Përmirësimi i planeve dhe programeve mësimore, për të gjitha ciklet dhe format e studimit, si edhe i dokumentacionit universitar, në përputhje me udhëzimet e MAS dhe ndryshimeve, që janë bërë në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.

- Modernizimi i metodave dhe teknologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre.

- Përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike me tekste bashkëkohore.

- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale të studentëve.

-Kualifikimi i vazhdueshëm individual profesional dhe shkencor i stafit akademik.

-Pjesëmarrja në aktivitete kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore e FE-së, gjatë vitit akademik 2020-2021, është përqëndruar në përdorimin e metodave e formave bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që iu duhen për të ardhmen, në përshtatje me kontekstet e reja, ku u përfshi i gjithë sistemi arsimor.

Edhe për këtë vit akademik, puna ka nisur nga aspekti organizativ i veprimtarisë mësimore.

Kështu, nga i gjithë stafi akademik i FE-së, janë hartuar:

- Programe të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.

- Dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MAS-së dhe rregulloreve të Universitetit, Fakulteteve dhe programeve përkatës të studimit.

- Oraret e mësimave dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimit.

- Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.

- Njësitë bazë janë plotësuar me stafin akademik të nevojshëm me kohë të plotë.

- Për nevojat e njësive bazë janë aktivizuar edhe staf akademik me kohë të pjesshme me kontratë, të cilët zhvillojnë kryesisht orë seminaresh apo ndjekje të praktikave profesionale të studentëve. Shumica prej tyre kanë përfunduar studimet “*Master i Shkencave*”, në fushën e Ekonomisë dhe në specialitetet e tjera sipas njësive bazë.

- Çdo pedagog ka hartuar programet mësimore mbi bazën e planit dhe programit mësimor, për realizimin sasior e cilësor të procesit mësimor. Kujdes është treguar edhe për përditësimin dhe pasurimin e ligjëratave me tekste bashkëkohore.

Pozitiv është fakti se studentët në përgjithësi (*krahas literaturës së rekomanduar*) janë të pajisur me tekste universitare, ose cikël leksionesh, të përgatitur nga pedagogët, për disiplina të ndryshme përkatëse, sipas programit të studimit.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, u bë një punë serioze, duke angazhuar të gjithë stafin akademik të njësive bazë, për përmirësimin dhe ristrukturimin e programeve mësimore dhe e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, *për të gjitha programet e studimit:*

❖ *Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive*

Provimet janë një nga komponentët më të rëndësishëm të aktivitetit mësimor, prandaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e gjithë stafit të njësisë bazë. Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit

akademik 2021-2022, janë respektuar të gjitha udhëzimet e MAS dhe Rektoratit, proces ky, i cili përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur, *për tre momente kryesore të këtij procesi:*

Së pari, janë njohur pedagogët si dhe studentët me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, në njësinë bazë është bërë kujdes për hartimin e tezave, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, kontrolli dhe vlerësimi i njohurive, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar në të gjithë ecurinë e tij:

- është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit;
- janë ngritur komisionet për çdo provim;
- është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit të stafit akademik;
- është ndjekur procesi i sekretimit, afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.
- është hartuar struktura dhe oraret e zhvillimit të procesit mësimor në përshtatje me situatat e krijuara.

Organizimi i praktikave profesionale ne FE

Departamenti i Kontabilitet Financës

Mundësoi zhvillimin e praktikës profesionale për studentët e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Kontabilitet Financë në Institucionet e administratës publike në rajon si dhe subjektet e ndryshme private.

Praktika profesionale u krijoi mundësi studenteve që të zbatojnë konkretisht në praktike njohuritë që ata kanë marrë në teori gjatë zhvillimit të kurrikulave të ndryshme të kontabilitetit dhe finances dhe të aftësojë ata për tregun e punës. Studentet janë njohur me organizimin e njësive ekonomike konkrete, me dokumentacionin bazë kontabel, me sistemin e kontabilitetit që ata zbatojnë dhe organizimin e tij, informatizimin e kontabilitetit, përgatitje dhe e publikimin e pasqyrave financiare, me regjistrimin e tyre dhe me marrëdhëniet me organet tatimore etj.

Departamenti i Administrimit Publik dhe Departamenti Turizmit

Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Publik angazhoi 2 pedagogë për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikqyrjen e studentëve. Studentët e zhvilluan praktiken në mënyrë individuale apo në grupe sipas kërkesave të shprehura nga ana e tyre në institucione të ndryshme të administratës publike në rajon e kryesisht në Gjirokastrë si Bashki,

Këshilli i Qarkut, Prefekti i Qarkut, Drejtori Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Spitali Rajonal, Zyra e Punës, Drejtori Rajonale e Shëndetit Publik etj. Praktika profesionale u ka dhënë mundësi studentëve të vëzhgojnë dhe të ushtrohen në pozicione të ndryshme pranë administratës publike, të njohin mënyrën e organizimit të institucioneve publike, bazën ligjore ku mbështetin veprimtarinë, marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe të varësisë ndërmjet tyre, mënyrën e përdorimit të fondeve publike, përgjegjësinë në rast të shkeljeve të legjislacionit etj.

Provimet janë një nga komponentët më të rëndësishëm të aktivitetit mësimor, prandaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e të gjitha strukturave drejtuese të universitetit dhe e gjithë stafit akademik.

Në të gjitha sezonet e provimeve të vitit 2021-2022, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht me përgjegjësi dhe korrektësi, duke bërë kujdesin e duhur për tre momente kryesore të këtij procesi:

Së pari, pedagogët dhe studentët janë njohur në vijimësi me përmbajtjen e neneve të Rregullores së Universitetit, Fakultetit dhe programeve të studimit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, nga të gjitha departamentet është bërë kujdes për hartimin e tezave të provimeve me shkrim e me gojë, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, si aspekt më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar zhvillimi i provimeve në të gjithë ecurinë e tij: është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit; janë ngritur komisionet për çdo provim; është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit; është ndjekur procesi i sekretimit; afati i korrigjimit të provimeve me shkrim; dhënia dhe afishimi i rezultateve etj.

Gjatë këtyre monitorimeve rezulton se në përgjithësi të gjitha procedurat janë kryer në mënyrë korrekte dhe nuk ka patur kontenstime të rezultateve dhe parregullsi nga ana e stafit akademik.

Si konkluzion, gjatë vitit, akademik 2021-2022, u realizuan një sërë objektivash dhe detyrash si më poshtë vijon:

- në përfshirjen aktive të gjithë stafit akademik të FE-së, në kërkimin shkencor;
- në pjesëmarrjen e kënaqshme të stafit akademik, në projekte shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- në pjesëmarrjen e mirë të stafit akademik, në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- në përmbushjen e plotë të kualifikimit shkencor, sidomos për stafin që është në proces;
- në pajisjen e studentëve me tekste dhe materiale të shkruara, për disiplinat në të cilat ato mungojnë;
- në rritjen e aktivizimit të studentëve, në kërkimin-shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme në kuadër të Erasmus +, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore etj;

Tërheqja e studenëve në aktivitete të kërkimit shkencor, do t'i nxisë ata që edhe në të ardhmen e afërt, me fillimin e vitit të ri akademik, por edhe në të ardhmen e largët, përgjatë gjithë jetës, të jenë kërkues shkencor të denjë dhe të japin ndihmesën e tyre në probleme të shumta të fushës ekonomike, jo vetëm në nivel lokal, rajonal, por gjithashtu mbarëkombëtar.

Në Fakultetin Ekonomik, për realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore-kërkimore janë këto strukturat përgjegjëse :

- Dekani

- Përgjegjësat e njësive bazë

NGA ANALIZA NË DEPARTAMENTET E FSHN NË LIDHJE ME PROCESIN MËSIMOR

VIHET RE:

Fushat kryesore të veprimtarisë së FSHN gjatë vitit 2021-2022:

1. Vazhdimi i procesit të kualifikimit të stafit akademik në të gjitha nivelet dhe drejtimet.
 - c) Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare nënjë pjesë të mirë të tyre në mjedisin virtual, nëpërmjet lidhjeve online.
 - d) Botime në periodikë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.
2. Realizimi i plotë me cilësi dhe performancë i procesit mësimor.
3. Plotësimi i saktë dhe në kohë i dokumentacionit përkatës për mbarrëvajtjen e procesit mësimor dhe shkencor.
4. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga stafi (akademik dhe ndihmës) dhe infrastruktura e laboratoreve për studentët ka qenë në vazhdimësi si çdo vit. Nisur nga eksperiencia e zhvillimit online të procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, pedagogët kanë përdorur laboratorët virtualë, duke i mëshuar më shumë përgatitjes teorike, si një alternativë plotësuese jo e detyrueshme që i bashkangjitej kryerjes praktike në laborator të eksperimenteve.
5. Marrja e masave për minimizimin e problematikave të konstatuara.
6. Sigurimi i asistencës së nevojshme për të gjithë studentët e diplomuar, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre.
7. Bashkërendimi i veprimtarisë mësimore midis Njësive Bazë të Fakultetit dhe të universitetit.
8. Intensifikimi i bashkëpunimit midis Njësive Bazë në funksion të veprimtarive kërkimore ndërdisiplinare.
9. Sigurimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit.

10. Në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit me universitete perëndimore, Universiteti i Gjirokastrës ka ndërmarrë veprime konkrete. Në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit tonë dhe Universitetit të Janinës (Greqi), Dr. Anduela Qendro është duke zhvilluar një periudhe studimore pranë departamentit të kimise (Universiteti i Janinës) në fushën e “elektroforeza e proteinave ne gjak”.

Stafi akademik i FSHN është i aktivizuar në një masë të konsiderueshme mësimdhënieje, në tre programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional në mësuesi (që i mbulon FESHSH) përveç pesë programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor dhe një programi studimi të ciklit të dytë Master Profesional në Shkencat Infermierore qëe mbulon FSHN.

Personeli i punësuar në FSHN për vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga:

- 29** *punonjës personel akademik me kohë të plotë*
- 2** *punonjës personel administrativ,*
- 5** *punonjës personel ndihmës mësimor-shkencor.*

Në Tabelat më poshtë është shpjeguar që gjatë vitit akademik 2021-2022, pranë FSHN janë aktivizuar 29 personel akademik me kohë të plotë (i brendshëm), 25 personel akademik me kohë të pjesshme (padagogë të jashtëm) si dhe 4 personel akademik i ftuar.

Gjithashtu pasqyrohet numri i personelit akademik të brendshëm sipas kategorive, të cilët janë aktivizuar në secilën njësi bazë të FSHN gjatë vitit akademik 2021-2022.

Personel akademik i aktivizuar pranë FSHN

Njësia Bazë / Departamenti	Personel akademik i brendshëm	Personel akademik i jashtëm	Personel akademik i ftuar
Dep. i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	8	2	2
Dep. Matematikës Informatikës dhe Fizikës	10	5	2
Dep. Infermierisë	11	14	0
TOTAL FSHN	29	21	4

Personeli akademik i brendshëm Njësia Bazë / Departamenti	Kategoria Profesor	Kategoria Lektor	Kategoria Asistent Lektor
Dep. i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit	5	2	1
Dep. Matematikës Informatikës dhe Fizikës	3	5	2
Dep. Infermierisë	1	3	7
TOTAL FSHN	9	10	10

Realizimi i ngarkesës mësimore të normuar

Ngarkesa mësimore e normuar e stafit akademik në FSHN, në zbatim të Udhëzimit 29 datë 10.09.2018 të MASH, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, (ndryshuar me Udhëzimin 36 datë 23.11.2018, ndryshuar me Udhëzimin 37 datë 04.12.2018), është realizuar në përputhje me planet mësimore, të miratuara nga Senati akademik i UGj-së.

Ngarkesa mësimore është realizuar nga personeli akademik me kohë të plotë i FSHN dhe personeli akademik me kohë të pjesshme (si dhe pedagogët e ftuar) të aktivizuar pranë FSHN. Realizimi i ngarkesës është kryer sipas kriterëve të mëposhtme:

- *Plotësimi 100% i ngarkesës mësimore për të gjithë personelin akademik me kohë të plotë dhe tejkalimi i saj, në përputhje me udhëzimet e MAS.*
- *Aktivizimi i personelit akademik me kohë të pjesshme, në varësi të kualifikimit, për plotësimin e nevojave të departamenteve të FSHN, duke realizuar maksimalisht deri në 120 orë mësimore.*

Procesi Mësimor

Nga analiza në departamentet e FSHN në lidhje me procesin mësimor vihet re:

- Realizimi i plotë i procesit mësimor të vitit akademik 2021-2022 dhe përgatitja për realizimin pa probleme të procesit mësimor të vitit akademik 2022-2023.
- Hartimi i planeve kalendare sipas planifikimit kohor dhe përmirësimi i programeve lëndore për disiplinat përkatëse.
- Hartimi dhe miratimi i tezave të provimit.
- Përmirësimi i materialeve mësimore të disiplinave sipas çdo programi për të qenë koherent me kërkesat e teknologjisë së prezantimit dhe të informimit sipas përmbajtjes.
- Realizimi konform rregullores së provimeve dhe formave të tjera të kontrollit gjatë semestrave.

- Hartimi i leksioneve, cikël leksionesh, maket tekstesh mësimore dhe laboratorike bashkëkohore në informacion dhe konceptim.
- Realizimi në menyrë sa më cilësore të praktikave profesionale dhe mësimore sipas specifikave
- Organizimi i mesidhenies nga shumica e stafit akademik ka qene me forma atraktive dhe forma digjitale me informacion bashkëkohor te perdorura krahas metodave klasike. Sigurisht që nevoja për përmirësim është adekuate pasi numri i sallave, infrastruktura e tyre dhe mjetet digjitale nuk janë në lartësinë e kërkuar, dhe ulin efikasitetin e këtyre metodave mësimore. Kështu ndriçimi, ftohtësia, numri i kufizuar i projektorëve, mos ofrimi i shërbimit në cilësinë dhe kohën e duhur nga strukturat përkatëse të universitetit (në lidhje me numrin e lektoreve në të njëjten kohe) vështiresojnë performancën e mesidhenies.
- Per nje organizim sa me te mire te procesit mesimor gjate vitit 2022 u organizua nje rishikim total i bazes materiale laboratorike me qellim njohjen e gjendjes dhe per nje organizim sa me te mire te procesit te metejshem mesimor, me qellim shfrytezimin e bazes ekzistuese ne menyre sa efikase te mundhsme.

Problematika të hasura gjatë zhvillimit të procesit mësimor

- Niveli i ulët shkencor i studentëve (vështirësia e lëndëve të shkencave natyrore, etj.).
- Frekuentimi jo në masë të lartë i seancave tëleksioneve nga ana e studentëve. Perpos kesaj, mjediset ne periudha kohore të motit ekstrem, nuk ofrojne kushte te pershtashme per pjesmarrje ne mesim. Por dhe stafi ne disa raste eshte treguar jo ekzigjent ne cilesimin e ores se mesimit si te shenjte dhe se çdo student qe paraqitet kerkon dhe jemi te detyruar ti ofrojme dije cilesore.
- Përgatitja dhe aktivizimi i studentëve në seminare e laboratore nuk është në nivelin e dëshiruar, gjë që e bën punën e pedagogëve jo shumë efektive dhe pengon shfrytëzimin efektiv të kohës prej tyre;
- Gjithashtu problem i mprehtë që është agravuar së tepërmi vitet e fundit është mungesa apo amortizimi i paisjeve laboratorike. Kjo i detyron pedagogët të ndërtojnë seanca laboratorike më fleksibël.
- Procesi mesimor ne te gjitha programet qe mbulon apo zhvillon mesim stafi i fakultetit ne teresi eshte monitoruar. Ne teresi rezulton se procesi mesimor eshte zhvilluar normalisht, rastet e mos zhvillimit te mesimit rezultojne kryesisht ne oret e para ku per shkak te ftohtit studentet nuk paraqiten, dhe me rralle ka ndodhur per arsye shendetsore ose familjare te pedagogeve dhe ku mundesia e zevendesimit te orarit teknikisht ka qene e pamundur. Persos ketij fakti janë marre masa qe oret e humbura te zevendesohen, sidomos labororet dhe ne kete kuader kemi gjetur mirekuptimin e studenteve te cilet kane qene te gatshem dhe per te cilet duhet te shprehim falenderim.

Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive

Nga analiza në departamentet e FSHN vihet re:

- Hartimi dhe miratimi i tezave të provimit në përputhje me rregulloren e UGJ.
- Realizimi i provimeve konform rregullores së FSHN dhe UGJ (tezat me disa variante, përfshirja në vlerësimin përfundimtar e vlerësimit të vazhduar, fletoret e sekretuara, vlerësimi analitik, orari i provimit, plotësimi i procesverbaleve dhe hedhja e notave në sistem) dhe formave të tjera të kontrollit. Janë hasur disa problematika teknike që lidhen me sa më sipër. Në mënyrë të veçantë problematika janë hasur në funksionimin e librezës elektronike të notave të studentit. Pavarësisht trajnimeve të organizuara për përdorimin e platformës Pitagora, edhe për arsye teknike të funksionimit, pedagogët, studentët dhe sekretaria mësimore e kanë pasur të vështirë të adaptohen 100%.

Problematika të hasura gjatë kontrollit dhe vlerësimit të njohurive

- Problem deri diku ka qenë komunikimi i rezultatit të provimit të studentët dhe hedhja e notave në sistem.
- Komisioni i provimit në pak raste ka përdorur edhe vlerësimin total ku nuk evidentohet saktë vlerësimi analitik i studentit për çdo pyetje.
- Nga analiza pamore e procesverbaleve rezulton se ka një nivel poshtë pritshmërive, të përgatitjes së studentëve në çfarëdolloj forme vlerësimi.

Masat për fillimin e vitit akademik 2022-2023

- Është njohur stafi i departamentit me udhëzimet e ministrisë dhe institucionit tonë për fillimin dhe mbarëvatjen e procesit mësimor.
- Bazuar në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë” është kryer fillimisht një ndarje paraprake e ngarkesës mësimore. Ka qenë e pamundur të bëhej një tabelë përfundimtare për ngarkesën mësimore të personelit akademik ndërsa nuk kishte përfunduar procesi i regjistrimit të studentëve në vitet e para në programet e studimit të ciklit të dytë në FSHN duke mospasur një vendim final për funksionimin ose mos-funksionimin për këtë vit akademik të disa viteve të para të programeve të studimit të mësuesisë si dhe për programet e studimit të ciklit të dytë.
- Ndarja e ngarkesës mësimore ka përfunduar pas mbylljes së afateve të regjistrimit të studentëve në gjithë programet e studimit të FSHN-së.

- Është punuar për hartimin e planeve kalendare përkatëse, programeve të rinovuara konform planeve mësimore që zbatohen në secilin program studimi dhe marrëveshjet e normimit vjetor të punës së stafit akademik.
- Vazhdon puna e stafeve akademike për të mundësuar sigurimin e bazës materiale shkencore të shkruar për studentët e secilit program studimi.
- Departamenti ka siguruar mbulimin e plote të disiplinave mësimore që zhvillohen gjatë këtij viti akademik duke mbuluar disiplinat sipas rendesise dhe kualifikimit të stafit akademik.
- Vazhdon puna e secilit pedagog për të mundësuar sigurimin e bazës materiale didaktike (lexione) për secilin student në format e ndryshme të mundshme.

Me qëllim rritjen e performancës së FSHN në përmbajtje, një punë e mirë është bërë nga personeli akademik dhe ndihmës, përgjegjësat e njësive bazë dhe grupeve mësimore në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programeve mësimore që ofron Njësia Kryesore.

Meqënëse u bënë disa vite që numri dhe cilësia e studentëve që aplikojnë për studime në programet që ofron FSHN ka rënë, politika jonë ka synuar në informimin masiv për mundësitë që ofrojnë programet tona, gadishmërinë dhe cilësinë e stafit, lehtësirat proceduriale që ofrojmë në rast integrimi programesh, kur vijnë nga degë të përafërta dhe që kanë ndërprerë studimet, si dhe fleksibiliteti i zhvillimit të programit përkatës.

Për të mundësuar vijueshmëri në sasi dhe cilësi, vëmendja e punës së stafit ka qenë informimi dhe marrëdhënia me studentët, ku që në fillim të vitit akademik janë njohur me planin mësimor, programin e studimit, rregulloren e departamentit, Universitetit, statutin dhe të gjithë elementet teknike të mbarëvatjes së procesit mësimor.

Problematika të hasura gjatë marrjes së masave për fillimin e vitit akademik 2022-2023

- Në disa raste në planet kalendare të disiplinave të caktuara ka mospërputhje kohore midis temave të leksioneve dhe seminareve/laboratoreve.
- Rënia e numrit të orëve për shkak të numrit shumë të vogël të studentëve (mos-hapja vitet e fundit e disa programeve të studimit të mësuesisë)

Zhvillimi i praktikave

a) Praktika mësimore (Departamenti i Infermierisë)

Gjatë vitit akademik 2021-2022 studentet kane zhvilluar praktiken profesionale ne ambjentet e spitalit rajonal “Omer Nishani” dhe ne laboratorët e departamentit, nen mbikqyrjen e mentoreve, me të cilët është vendosur një raport mjaft komunikues dhe vlen të vlerësohet angazhimi i tyre për kryerjen me efikasitet nga ana e studentëve të praktikave mësimore..

b) Praktika profesionale (Dep. e Matematikës Informatikës dhe Fizikës dhe Dep. Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit)

Gjatë vitit akademik 2020-2021 në lidhje me studentët e ciklit të dytë Master në mësuesi që zhvillojnë praktikë profesionale është planifikuar shpërndarja nëpër Drejtoritë Arsimore rajonale përkatëse, janë pajisur me materialet e nevojshme që sigurojnë mbarëvatje të procesit pedagogjik, për mundësi kontrolli për rezultatet e punës së tyre. Një element pozitiv në këtë drejtim ka qenë bashkëpunimi me drejtuesit e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Praktikën profesionale studentët e zhvilluan pranë shkollave 9 vjeçare, nën drejtimin e pedagogeve metodistë të Departamentit. Në përfundim të praktikës profesionale u realizua dhe vlerësimi i ecursisë dhe rezultateve të studentëve.

Nje pune te mire dhe raport mjaft komunikues eshte ndertuar me mesuesit “mentor” per te cilet duhet vleresuar efikasiteti me studentet tane. Praktikisht praktikat mesimore pasive me studentët e programit të ciklit të dytë Master në Mësuesi Biologj Kimi, janë zhvilluar me mësuesit mentorë: Vezir Mamo (metodiste kimie Shkolla Koto Hoxhi) dhe Merita Late (metodiste biologjie Shkolla Urani Rumbo)

c) Praktika në terren (Departamenti i Dep. Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit)

Gjate vitit 2022 jane zhvilluar praktika ne terren nga studentet e deges Biologj-Kimi (Bachelor), ku është synuar (në kushtet e vështira të mundësisë për të lëvizur), të merret nje rezultat sa më i kënaqshëm. Në tërësi praktika në terren është realizuar brenda rrethit.

Në tërësi stafi i FSHN-së ka qenë bashkëpunues në zhvillimin e procesit mësimor. Kjo ka konsistuar në realizimin e detyrave personale të ngarkuara për çështje të veprimtarisë së Fakultetit në këtë fushë. Elementet e veprimtarisë së tyre ditore jane konkretizuar me korrektesi, dhe per rastet e veçanta jane marre masa sikurse keshillime dhe qortime.

Problematika të hasura gjatë zhvillimit të praktikave

a) Praktika mësimore (Departamenti i Infermierisë)

- Baza materiale e pamjaftueshme në spital dhe qendra shëndetësore nuk mundëson zhvillimin real praktik të disa temave në disa disiplina të caktuara.
- Nëplotësim të praktikës së zhvilluar pranë Spitalit Rajonal apo qendrave shëndetësore disa tema specifike tëorëvetë praktikave profesionale të Infermierisë të parashikuara, janë zhvilluar duke ndarë me studentët online materialin teorik të shkruar apo materiale multimediale.

b) Praktika profesionale (Dep. e Matematikës Informatikës dhe Fizikës si dhe Dep. Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit)

- Stafi akademik i FSHN ka vështirësi në ndjekjen e praktikës profesionale afatgjatë për arsye të angazhimit në universitet me mësimdhënien e disiplinave të tjera.

c) Praktika në terren (Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit)

- Financimi i pamjaftueshëm për udhëtime dhe bazë materiale ka vështirësuar zhvillimin me cilësi të lartë të praktikave në terren.
- Baza materiale e amortizuar nuk lejon zhvillimin me cilësinë e pretenduar të këtyre praktikave.

Detyrat për të ardhmen

- Vazhdimësia dhe përmirësimi i komunikimit dhe informimit të studentëve që diplomohen në programet e studimit pranë fakultetit tonë.
- Inkurajimi dhe shtimi i numrit të pedagogëve të FSHN që përfshihen në projekte kërkimore me partnerë shqiptarë dhe të huaj. Në këtë aspekt vëmendje duhet të tregohet në përfshirjen edhe të studentëve në aktivitete specifike të projekteve. Gjithashtu përfshirja në projekte mundëson sigurimin e financimeve për aktivitete të ndryshme mësimore dhe pasurimin e bazës materiale laboratorike.
- Të vazhdohet puna për përdorimin në vazhdimësi të burimeve të informacionit sa më bashkëkohorë dhe atraktive, sidomos në lëndët përshkruese. Kjo merr peshë të veçantë në kuadrin e mësimdhënies moderne të përzier; në auditor (e detyrueshme) dhe online nëpërmjet platformave kompjuterike (fakultative).
- Të insistohet për sigurimin e një procesi mësimor sa më atraktiv me bazë didaktike sa më bashkëkohore dhe shkencore, megjithëse vazhdon vështirësia e sigurimit të literaturës së duhur konform kërkesave të

stafit nëpërmjet fondit të akorduar nga universiteti, për të cilin duhet të investojmë akoma më shumë në të ardhmen.

- Modernizimi drejt dixhitalizimit i metodave mësimdhënëse. Kjo vlen veçanërisht në laboratorët e fizikës të cilët në pamundësi për tu pajisur me dispozitivë modernë e të shtrenjtë, mund të zhvillohen me cilësi të lartë duke shfrytëzuar laboratorët virtualë.
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme në lidhje me përdorimin e platformave të mësimi online, të cilat tashmë po bëhen mjete shtesëndihmëse në procesin mësimdhënës të realizuar në auditor.
- Përforcimi i punës në aspektin e tretë të veprimtarisë universitare: ndërveprimi me biznesin dhe komunitetin përveç dy aspekteve të tjera: mësimdhënies dhe kërkimit.

NGA ANALIZA NË DEPARTAMENTET E FESHSH NË LIDHJE ME PROCESIN MËSIMOR

VIHET RE SE:

Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit, gjatë vitit akademik 2021-2022, personeli akademik i FESHSH-së ka realizuar një sërë detyrash mbështetur në Urdhërat dhe Udhëzimet e MASH dhe Rektoratit. Në tërësi strukturat drejtuese dhe stafi akademik i FESHSH-së e ka përqendruar punën e vet, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve në realizimin e procesit të mësimdhënies, rinovimit të planeve aktuale mësimore, hapjes së planeve të reja, sipas kërkesave të punës si dhe janë bërë analiza dhe planifikime, në aspektin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e MASR dhe Rregullores së Brendshme të Universitetit dhe Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor shkencor, në Fakultet, duke filluar që nga ditët e para të mësimi i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementët e tij. Kontrollët, vëzhgimet, bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj, në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (*realizimin e orëve të programit*) ashtu edhe në aspektin cilësor. Kështu, p.sh. në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i TIK në mësim, angazhimi i studentëve në hartimin e eseve në lëndë të ndryshme, përfshirja e të gjithë studentëve të vitit të fundit në kryerjen e mikrotezave etj. Sigurisht ka vend dhe mundësi, që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë. Në kuadrin e përdorimit të platformave të reja të mësimdhënies *online*, stafi akademik ka kryer mësimdhënien me format e ofruara, duke e përmirësuar atë nga koha në kohë, përgjatë semestrit të dytë, duke i kushtuar vëmendje të shtuar, tërheqjes më të madhe të mendimit kritik dhe të pavarur të studentëve, për çështje të ndryshme në debate dhe diskutime gjatë seminareve.

Departamenti u plotësua me stafin e nevojshëm akademik duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente, në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e Universitetit. Për nevojat e departamentit janë aktivizuar dy pedagogë me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar dhe një pedagog i ftuar të cilët zhvillojnë lëndë të posaçme në degën e Bachelor në Gjuhë angleze dhe Master në mësuesi në Gjuhë angleze si dhe lëndën e gjuhës së huaj nëpër degë të ndryshme të universitetit.

U bë shpërndarja e lëndëve mësimore si dhe përcaktimi i mësimdhënies së normuar vjetore.

U hartuan oraret e mësimave dhe struktura e vitit akademik për të dy ciklet e studimeve.

Çdo pedagog ka hartuar planet lëndore mbi bazën programit mësimor dhe janë bërë përpjekje maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor.

Është punuar nga të gjithë pedagogët në vazhdimësi për t'i pajisur studentët me materiale të shkruara, si tekste apo cikël leksionesh në formë dispensash në lëndët përkatëse.

Janë bërë përpjekje intensive e të vazhdueshme të stafit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që iu duhen për të ardhmen. Për këtë qëllim shërben edhe laboratorit me kabina dhe kufje personale për çdo student si dhe pajisja e laboratorit me një projektor për modernizimin e mësimdhënies.

Për sa i përket studentëve të vitit të parë Bachelor në Gjuhë angleze, gjatë vitit akademik 2021-2022, në Programin e Studimit Bachelor në Gjuhë angleze viti I vërehet një numër i ulët studentësh ashtu si edhe një vit më parë, 6 studentë, ndërsa në Programin e përbashkët të studimit me Departamentin e Historisë Bachelor në Histori dhe gjuhë italiane u vu re mungesa e prurjeve studentore për të dytin vit radhazi gjë që çon në rrezikimin e mbylljes së këtij Programi studimi. Programi i studimit Bachelor në Histori dhe gjuhë italiane vazhdon të jetë i mbyllur për arsye se nuk është aktiv prej disa vitesh radhazi. Mendojmë se duhen shtuar përpjekjet për rekrutimin e maturantëve të ardhshëm duke gjetur metoda më bindëse dhe më tërheqëse për këta maturantë. Ndërkohë ka nisur normalisht viti II dhe III i Bachelor-it në gjuhë angleze. Nga bisedat me pedagogë që japin mësim në vitin e parë, në sajë të rritjes së kufirit të notës minimale të shkollës së mesme në 7.5, vërehet rritje e cilësisë së studentëve të ardhur, por interesim i paktë për njohuri nga ana e tyre. Për sa i përket studentëve të semestrit të parë Master në mësuesi, gjatë vitit akademik 2021-2022, në Programin e Studimit Master në Gjuhë angleze vërehet një numër më i ulët prurjesh studentore (13 studentë), por që është i kënaqshëm duke patur parasysh numrin e ulët të studentëve në Bachelor në Gjuhë angleze në Universitetin tonë. Kjo vjen jo vetëm nga interesimi i shumicës së studentëve diplomantë të Bachelorit në Gjuhë angleze nga Universitetit ynë për vazhdimin e studimeve Master, por edhe nga interesimi i disa studentëve diplomantë të Bachelor-it nga Filiali i Sarandës apo nga Universiteti i Vlorës për vazhdimin e studimeve Master në Universitetin tonë. Ndërsa në Programin e studimit Master në Gjuhë italiane u vu re mungesa e prurjeve gjë që ka çuar në moshapjen e vitit të parë të kësaj dege për vitin e dytë radhazi gjë që çon në rrezikimin e mbylljes së këtij Programi studimi. Ndërkohë ka nisur normalisht viti i dytë i studimeve Master në Gjuhë angleze me gjithsej 14 studentë. Natyra e mësimdhënies gjatë vitit akademik 2021-2022 iu kthye normalitetit me prani fizike nëpër auditore ndryshe nga

vitet e pandemisë. Që në semestrin e parë mësimdhënia filloi dhe vazhdoi me prani fizike gjatë gjithë vitit shkollor. Ecuria e procesit mësimor ka qenë e kënaqshme dhe u finalizua me provimet e të tria sesioneve, të dimrit, verës dhe vjeshtës. Provimet janë një nga komponentët më të rëndësishëm të aktivitetit mësimor, prandaj dhe u është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e gjithë stafit të departamentit. Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik 2021-2022, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht me prani fizike në ambientet e universitetit. Gjatë periudhës së provimeve u tregua kujdesi i duhur për tri momente kryesore të këtij procesi: *Së pari*, janë njohur pedagogët si dhe studentët me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj.

Së dyti, në departament është bërë kujdes për hartimin e tezave që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, është planifikuar dhe monitoruar zhvillimi i provimeve në të gjithë ecurinë e tij:

- është hartuar në kohë kalendari i provimeve ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit.
- janë ngritur komisionet për çdo provim.
- është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit të tezave të provimit.
- është ndjekur procesi i sekretimit, afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.

Për të nxitur një përgatitje sistematike gjithëvjete, në programet e të gjitha lëndëve që zhvillojnë pedagogët e departamentit tonë është parashikuar që studenti duhet të sigurojë 20 pikë nga përgatitja në seminarët që zhvillohen gjatë vitit.

Krahas ecurisë normale, duhet theksuar se ende vërehen mangësi të tilla si:

- vonesa në fillimin e provimeve.
- dhënia me vonesë e rezultateve të provimit.

Është bërë udhëheqja e tezave të diplomës të studentëve të programeve të studimit Master në Mësuesi për AMU në Gjuhë angleze.

Janë bërë përpjekje për një mbarëvajtje sa më të mirë të praktikave dhe për vlerësimin sa më real të studentëve duke u mbështetur jo vetëm në vlerësimin e mësuesit mentor të shkollës ku zhvillohet praktika aktive, por edhe të pedagogut tutor dhe përgatitjes teorike në lëndën e metodikës.

Në përgjithësi, mund të themi se kontrollet, vëzhgimet, bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj. në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor.

Është realizuar me sukses semestri i parë dhe i dytë i viti akademik 2021-2022.

Janë modernizuar metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre. Nga studentët e Departamentit tonë kanë fituar bursa mobiliteti për periudhën e verës në Amerikë në programin *Ëork and Travel* 3 studentë: 2 nga programi Bachelor Gjuhës angleze dhe 1 nga Programi Master në gjuhë angleze.

Për sa i përket transferimit të studentëve, nuk pati studentë të larguar nga Departamenti ynë, por pati ardhje të 1 studenteje të transferuar nga Universiteti i Tiranës.

Në Programin e ciklit të dytë Master në mësuesi në gjuhë angleze pati interesim nga 4 studentë të ardhur nga Programe studimi të gjuhës angleze të Universitetit të Vlorës, të Universitetit të Tiranës dhe të filialit Sarandë të Universitetit të Tiranës për Master të dytë në Gjuhë angleze.

Në lidhje me cilësinë e studentëve, është për t'u theksuar se studentët e departamentit tonë kanë rezultate të kënaqshme, dhe kjo ndodh kryesisht për arsye të nivelit të tyre të mëparshëm nga shkollat e mesme dhe jo për shkak të studimit të mjaftueshëm gjatë studimeve universitare. Ajo që vihet re është përpjekja e tyre finale gjatë provimeve të diplomimit ku ky nivel rritet kënaqshëm.

Në lidhje me numrin e studentëve të diplomuar në të dy ciklet e studimit mund të themi se rezultatet janë të kënaqshme brenda sesioneve të diplomimit.

Kështu, për ciklin e parë të studimeve Bachelor në Gjuhë angleze, viti III, në sesionin e provimeve të verës u diplomuan 4 studentë, ndërsa në sezonin e vjeshtës 2 studentë. Për ciklin e dytë të studimeve Master në Gjuhë angleze, viti II, në sezonin e provimeve të verës u diplomuan 6 studentë, në sesionin e vjeshtës 6 studentë të tjerë nga 14 studentët e grupit. Dy studentët nuk u paraqitën as në sesionin e vjeshtës. Ndërsa për ciklin e dytë të studimeve Master në Gjuhë italiane, viti II, në sezonin e provimeve të vjeshtës u diplomua një student i prapambetur.

Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore e Departamentit gjatë vitit 2021-2022, është karakterizuar nga përpjekje intensive e të vazhdueshme të stafit akademik për të instaluar metoda e forma bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që iu duhen për të ardhmen.

Një pedagog fitoi gradën shkencor Dr dhe dy pedagogë fituan titullin akademik Profesor i asociuar, ndërsa pedagogë të tjerë janë në proces të fitimit të gradave dhe titujve.

Me fillimin e vitit të ri akademik u hartuan:

- a.** Planet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore si dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimeve të MASH-IT dhe Rregullores së Universitetit dhe Fakultetit: Orari i mësimave; Struktura e vitit akademik; Planet kalendare dhe Programet e çdo disipline mësimore; Shpërndarja e ngarkesës mësimore për çdo pedagog etj.
- b.** U ripunuan planet lëndore të programit të studimit Cikli i Bachelor
- c.** U hartuan planet lëndore për Masterin në Gj-L shqipe me shtrirje kohore dy vite mësimore (120 ECTS).
- d.** U punuan planet lëndore për programin dyvjeçar të studimit “Librar dhe bibliotekar”, i cili mori miratimin nga Ministria e Arsimit në korrik 2019.
- e.** Gjithashtu, për pjesën më të madhe të këtyre disiplinave për studenët janë përgatitur ciklet e leksioneve.
- f.** i është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e gjithë stafit të departamentit.

1. Planet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore si dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimeve të MASH dhe Rregullores së Universitetit dhe Fakultetit, orari i mësimave, strukturat mësimore, planet kalendar dhe programet e çdo disiplinë mësimore, shpërndarja e ngarkesës mësimore për çdo pedagog etj.
 2. U ripunuan planet lëndore të programit të studimit Cikli I Bachelor
 3. U ripunuan planet lëndorë të Masterit në Gj-l shqipe në AMU me shtrirje kohore dy vite mësimore (120 ECTS)
 4. U ripanë planet lëndore të programit dyvjeçar të studimit “Librar dhe bibliotekar”.
 5. Gjithashtu, për pjesën më të madhe të këtyre disiplinave për studenët janë përgatitur tekstet apo ciklet e leksioneve në formë përmbledhje dispensash.
- a. **Së pari**, janë njohur pedagogët si dhe studentët me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.
 - b. **Së dyti**, për sa i përket sezoneve të provimeve, gjatë vitit akademik 2021-2022, janë marrë masat e duhura për zhvillimin e tyre. Provimet janë zhvilluar në kohën e rregullt, të planifikuar.
 - c. **Së treti**, në departament është bërë kujdes për hartimin e tezave që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve dhe të të gjithë programit të lëndëve.
 - d. **Së katërti**, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar zhvillimi i provimeve në të gjithë ecurinë e tij: është hartuar në kohë kalendar i provimeve ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit; janë ngritur komisionet për çdo provim; është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit; është ndjekur procesi i sekretimit; afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.

Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecure normale të procesit mësimor shkencor në departamentin tonë, duke filluar që nga ditët e para të mësimi i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjitha elementet e tij.

Është organizuar kontroll i vazhdueshëm lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog dhe me programet përkatëse të lëndëve, për një ecure sa më normale të të gjithë procesit mësimor dhe shkencor.

Në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve janë zhvilluar mbledhje të rregullta dhe me protokoll për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë stafit.

Realizimi i procesit mësimor është kryer në auditore në përputhje me rregulloren e zhvillimit të mësimi. Gjatë vitit të kaluar praktikat janë zhvilluar në rrethet e studentëve. Mësimi është zhvilluar nga pedagogët përkatës.

Zhvillimi i praktikave mësimore u realizua më mirë se vitin e kaluar, pasi situata anticovid ishte më e stabilizuar. Kontrollat, vëzhgimet, bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj. në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundur përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor.

Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i TIK në mësim, angazhimi i studentëve në hartimin e eseve dhe punës krijuese në lëndë të ndryshme, etj. Sigurisht ka vend dhe mundësi që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë.

- Për të nxitur një përgatitje sistematike gjithëvjetore, në programet e të gjitha lëndëve, që zhvillojnë anëtarët e personelit akademik të FESHSH-së, është parashikuar, që studenti duhet të sigurojë 20 pikë, nga përgatitja në seminare, që zhvillohen gjatë vitit.

Më konkretisht fokusi u përqëndrua në:

- Ripunimin e planeve lëndore, të programeve të studimit të Ciklit të Parë, Bachelor.
- Rinovimin e planeve mësimore, për programet e studimit të Ciklit të Dytë, Master.
- Përgatitjen e teksteve apo cikleve të leksioneve, në formë përmbledhje dispensash.
- Zgjerimin e bashkëpunimit institucional dhe të stafëve si me universitetet brenda, por gjithashtu edhe me ato jashtë vendit.
- Pjesëmarrjen e stafit akademik (*sipas departamenteve*) të fakultetit, në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

- Gjatë vitit akademik 2021-2022, stafi akademik i FESHSH synim kryesor kishte realizimin plotësisht me sukses të procesit mësimor, synim i cili kërkoi angazhimin maksimal të stafit akademik të njërive bazë të fakultetit.
- Veprimtaria kërkimore-shkencore, që kryhet në FESHSH, synon të mbështetë zhvillimin në rang lokal, rajonale dhe kombëtar si dhe rritjen e cilësisë së arsimit mbarëkombëtar
- Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.
- Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor shkencor në departamentin tonë, duke filluar që nga ditët e para të mësimi, i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementet e tij.
- Është organizuar kontroll i vazhdueshëm lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog dhe me programet përkatëse të lëndëve, për një ecuri sa më normale të të gjithë procesit mësimor dhe shkencor.
- Në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve janë zhvilluar mbledhje të rregullta dhe me protokoll për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë stafit.
- Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i TIK në mësim, angazhimi i studentëve në hartimin e eseve dhe punës krijuese në lëndë të ndryshme, etj. Sigurisht ka vend dhe mundësi që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë.
- Njësia bazë e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek vëpron në kuadrin e Universitetit “E. Çabej” si pjesë e fakultetit të Edukimit dhe Shkenceve Shoqërore. Ka për objekt akademiko-shkencor formimin gjuhësor, letrar, psikopedagogjik dhe metodologjik të studentëve, mësues të ardhshëm të gjuhës greke dhe lëndëve shoqërore në shkollat e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri për të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar.
- Në Njësinë Bazë të Gjuhës, Letërsisë & Qytetërimit Grek, viti akademik 2021-2022, si periudhë tranzitore, post Covid-19, u përqëndrua në dy drejtime kryesore. Në rikthimin e punës akademike në normalitet dhe përpjekjet për ngritjen cilësore përsa i përket performancës. Për këtë në Njësinë tonë Bazë u shfrytëzua pozitivisht përvoja e re e krijuar në dy vitet e kushteve të pandemisë.
- Në vitin akademik 2021-2022 në Njësinë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek funksionuan dy, nga tri, programe studimi: Programi Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, programi i nivelit të dytë, Master profesional për arsimin fillor në gjuhën greke.

- Stafi akademik u angazhua totalisht në realizimin cilësor të dy programeve të studimit. Sgfrrytëzoi për këtë dhe përfitimet e komunikimit me sistemet on line të konsoliduara në dy vitet parardhëse, sidomos në anën e punës individuale dhe praktike.
- U përmiresuan dukshëm metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe u vu re efektiviteti i tyre. Mësimi on line ishte një përvojë e re dhe e aplikuar me sukses dhe në periudhën post Kovid në ato segmente që garantojnë efektivitet më të mirë dhe gjithmonë brenda kuadrit të lejuar nga legjislacioni në fuqi.
- U perfeksionua më shumë praktika e punimeve të pavarura dhe detyrave të kursit për sa më shumë tema të lidhura me përmbajtjen e disiplinave të caktuara, (sidomos në programin master).
- U aplikua gjithashtu biseda në bazë të pyetësorëve të hartuara nga pedagogu dhe testet.
- Po ashtu kujdes u tregua për të rritur pjesëmarrjen në mësim, leksione dhe seminare, që u realizua në masë të kënaqshme.
- Në përfundim të vitit akademik gjithë stafi akademik ka raportuar se u realizua me sukses programet e nivelit të parë dhe të dytë në të gjitha disiplinat për vitin akademik 2021-2022.
- Paralelisht gjatë vitit akademik, secili anëtar i stafit akademik përmirësoi programet e veta mësimore dhe ciklet e leksioneve për të dy ciklet e studimit. Puna u përqëndrua veçanërisht për në realizimin e programit Master me 60 credite, pasi është relativisht program i ri dhe kërkon impenjim shtesë për përgatitjen e plotë të leksioneve, anës teorike në përgjithësi dhe asaj praktike në veçanti.
- Për të dy programet rinovua bibliografia bazë dhe ajo ndihmese në masën 30-40 përqind dhe u muarrën masa që ajo të vihet në funksion të studenteve.
- Edhe në këtë vit akademik Departamenti organizoi dhe zhvilloi me mesuesit e shkollave të minoritetit etnik grek takime dhe seminare trajnuese dhe kualifikuese. Punë me grafikë dhe e specializuar u bë sidomos në drejtim të përshtatjes së metodave të mësimdhënies me tekstet e reja mësimore në gjuhën amtare, në zbatim të kurrikulës së re. Kjo u konsiderua si eksperience në vijim të punës së stafit akademik të departamentit për ambjentimin e mësuesve me tekstet në gjuhën amtare për shkollat e shtetit parauniversitar të përgatitura nga stafin i Njesisë tonë Bazë i (fillore AMU).
- Posaçërisht i vlefshëm ishte vijimi i punës për kongretizimin e përvojës së fituar përgjatë seminarit kualifikues 6 mujor realizuar përgjatë vitit 2020-21, në bashkëpunim me universitetin e Maqedonisë Perendimore Greqi, me të gjithë mësuesit e shkollave të minoriteti grek.
- Në drejtim të përfeksionimit të punës për pajisjen e studenteve me njohuri efikase, me aftësi dhe kompetenca profesionale, stafi akademik ishte në kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e shkollave në gjuhën amtare dhe me mësuesit e tyre.
- Punë cilësore është kryer edhe për mbulimin e të gjitha lëndëve të programeve të studimit me staf akademik të kualifikuar sipas profileve të parashikuara.

- Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore e Njesisë tonë Bazë gjatë vitit akademik 2021-2022, pavarësisht vështirësive dhe pengesave, është karakterizuar në vijimësi nga përpjekje të admirueshme të stafit akademik për të realizuar detyrimet akademike shkencore për përmbylljen me sukses të tij në të dy programet e studimit.
- Përgjatë vitit akademik 2021-22 u punua me përgjigjësi për mbarrëvajtjen e sesionit të provimeve të sezonit të dimrit, të verës dhe të vjeshtës.
- U realizua me shumë sukses procesi i diplomimit të studenteve që përfunduan programet e studimit si edhe për të mbarturit.
- Janë intensifikuar gjithashtu përpjekjet për të siguruar numër të kënaqshëm studentesh për të dy programet e studimit në Departamentin tonë.
- Gjithashtu, si për çdo fillim viti akademik edhe për vitin akademik në pritje, 2022-2023, puna ka nisur me ndjekjen e ecurisë së maturantëve dhe afrimit të tyre me programet tona të studimit. Kjo u evidentua me prurje më të mëdha studentesh se në vitet e mëparshme.
- Në përgjithësi në aspektin organizativ të veprimtarisë mësimore është patur parasysh:
- Puna për përfeksionimin e aftësive akademiko-shkencore të stafit sipas programeve të reja të studimit (përpunimi dhe përmirësimi i leksioneve dhe literaturës në programin bachelor dhe në programet e nivelit të dytë, master) dhe për fillimin mbarë të vitit të ri akademik 2022-23 me këto programe.
- Ky proces u shoqërua nga puna e kryer nga stafi akademik i departamentit për promovimin e anëve të forta të programeve të tij me qëllim thithjen e një numri sa më të madhë studentesh.
- Duke u nisur nga kualifikimi dhe specializimi ndër vite i stafit akademik si edhe duke patur parasysh detyrimet e normimit vjetor, është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore përkatëse.
- Këtu edhe një herë u evidentua problemi që për mbulimin e programeve mësimore stafit akademik i duhet të marrë përsipër më shumë se tri lëndë, gjë që pengon përfeksionimin e përqendruar të stafit në disiplina që mund të jap rendiment më të lartë. Rekrutimi i një anëtari të ri stafi akademik me kohë të plotë kishte në këtë drejtim përparësi dhe magësitë e veta. Në radhë të parë zëvendësimi ose rekrutimi i personelit të ri nxorri në pah rendësinë e rolit të personelit ndihmës akademik për veçoritë e Njesisë tonë Bazë. Kjo pasi personeli ndihmës akademik u kthye në personel akademik me kohë të plotë dhe vendi i personelit ndihmës akademik mbëti vakant.
- Po ashtu, duke qenë se planet mësimore janë ripunuar është treguar kujdes që stafi akademik të marrë në kohë lëndët e reja.
- U përgatiten në kohë oraret mësimore, organograma dhe struktura e vitit akademik për të dy programet e studimit.
- I gjithë stafi akademik i departamentit ka punuar në vazhdimësi për t'i pajisur studentët me materiale të shkruara, si tekste apo cikël leksionesh në formë dispensash në lëndët përkatëse.

- Departamenti është plotësuar me stafin akademik të nevojshëm me kohë të plotë. Për vitin akademik 2021-2022, u plotësua me 8 anëtarë me kohë të plotë. Mbëti vacant vendi i personelit ndihmës akademik.
- Për realizimin e ngarkesës akademike për të dy programet nuk u desh personel akademik me kohë të pjesshme. Departamenti vlerësoi se ishte më e favorshme dhe me rentabël për mbarrëvajtjen cilësore të programeve të studimit mbulimi i lëndëve nga stafi akademik me kohë të plotë. Nga anëtarët e stafit akademik me kohë të plotë një është me titull profesor i asocuar dhe një me gradën doctor. Dy anëtarë të stafit akademik u regjistruan në programin e doktoraturës të fakultetit të gjuhëve të huaj në Tiranë dhe dy aplikuan në Universitetin e Janinës (Këto për vitin akademik 2022-2023). Dy të tjerë mbëten me studime pas universitare, Master i Shkencave.
- Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor, Departamenti ynë i ka kushtuar kujdes mbarrëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementet e tij. Ky detyrim u bë më i rëndësishëm për shkak të veçorive të reja që mbart në vetvete ky program.
- Në këtë drejtim është punuar shumë për ndërgjegjësimin e stafit akademik për respektimin me rigorozitet të orës së mësimi dhe trajtimin e studentit si objekt dhe subjekt i dijes.
- Për këtë, nuk kanë munguar kontrollët si në aspektin formal ashtu dhe të përmbajtjes. Organizimi i bisedave për metodat e përdorura, vëzhgimet, bisedat midis pedagogëve e studenteve, raportimet në vazhdimësi kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor .
- Për kontrollin e njohurive përgjatë gjithë vitit, puna u përqëndrua në vlerësimin e punimeve personale, detyrave të kursit, diskutimeve qoftë edhe on line si edhe nëpërmjet testeve. Krahasimisht me vitet e tjera vlerësimi i vazhduar pati vështirësi. Shkaku duhet kërkuar tek mungesa pjesëmarrjes së gjithë studenteve në seminare dhe forma të tjera të vlerësimit të vazhduar. Mëgjithatë, procesi ishte në nivele të kënaqshme.
- Provimet si forma finale e vlerësimit të njohurive të studentit, si një nga komponentët më të rëndësishëm të aktivitetit mësimor, u është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e gjithë stafit të Departamentit. Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik 2021-22, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur në disa momente kryesore.
- *Së pari*, Njohja e stafit akademik dhe studenteve me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme .
- *Së dyti*, i është kushtua vëmendje që studentët të cilët nuk e mbrojnë diplomën me punim diplome të kenë paraprakisht programin e studimeve me përmbledhjen e çështjeve kryesore.
- *Së treti*, studentët që e mbrojtën diplomën me punim diplome ndoqen me rigorozitet të gjitha procedurat dhe udhëheqësit treguan impenjim të kualifikuar

- *Së katërtri, Në Departament është bërë kujdes për hartimin e tezave me të gjitha elementët e parashikuara në rregulloren e Universitetit dhe të programit të studimit. Synimi kryesor ishte që nëpërmjet tyre të synohet një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve. Po ashtu respektimi i akteve normative në hartimin dhe administrimin e tyre i jipet prioritet në Departament.*
- *Së pesti, rendësi fitoi gjithashtu planifikimi dhe monitorimi i zhvillimit të provimit në të gjithë ecurinë e tij:*
- *Hartimi në kohë i kalendarit të provimeve ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit;*
- *Ngritja e komisionit për çdo provim;*
- *Kontrolli i plotë i dokumentacionit;*
- *Është ndjekur procesi i sekretimit, afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.*
- *Po ashtu, është treguar kujdes i posaçëm për hedhjen e notave në sistemin on line dhe njoftimi i rezultateve tek studentët, pavarësisht se çdo studentë ka akses personal, punë për të cilën nuk pati asnjë vërrejtje apo ankim.*
- *Rezultoi se kalushmeria në simestrin e dytë të vitit akademik 2021-22 ishte në masën 54% për programin e studimit të nivelit të parë dhe 86% në programin e studimit të nivelit të dytë, Master profesional. Nota mesatare për programin e studimit të nivelit të parë ishte 6, 9 dhe në programin e studimit të nivelit të dytë 7.8.*
- *Ne sezonin e provimeve të vjeshtës kalushmeria për simestrin e parë dhe të dytë u përmiresua reciprokisht, në programin e studimit të nivelit të parë në masën 75 %, pa patur ndonjë përmiresim të dukshëm në notën mesatare.*
- *Në programin e studimit MASTER u diplomuan 6 studentë në master profesional, dy prej të cilëve me punim diplome.*
- *Organizimi dhe zhvillimi i praktikës pedagogjike mbëti një aspekt i rendësishëm i procesit mësimor në departamentin tone. Në përgjithësi u reflektuan marrëdhëniet e mira me institucionet shkollore ku kryhet praktika mësimore. Marrja përsipër nga ana e departamentit tone të hartimit të librave për shkollat në gjuhën amtare të sistemit parauniversitar, ka siguruar një komunikim dhe një marrëdhënie me produktive dhe në efektivitetin e kryerjës së praktikës pedagogjike*
- *Po ashtu, për here të pare praktika pedagogjike në programin “Master profesional për arsimin fillor në gjuhën greke” u shtua me një javë, pra u bë katër javë. Mëgjithatë, përseri konsiderohet e shkurtër.*

Nisur nga sa më sipër, në analizën dhe vlerësimin e punës së stafit akademik u vërejt se:

- ✓ *Është punuar për të realizuar me sukses simestrin e parë dhe të dytë, të vitit akademik 2021-2022.*
- ✓ *Janë rinovuar dhe përmirësuar programet mësimore, për të dyja ciklet e studimit.*

- ✓ Janë modernizuar edhe më tej metodat dhe teknologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre të mëtejshme.
- ✓ Është bërë përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike (*seminareve, laboratoreve etj*), me të reja bashkëkohore të shkencës.
- ✓ Është bërë udhëheqja e tezave të diplomës të studentëve, të programeve të studimit “*Master në mësuesi në AMU*” dhe “*Master profesional*” dhe në fushat e studimit, që ofrohen në FESHSH.
- ✓ Është kryer me përkushtim dhe seriozitet mbarëvajtja e praktikave mësimore në terren dhe praktikave mësimore profesionale si dhe janë bërë përpjekje për të bërë vlerësime sa më reale të studentëve, duke marrë në konsideratë jo vetëm vlerësimin gjatë kryerjes së praktikës, por edhe duke organizuar testime konform programit të praktikave. Organizimi dhe zhvillimi i praktikave pedagogjike është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në FESHSH. Në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionin ku kryhet praktika mësimore. Marrja përsipër nga ana e departamenteve, të hartimit të librave për shkollat në gjuhën amtare të sistemit parauniversitar, ka siguruar një komunikim dhe një marrëdhënie me produktive dhe në efektivitetin e kryerjes së praktikës pedagogjike, por gjatë këtij viti, si rezultat i situatave të krijuara, janë zbatuar programe të veçanta, në bazë të kushteve të krijuara.
- ✓ Në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira dhe korrekte bashkëpunimi me institucionet dhe subjektet shtetërore, ku kryhen praktikat mësimore profesionale. Edhe gjatë këtij viti, si rezultat i marrëveshjes së bashkëpunimit me organizmat drejtues të arsimit parauniversitar në rang qyteti apo bashkish, ato u zhvilluan normalisht.
- ✓ Kontrollat, vëzhgimet, diskutimet me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj., në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (*realizimin e orëve të programit mësimor*) ashtu edhe në aspektin cilësor.
- ✓ Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore në fakultet është karakterizuar nga përpjekje intensive dhe të vazhdueshme, të stafit akademik për të instaluar metoda dhe forma bashkëkohore, për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve, në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje, aftësi dhe kompetenca, që do t’ju duhen për të siguruar punë në të ardhmen.
- ✓ Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.
- ✓ Janë hartuar oraret mësimore dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimeve.
- ✓ Njësitë bazë janë plotësuar me stafin akademik të nevojshëm duke ndjekur procedura ligjore dhe transparente, në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
- ✓ Çdo pedagog ka hartuar programet e lëndëve, mbi bazën e planit mësimor dhe janë bërë përpjekje maksimale për realizimin sasior dhe cilësor të procesit mësimor.
- ✓ Është bërë përmirësimi i materialeve mësimore, të disiplinave përkatëse nga çdo pedagog.
- ✓ Është punuar nga të gjithë pedagogët në vazhdimësi, për t’i pajisur studentët me materiale didaktike të shkruara, si tekste apo cikël leksionesh, në formë dispensash, në lëndët përkatëse.

Në kuadrin e organizimit të procesit mësimor, janë bërë kontrole të herëpashershme mbi disiplinën në punë, cilësinë e mësimdhënies etj. Në fund të semestrave është bërë ballafaqimi i planeve kalendare me orët e realizuara nga pedagogët si dhe plani për plotësimin e orëve të perealizuara, për arsye të ndryshme (*festa zyrtare, shëndeti etj*).

- Vazhdoi funksionimi normal i programeve të reja mësimore, të Ciklit të Dytë “*Master*”:

1. “*Mësues i arsimit fillor klasa I-V*”, nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe i Metodologjisë së Mësimdhënies.

2. “*Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës*”, nga Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe i Metodologjisë së Mësimdhënies.

3. “*Mësuesi për arsimin fillor në gjuhën greke*”, nga Departamenti i Gjuhës, Letërsisë e Qytetërimit Grek.

- Detyra të rëndësishme kanë qënë riorganizimi i njësive bazë, rishpërndarja e ngarkesave mësimore, përgatitja e planeve mësimore, rishikimi i planeve ekzistuese, pasurimi dhe përsosja e programeve mësimore, janë hartuar dhe miratuar orari i mësimave për sistemin me kohë të plotë; struktura e vitit akademik; planet kalendare dhe programet mësimore të çdo disipline mësimore; shpërndarja e ngarkesës mësimore, për çdo pedagog, konform Udhëzimit 20, dt. 09.05.2018, të MASH-it.

- Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor në rang fakulteti, duke filluar që nga ditët e para të mësimin, i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementet e tij.

- Është organizuar kontroll i vazhdueshëm lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog dhe mbi programet përkatëse të lëndëve, për një ecuri sa më normale të të gjithë procesit mësimor.

- Në zbatim të rregullores dhe udhëzimeve janë zhvilluar mbledhje të rregullta dhe me protokoll për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë stafit akademik, të departamenteve të FESHSH.

- Edhe gjatë këtij viti akademik, ka vijuar përmirësimi i mëtejshëm i zhvillimit të procesit mësimor, ku janë vërejtur përdorimi më i gjerë i metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve (*përdorimi i TIK në mësim*). Sigurisht, përmirësimi i metodave të mësimdhënies nuk do të ndalet këtu. Për këtë edhe stafi akademik i departamenteve, në përbërje të FESHSH-së në tërësi, është i vetëdijshëm dhe punon për gjetjen e mundësive përmirësuese, në vazhdimësi, si në përdorimin dhe perfeksionimin e teknikave të mësimdhënies, ashtu edhe në zbatimin e mënyrave bashkëkohore të mësimdhënies.

- Në zbatim të Rregullores dhe udhëzimeve, janë zhvilluar mbledhje dhe analiza në rang njësish bazë, për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë. Në tërësi departamentet e FESHSH, janë të plotësuara me kuadrin e stafit akademik të nevojshëm. Ngarkesa e pedagogeve efektivë, ka qënë brenda parametrave normalë. Është organizuar kontroll i vazhdueshëm, lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog (*programet përkatëse të lëndëve, regjistrat, etj*) për një ecuri sa më normale të gjithë procesit mësimor dhe shkencor.

- Për lëndët mësimore, që zhvilluan studentët, informacionet e marra u mbështetën në ciklet e leksioneve në formë dispence apo tekstesh. Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i teknologjisë së informacionit, në procesin mësimor, angazhimi i studentëve në hartimin e eseve, detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike etj, në disiplina të ndryshme, përfshirja e një pjese të studentëve të vitit të fundit, etj. Por gjithashtu, duhet theksuar se ka vend edhe mundësi, që mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies, të përmirësohen dhe të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë.

- U miratuan planet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore si dhe dokumentacioni përkatës, u azhornuan me kërkesat e udhëzimeve të MASH dhe Rregullores së Universitetit dhe Fakultetit: orari i mësimeve; struktura e vitit akademik; programet e lëndëve në përputhje me planet mësimore; shpërndarja e ngarkesës mësimore për çdo pedagog etj.

- Një nga problemet, që është parë me prioritet dhe i është kushtuar një vëmendje e veçantë gjatë këtij viti akademik, është problemi i organizimit të punës së departamenteve të FESHSH-së, në lidhje me ditët e informimit të maturantëve të shkollave të mesme, kryesisht të Rajonit Jugor, duke siguruar një njohje të programeve, stafeve si dhe mjediseve; laboratoreve, bibliotekave etj.

- Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive është realizuar si gjatë gjithë vitit akademik, ashtu edhe në fund të semestrave. Një nga komponentët më të rëndësishëm të përmbushjes me sukses të aktivitetit mësimor janë provimet, ndaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur.

Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik, ky proces përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur, *për tre momente kryesore të këtij procesi:*

Së pari, janë njohur pedagogët si dhe studentët, me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve, për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, në njësitë bazë është bërë kujdes për hartimin e tezave, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar zhvillimi i provimeve në të gjithë ecurinë e tij:

- *është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora dhe mjedisi i zhvillimit të provimit;*

- *janë ngritur komisionet për çdo provim;*

- *është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit;*

- *është ndjekur procesi i sekretimit , afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.*

Krahas ecurisë normale, duhet theksuar se ende vërehen mangësi të tilla si:

- Numri dhe niveli i ulët i studentëve të regjistruar në programet e studimit.

- Ka raste të frekuentimit të ulët të leksioneve nga ana e studentëve (në disa raste lidhen me faktorë socio-ekonomik të vet studentëve, por edhe të neglizhencës të ndonjë anëtari të stafit akademik, për të rritur motivimin dhe nxitjen, për pjesëmarrje sa më aktive të tyre në orën e mësimit).
- Nuk mungojnë rastet kur përgatitja dhe aktivizimi i studentëve në seminare dhe laboratore lë shumë për të dëshiruar, gjë që përbën pengesë për pedagogët për shfrytëzimin efektiv të kohës prej tyre;
- Gjithashtu objektiv mbetet modernizimi me pajisje dhe materiale të nevojshme, në mbështetje të zhvillimit me cilësi të lartë dhe me standarte bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo i detyron pedagogët që në disa raste të jenë më tepër teorikë sesa praktikë.
- Rritja sasiore dhe cilësore e mësimdhënies, me staf akademik mësimdhënës si me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme.

❖ *Praktika profesionale (pedagogjike)*

Organizimi dhe zhvillimi i praktikave pedagogjike është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në të gjitha programet e studimit, që mbulon Fakulteti. Gjatë të gjitha viteve të studimit, për të gjitha programet, në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionet ku kryhen praktikat mësimore profesionale.

Futja e sistemit të “mentoreve”, si një përvojë e fituar nga projektet e përbashkëta me universitetet perëndimore, prej disa vitesh ka ndikuar pozitivisht në cilësinë e punës.

Praktika mësimore vëzhguese (*afatshkurtër*), zhvillohet në shkollën 9-vjeçare, të arsimit të mesëm të ulët “Koto Hoxhi” dhe kopshtet Nr. 6 “Rreze Drite”, “Cicërimat”, Nr. 4 “Dallëndyshet”, kopshti Nr. 7 “Buzëqeshja” etj.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, e ka përqendruar punën mësimore e shkencore në disa drejtime:

- Përmirësimi i planeve dhe programeve mësimore, për të gjitha ciklet dhe format e studimit, si edhe i dokumentacionit universitar, në përputhje me udhëzimet e MASR dhe ndryshimeve, që janë bërë në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
- Modernizimi i metodave dhe teknologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre.
- Aplikimi i platformës së komunikimit online me studentët Microsoft team
- Përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike me të reja bashkëkohore të shkencës.
- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale të studentëve.
- Kualifikimi i vazhdueshëm individual profesional dhe shkencor i stafit akademik.
- Pjesëmarrja në aktivitete kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore e FESHSH, gjatë vitit akademik 2021-2022, është përqendruar në përdorimin e metodave e formave bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në

mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që iu duhen për të ardhmen, në përshtatje me kontekstet e reja, ku u përfshi i gjithë sistemi arsimor.

Edhe për këtë vit akademik, puna ka nisur nga aspekti organizativ i veprimtarisë mësimore.

NJBEMM gjatë vitit akademik 2021-2022, e ka përqendruar punën mësimore e shkencore *në disa drejtime*:

- Përmirësimi i planeve dhe programeve mësimore, për të gjitha ciklet dhe format e studimit, si edhe i dokumentacionit universitar, në përputhje me udhëzimet e MASR dhe ndryshimeve, që janë bërë në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.

- Riorganizimi dhe aplikimi i Masterit Profesional në “Mësuesi ndihmës në edukimin gjithëpërfshires,, me 60 kredite në Master Profesional në “Mësues i arsimit special me 120 kredite.

- Modernizimi i metodave dhe teknologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, me synim rritjen e cilësisë së tyre, duke i përshtatur ato edhe me hapësirat dixhitale.

- Përditësimi dhe pasurimi i përmbajtjes së programeve mësimore, ligjëratave dhe seancave praktike me të reja bashkëkohore të shkencës.

- Realizimi në mënyrë sa më cilësore i praktikave profesionale të studentëve.

- Kualifikimi i vazhdueshëm individual profesional dhe shkencor i stafit akademik.

- Pjesëmarrja në aktivitete kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

Mund të thuhet se përgjithësisht veprimtaria mësimore e NJBEMM, gjatë vitit akademik 2021-2022, është përqendruar në përdorimin e metodave e formave bashkëkohore për transmetimin dhe përvetësimin e dijeve në mënyrë që studentët të zhvillojnë ato shprehje e kompetenca që i'u duhen për të ardhmen, në përshtatje me kontekstet e reja, ku u përfshi i gjithë sistemi arsimor.

Edhe për këtë vit akademik, puna ka nisur nga aspekti organizativ i veprimtarisë mësimore.

Kështu, nga i gjithë stafi akademik i NJBEMM, janë hartuar:

- Programe të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.

- Dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MASR-së dhe rregulloreve të Universitetit, Fakulteteve dhe programeve përkatës të studimit.

- Oraret e mësimave dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimit.

- Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.

- Departamenti është i plotësuar me stafin akademik të nevojshëm me kohë të plotë.

- Për nevojat e departamentit janë aktivizuar edhe staf akademik me kohë të pjesshme me kohëzgjatje të caktuar, të cilët zhvillojnë kryesisht orë seminaresh apo ndjekje të praktikave pedagogjike e profesionale të studentëve.

Në NJBEMM me këtë statue janë 2 (dy) docent , 1 (një) Dr dhe pjesa tjetër, “Master ekzekutiv”, “*Master i Shkencave*”, në fushën e Edukimit dhe në specialitetet e tjera sipas fushave.

- Çdo pedagog ka hartuar programet mësimore mbi bazën e planit dhe programit mësimor, për realizimin sasior e cilësor të procesit mësimor. Kujdes është treguar edhe për përditësimin dhe pasurimin e ligjëratave me të reja

bashkëkohore të shkencës, si dhe për aplikimin e metodave rezultative për kontrollin e dijeve nëpërmjet platformave dixhitale

- Pozitiv është fakti se studentët në përgjithësi (*krahas literaturës së rekomanduar*) janë të pajisur me tekste universitare, makete, ose cikël leksionesh, të përgatitur nga pedagogët, për disiplina të ndryshme përkatëse, sipas programit të studimit.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, u bë një punë serioze, duke angazhuar të gjithë stafin akademik të departamenteve, për pasurimin e shumë lëndëve duke i përshtatur me kontekstet e reja, ekonominë e tregut dhe literaturat bashkëkohore, *për të gjitha programet e studimit*:

1. Programi i ciklit të parë të studimeve, Bachelor në “*Arsimin fillor*” Klasa I-V, me diplomë universitare Bachelor në “*Mësuesi për arsimin fillor*” Klasa I-V.
2. Programi i ciklit të parë të studimeve, Bachelor në “*Arsimin parashkollor*”, me diplomë universitare Bachelor në “*Mësuesi për arsimin parashkollor*”
3. Programi i studimit dyvjeçar, me karakter profesional “*Edukatorë për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme*” (0-3 vjeç).
4. Programi i ciklit të dytë të studimeve, “*Master profesional*” në “*Mësues ndihmës në edukimin gjithëpërfshirës*”.
5. Programi i ciklit të dytë të studimeve, “*Master profesional*” në “*Mësues i arsimit fillor*” Klasa I-V.
6. Programe të ciklit të dytë të studimeve, “*Master*” në “*Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët*”, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore (FESHSH) dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës (FSHN).

1.1. Staf i akademik dhe studentët

1.1.1. Staf i akademik

NJBEMM është e plotësuar me kuadrin akademik të nevojshëm. Ngarkesa e stafit akademik me kohë të plotë është brenda parametrave normale. Gjatë vitit 2021-2022, kemi të përfshirë me kohë të plotë 9 (nëntë) pedagogë, të cilët sipas titujve dhe gradave mbulojnë të gjitha nevojat e procesit mësimor. Për nevojat e departamentit janë aktivizuar pedagogë, me kohë të pjesshme, të cilët sipas titujve dhe gradave zhvillojnë leksione, seminare apo ndjekje të praktikave pedagogjike të studentëve: 3 (një) “Prof. asoc”, personel akademik i ftuar; 2 (dy) “Docent”; 1 (një) “Doktor”, në Universitetin e Tiranës; 2 (dy) “Master ekzekutiv”, në Universitetin e Tiranës; 1 (një) “Master Shkencor”, në “Psikologji”, Universiteti I Tiranës; 4 (katër) “Master Shkencor”, në Mësuesi për Arsimin Fillor, në Universitetin e Gjirokastrës.

Studentët

Numri total i studentëve, gjatë vitit akademik 2021-2022, në programet e ciklit të parë të studimeve, të ciklit të dytë të studimeve dhe programin e studimit dyvjeçar, me karakter profesional, ka qënë 225 të tillë, me këtë ecuri, si më poshtë vijon:

Gjatë vitit akademik 2021-2022, ka numër të ulët të studentëve të vitit të parë dhe të dytë në ciklin e parë të studimeve, më kohë të plotë: në programet e studimit Bachelor në “Arsimin fillor” Klasa I-V dhe Bachelor në “Arsimin parashkollor”:

- Në të 2 (dy) programet e reja të studimit, kemi një intersim dhe rritje të numrit të studentëve, të cilat pasqyrohen specifikisht në tabelat e mëposhtme:

Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive

Provimet janë një nga komponentët më të rëndësishëm të aktivitetit mësimor, prandaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e gjithë stafit të departamentit. Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik 2021-2022, janë respektuar të gjitha udhëzimet e MASR dhe Rektoratit, proces ky, i cili përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur, për tre momente kryesore të këtij procesi:

Së pari, janë njohur pedagogët si dhe studentët me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, në departament është bërë kujdes për hartimin e tezave, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, kontrolli dhe vlerësimi i njohurive, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar në të gjithë ecurinë e tij:

- është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit;
- janë ngritur komisionet për çdo provim;
- është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit të stafit akademik;
- është ndjekur procesi i sekretimit, afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.

Gjatë këtij viti akademik kemi patur një mbështetje shumë efektive për realizimin e provimeve me teknikën CleanScore nga coordinator për UEÇGJ.

NJBEMM ka hartuar strukturën dhe oraret e zhvillimit të procesit mësimor në përshtatje me situatat e krijuara.

Organizimi i punës dhe ndjekja e procesit mësimor

Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor shkencor, në departamentin tonë, duke filluar që nga ditët e para të mësimin i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementët e tij.

Kontrollet, vëzhgimet, bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj, në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundur përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (*realizimin e orëve të programit*) ashtu edhe në aspektin cilësor.

Kështu, p.sh. në zhvillimin e procesit mësimor gjatë këtij viti janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve: përdorimi i TIK në mësim, angazhimi i studentëve në hartimin e eseve në lëndë të ndryshme, përfshirja e të gjithë studentëve të vitit të fundit në kryerjen e mikrotezave etj. Sigurisht ka vend dhe mundësi, që

mënyrat bashkëkohore të mësimdhënies të gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë. Gjatë këtij viti akademik platformave të reja të mësimdhënies *online të përdorura gjatë vititeve të pandemisë, tashmë u përdorën për punët e pavarura dhe detyra të ndryshme për studentët*, duke e përmirësuar atë nga koha në kohë, përgjatë këtij viti akademik, duke i kushtuar vëmendje të shtuar, tërheqjes më të madhe të mendimit kritik dhe të pavarur të studentëve, për çështje të ndryshme në debate dhe diskutime gjatë seminareve.

Për të nxitur një përgatitje sistematike gjithëvjetore, në programet e të gjitha lëndëve, që zhvillojnë anëtarët e personelit akademik të NJBEMM, është parashikuar, që studenti duhet të sigurojë 20 pikë nga vlerësimi i vazhduar.

Praktika profesionale (pedagogjike)

Organizimi dhe zhvillimi i praktikave pedagogjike është një aspekt i rëndësishëm i procesit mësimor, në të gjitha programet e studimit, që mbulon NJBEMM. Gjatë të gjitha viteve të studimit, për të gjitha programet, në përgjithësi janë krijuar marrëdhënie të mira me institucionet ku kryhen praktikat mësimore profesionale.

Praktika mësimore vëzhguese (*afatshkurtër*), zhvillohet në shkollën 9-vjeçare, të arsimit të mesëm të ulët “Koto Hoxhi” dhe kopshtet Nr. 6 “Rreze Drite”, “Cicërimat”, Nr. 4 “Dallëndyshet”, kopshti Nr. 7 “Buzëqeshja”, Institucionet e moshës 0-3 vjeç, etj.

Brenda Universitetit “Eqrem Çabej”, NJBEMM është një njësi bazë, me funksion formimin psiko-pedagogjik dhe metodologjik të studentëve, mësues të ardhshëm për të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar. Ky pozicion dhe mision i NJBEMM, ka përcaktuar gjithashtu edhe drejtimin kryesor dhe dominant të aktivitetit kërkimor-shkencor të departamentit: problematika psiko-pedagogjike e edukimit të nxënësve në shkollë, në të gjitha aspektet e saj, që nga formimi cilësor i mësuesve në universitet, tek metodologjitë e reja bashkëkohore të mësimdhënies në shkollë dhe deri tek zbatimi i kurrikulës së re të arsimit parauniversitar, e mbështetur mbi të mësuarin me bazë kompetencat kyçe dhe të lëndëve, gjatë organizimit të veprimtarive mësimdhënëse dhe mësimnxënëse.

Fushat e kërkimit shkencor janë të larmishme:

Të mësuarit me kompetenca

- Korniza e re e Arsimit Parashkollor në Republikën e Shqipërisë.
- Kurrikulat bërthamë në arsimin fillor dhe Arsimin Parashkollor.
- Kurrikula Bërthamë në Arsimin e Mesëm të Ulët

Kurrikula bazohet në realitete historike, shoqërore, gjuhësore, politike, fetare, gjeografike dhe kulturore të një vendi. Me anë të saj sigurohet arsimimi cilësor dhe i barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.

Në kurrikula, ndër të tjera, përcaktohet se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit, cilat vlera dhe qëndrime duhen kultivuar tek ata, si duhen aftësuar ata për bashkëjetesë dhe tolerancë, si mund të japin ndihmesë në mënyrë aktive, për mirëqënien shoqërore dhe vetjake etj.

Me ndryshimet që ndodhin në shoqëri, shfaqen nevoja të reja, marrëdhënie të reja në shoqëri dhe në tregun e punës, risi teknologjike, aspirata të reja njerëzore, strategji të reja për zhvillim etj.

Të gjitha këtyre ndryshimeve, arsimi duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore dhe cilësore, për të mundur njohuri të reja, shkathhtësi, vlera dhe qëndrime të përshtatshme, sistematike, koherente dhe në zhvillim të përhershëm. Në këto kushte, nevoja për ndryshime kurrikulare, që synojnë kompetencat, rishfaqet gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore dhe praktikën shkollore, ndaj përbën thelbin e reformave arsimore, në përgjithësi dhe atyre kurrikulare, në veçanti.

Edukimi gjatë gjithë jetës

- Problematikat dhe përvojat e edukimit të vazhdueshëm në plan të përgjithshëm. Format e organizuara dhe jo të organizuara. Lidhja e të mësuarit gjatë gjithë jetës me tregun e punës dhe zhvillimin teknologjik bashkëkohor.
- Formimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve, si aspekt i rëndësishëm i të mësuarit gjatë gjithë jetës. Legjislacioni, praktikat konkrete, politikat e zhvillimit etj.
- Realizimi i programeve të trajnimit me mësuesit e arsimit parauniversitar.

Edukimi ndërkulturor

- Plani global, rajonal, lokal. Edukimi në një shoqëri multikulturore. Dimensioni social dhe edukativ.
- Dimensioni ndërkulturor, në sistemin e edukimit dhe praktikën e institucioneve edukative në rajon (kurrikula shkollore, praktikë, politika arsimore etj.)

Zhvillimi i sistemit dhe i kurrikulave, për përgatitjen e mësuesve në arsimin e lartë sipas sistemit të Bolonjës

- Transformimet në sistemin e formimit të mësuesve, për nivele dhe cikle të ndryshme.
- Zhvillimi i kurrikulave dhe i mësimdhënies.

Gjithëpërfshirja në edukim

Edukimi dhe arsimimi i fëmijve, me nevoja të veçanta. Problematikat e diagnostikimit, përmbajtjes dhe metodave të punës me ta. Në të tre programet e reja të studimit është futur si lëndë e re, *gjithëpërfshirja në edukim*.

Psikologjia dhe shkolla

Problematika psikosociale e marrëdhënieve ndërmjet komponentëve, në procesin mësimor-edukativ dhe ndikimi i tyre, në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies. Motivimi. Menaxhimi i klasës. Etika e sjelljes. Problematika moshore dhe individuale. Fushat e veprimit të psikologëve shkollorë. etj.

Diversiteti dhe komunikimi në klasë

Problematika të ndryshme që lindin në një klasë diversë në komunikim, në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, menaxhimi i këtyre problematikave si dhe hartimi i strategjive për zgjidhjen e tyre.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.

Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlikuar dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI, kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të

shfrytëzuar mundësitë, që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisi

Plane mësimore (hartime të reja dhe përmirësime)

Gjatë vitit akademik 2021-2022, NJBEMM ka aplikuar dhe ka fituar Masterin profesional “Mësuesi i Arsimit special”, me 120 kredite.

Tekste universitare, tekste parauniversitare, tekste-maket universitar, cikle leksionesh dhe monografi

Gjatë vitit akademik 2021-2022, në NJBEMM janë hartuar 6(gjashtë) cikle leksionesh, brenda Grupit Mësimor-Kërkimor të Pedagogji-Psikologjisë: *Motivimi dhe produktiviteti; Gjithëpërfshirja në edukim, Tik në edukim, Çrregullimet dhe terapia e të folurit, Strategji didaktike në edukimin special dhe Logopedi.*

Kështu, nga i gjithë stafi akademik i FESHSH-së, janë hartuar:

- Programe të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore.
- Dokumentacioni përkatës në përputhje me kërkesat e udhëzimet e MASR-së dhe rregulloreve të Universitetit, Fakulteteve dhe programeve përkatës të studimit.
- Oraret e mësimave dhe struktura e vitit akademik, për të dy ciklet e studimit.
- Është bërë shpërndarja e disiplinave mësimore dhe e mësimdhënies së normuar vjetore.
- Departamentet janë plotësuar me stafin akademik të nevojshëm me kohë të plotë.
- Për nevojat e departamenteve janë aktivizuar edhe staf akademik me kohë të pjesshme me kontratë, të cilët zhvillojnë kryesisht orë seminaresh apo ndjekje të praktikave pedagogjike e profesionale të studentëve. Shumica prej tyre kanë përfunduar studimet “*Master Ekzekutiv*”, “*Master i Shkencave*”, në fushën e Edukimit dhe në specialitetet e tjera sipas departamenteve.
- Çdo pedagog ka hartuar programet mësimore mbi bazën e planit dhe programit mësimor, për realizimin sasior e cilësor të procesit mësimor. Kujdes është treguar edhe për përditësimin dhe pasurimin e ligjëratave me të reja bashkëkohore të shkencës, si dhe për aplikimin e metodave rezultative për kontrollin e dijeve nëpërmjet platformave online të ofruara në kuadrin e pandemisë.

Pozitiv është fakti se studentët në përgjithësi (*krahas literaturës së rekomanduar*) janë të pajisur me tekste universitare, makete, ose cikël leksionesh, të përgatitur nga pedagogët, për disiplina të ndryshme përkatëse, sipas programit të studimit.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, u bë një punë serioze, duke angazhuar të gjithë stafin akademik të departamenteve, për përmirësimin dhe ristrukturimin e programeve mësimore dhe e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, *për të gjitha programet e studimit:*

❖ Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive

Provimet janë një nga komponentët më të rëndësishëm të aktivitetit mësimor, prandaj dhe i është kushtuar vëmendja e duhur nga ana e gjithë stafit të departamentit. Në të gjitha sezonet e provimeve gjatë vitit akademik 2021-2022, janë respektuar të gjitha udhëzimet e MASR dhe Rektoratit, proces ky, i cili përgjithësisht është zhvilluar normalisht duke bërë kujdesin e duhur, *për tre momente kryesore të këtij procesi:*

Së pari, janë njohur pedagogët si dhe studentët me nenet përkatëse të Rregullores së Universitetit, me kërkesat e udhëzimeve për plotësimin e dokumentacionit etj. Duhet thënë se në këtë drejtim ka përmirësime të ndjeshme.

Së dyti, në departament është bërë kujdes për hartimin e tezave, që bëjnë të mundur një kontroll dhe vlerësim sa më objektiv dhe cilësor të njohurive të studentëve.

Së treti, kontrolli dhe vlerësimi i njohurive, si aspekti më kryesor, është planifikuar dhe monitoruar në të gjithë ecurinë e tij:

- është hartuar në kohë kalendari i provimeve, ku janë përcaktuar datat, ora, mjedisi i zhvillimit të provimit;
- janë ngritur komisionet për çdo provim;
- është kontrolluar plotësimi i dokumentacionit të stafit akademik;
- është ndjekur procesi i sekretimit, afati i korrigjimit të provimeve me shkrim etj.
- është hartuar struktura dhe oraret e zhvillimit të procesit mësimor në përshtatje me situatat e krijuara.
- me po të njëjtin protokoll dhe kërkesa rigoroze, për mbajtjen e distancimit social dhe numrit të studentëve në auditore (*sipas kriterëve të vlerësuar nga specialistët përkatës të UGJ*), u organizuan gjithashtu edhe provimet e vjeshtës.

Si konkluzion, gjatë vitit, akademik 2021-2022, u realizuan një sërë objektivash dhe detyrash, por u evidentuan edhe një sërë sfidash, *si më poshtë vijon*:

- në përfshirjen aktive të gjithë stafit akademik të FESHSH, në kërkimin shkencor;
- në pjesëmarrjen e kënaqshme të stafit akademik, në projekte shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- në pjesëmarrjen e mirë të stafit akademik, në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- në numrin e ulët të artikujve shkencorë, në periodikë vendas dhe të huaj;
- në përmbushjen e plotë të kualifikimit shkencor, sidomos për stafin që është në proces;
- në vënien në efikasitet të plotë, të grupeve mësimore-kërkimore, të cilat duhet t'u kthehen edhe referimeve shkencore periodike, sipas fushave përkatëse kërkimore;
- në pajisjen e studentëve me tekste dhe materiale të shkruara, për disiplinat në të cilat ato mungojnë;
- në rritjen e aktivizimit të studentëve, në kërkimin-shkencor nëpërmjet punimeve të diplomave, mikrotezave, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore etj;
- në rritjen më shumë të punës, në të ardhmen, për faktin e regjistrimit në planet mësimore “*Master profesional*”, që mbulon FESHSH, të një të konsiderueshëm studentësh. Tërheqja e studenëve në aktivitete të kërkimit shkencor, do t'i nxisë ata që edhe në të ardhmen e afërt, me fillimin e vitit të ri akademik, 2021-2022, por edhe në të ardhmen largët, përgjatë gjithë jetës, të jenë kërkues shkencor të denjë dhe të japin ndihmesën e tyre në probleme të shumta të edukimit, jo vetëm në nivel lokal, rajonal, por gjithashtu mbarëkombëtar.

Si konkluzion, gjatë vitit, akademik 2021-2022, u realizuan një sërë objektivash dhe detyrash, por u evidentuan edhe një sërë sfidash, në kushtet e situatës kombëtare dhe globale, *si më poshtë vijon*:

Anët e forta

1 (një) staf pedagogjik fiton titullin akademik Profesor i asociuar. Mimoza Çarka

2 (Dy) staf akademik me kohë të plotë kanë fituar të drejtën për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve në fushën e pedagogjisë Aida Sotiri dhe të psikologjisë Valbona Caushi, në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

- në pjesëmarrjen e kënaqshme të stafit akademik, në projekte shkencore kombëtare e ndërkombëtare;
- në pajisjen e studentëve me tekste dhe materiale të shkruara, për disiplinat në të cilat ato mungojnë;
- në rritjen e aktivizimit të studentëve, në kërkimin-shkencor nëpërmjet punimeve të diplomave, mikrotezave, pjesëmarrjes në aktivitete shkencore etj;
- Tërheqja e studenëve në aktivitete të kërkimit shkencor, do t'i nxisë ata që edhe në të ardhmen e afërt, me fillimin e vitit të ri akademik, 2021-2022, por edhe në të ardhmen largët, përgjatë gjithë jetës, të jenë kërkues shkencor të denjë dhe të japin ndihmesën e tyre në probleme të shumta të edukimit, jo vetëm në nivel lokal, rajonal, por gjithashtu mbarëkombëtar.

Pikat e dobëta

- Përmbushje jo e plotë e kualifikimit shkencor, sidomos për stafin që është në proces;
- Pjesëmarrje jo e mirë e stafit akademik, në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare;

Në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, për realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore-kërkimore janë këto strukturat përgjegjëse:

- Dekani
- Përgjegjësat e njësive bazë
- Përgjegjësat e grupeve mësimore-kërkimore

Të dhëna mbi studentët:

Për vitin akademik 2021 – 2022 nga Universiteti “Eqrem Çabej” ishin planifikuar gjithësej 1521 kuota në total për pranimet e reja në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe programet profesionale dhe ciklin e trete.

528 kuota për ciklin e parë, 715 kuota për ciklin e dytë dhe 265 për programet profesionale dhe 13 për ciklin e tretë të studimeve. Tabelat e mëposhtme janë parashikimet e kuotave për çdo program studimi të ofruar nga Fakultetet në zbatim të pikës j sipas udhëzimit nr. 5 dt 19.02.2018.

Nr.	Kapacitetet pritëse	Shuma e kuotave	Shqiptarë brenda vendit	Trojet	Shtetas të Huaj	PAK	Me Statusin e jetimit	Romë/ Ballkano egjiptian	Trasferim Studimesh	Program i dytë
1.	Bachelor	528	354	44	1	9	6	2	74	43
2.	Cikli i dytë	715	528	28	4	11	10	11	39	80
3.	Programe profesionale	265	210	13	1	12	10	10	8	6
4.	Cikli i tretë	13	10	4					1	

Realizimi i kuotave u bë në masën 48.3 %, dhe u regjistruan gjithësej 735 studentë të rinj.

Studentë të rinj të regjistruar	Viti 2021-2022
Regjistrime për program të parë sipas afateve të përcaktuara (cikli i parë, cikli i dytë dhe prog prof)	634
Transferime	4
Programe të dyta	97
Gjithësej	735


Regjistrimet sipas programeve të studimit dhe fakuleteve në programet e ciklit të parë

Cikli i studimeve	Fakulteti	Kuotat	Regjistruar në raunde	Transferime	Program i dytë	Totali	Realizimi
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore							
Bachelor	Histori – Gjeografi	35	4	0	1	5	14%
Bachelor	Gjuhë Letërsi Shqipe	30	5	0	1	6	20%
Bachelor	Gjuhë Angleze	33	3	0	2	5	15%
Bachelor	Histori dhe Gjuhë Italiane	20	0	0	0	0	0%
Bachelor	Mësuesi për Arsimin Fillor kl I - V	30	1	1	4	6	20%
Bachelor	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	30	4	0	3	7	23%
Bachelor	Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek	20	6	0	-	6	30%
Fakulteti i Shkencave të Natyës							
Bachelor	Matematikë - Informatikë	25	0	0	0	0	0%
Bachelor	Teknologji Informati	30	19	0	0	19	63%
Bachelor	Infermieri e Përgjithshme	90	80	0		80	100%
Bachelor	Infermieri Mami	25	14	0	0	14	56%
Bachelor	Biologji Kimi	25	4	0	1	5	20%

Fakulteti Ekonomik							
Bachelor	Kontabilitet Finance	55	35	1	1	37	67%
Bachelor	Administrim Publik	55	26	2	0	28	51%
Bachelor	Turizëm	25	5	0	0	5	20%

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore i realizoi kuotat në masën 18 %, Fakulteti i Shkencave të Natyrës i realizoi kuotat në masën 61 % dhe Fakulteti Ekonomik në masën 52 % për programet e ciklit të parë “Bachelor”


Grafiku i regjistrimeve për ciklin e parë për vitin 2021-2022



Klasifikimi i studentëve të rinj në programet Bachelor sipas gjinisë.

Sipas gjinisë pranimet e reja janë: Bachelor 142 femra ose (63 %) dhe 80 meshkuj (ose 36 %)

(Grafiku ilustrues)



Studentë sipas Grupmohave


Gjithsej cikli i pare Bachelor viti i pare 222 student

18 vjecarë - 95 studentë ose 42 % e pranimeve në Bachelor

19-20 vjecarë - 64 studentë ose 28 %

Mbi 20 vjeç - 63 studentë ose 28 %

(Grafiku ilustrues)



Studentë sipas vendbanimit ne ciklin e pare “Bachelor” 2021-2022

Rethi	Nr. i studentëve të rinj gjithsej
Gjirokastrë	99
Berat	2
Bulqize	2
Tepelene	22
Delvine	4
Përmet	19
Libohovë	1
Fier	7
Lushnjë	5
Vlorë	1
Tiranë	6
Diber	2
Kucovë	1
Korce	1
Kelcyre	5
Mat	2
Pogradec	1
Sarandë	25
Konispol	1
Memaliaj	2


Regjistrimet sipas programeve të studimit dhe fakuleteve në programet e ciklit të dytë

Cikli i studimeve	Fakulteti	Kuotat	Regjistruar	Transferime	Program i dyte	Totali	Realizimi
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore							
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë-Fizikë	25	-	0	0	0	0%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë-Informatikë	30	7	0	2	9	30%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Biologji - Kimi	30	9	0	0	9	30%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	25	0	0	0	0	0%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë dhe Qytetërim Italian	25	0	0	0	0	0%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë Letërsi	35	12	0	0	12	34%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Gjuhë Angleze	35	11	0	2	13	37%
Ciki i dyte	"Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Histori Gjeografi	55	8	0	2	10	18%
Ciki i dyte	"Master i Shkencave " në Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike	15	6	0	0	6	40%
Ciki i dyte	Master Profesional në mësuesi për Arsimin Fillor Kl I – V	60	16	0	0	16	27%
Ciki i dyte	Master Profesional në mësuesi ndihëms në Edukimin Gjithëpërfshirës	120	49	0	53	102	85%
Ciki i dyte	Master Profesional në mësuesi për Arsimin Fillor në Gjuhën Greke	25	7	0	0	7	28%
Fakulteti i Shkencave të Natyës							
Ciki i dyte	Master Profesional në Shkenca Infermiore	90	58	0	0	58	64%

Cikli i studimeve	Fakulteti	Kuotat	Regjistruar	Transferime	Program i dyte	Totali	Realizimi
Fakulteti Ekonomik							
Ciki i dyte	Master Profesional në Kontabilitet Finance	60	25	-	2	27	45 %
Ciki i dyte	"Master Profesional" në Administrim Publik	60	28	-	4	32	53%
Ciki i dyte	"Master Profesional " në Turizëm	25	9	-	-	9	36%
Cikli i dyte	"Master i Shkencave" në Financë Kontabilitet	50	20	-	16	36	72%

Realizimi i kuotave për programet e ciklit të dytë të studimit është në masën 45 %

Grafiku i regjistrimeve për ciklin e dytë për vitin 2021-2022




Studentë sipas Grupmoshave per ciklin e dyte te studimeve 21-22:

20-25 vjec - 92 studentë ose 26 % e pranimeve në ciklin e dytë

25- 35 vjecar - 164 studentë ose 46 %

Mbi 35 vjeç - 93 studentë ose 27 %

(Grafiku ilustrues)



Studentë sipas vendbanimit cikli i dyte i studimit 2021-2022


Rethi	Nr. i studentëve të rinj gjithsej
Gjirokastrë	89
Tepelene	42
Libohovë	2
Përmet	16
Fier	36
Lushnjë	35
Vlorë	3
Tiranë	5
Durrës	1
Berat	13
Delvinë	8
Gramsh	1
Korçë	2
Kukës	3
Skrapar	1
Mat	1
Librazhd	1
Sarandë	26
Konispol	1
Memaliaj	9
Elbasan	3

Regjistrimet sipas programeve të studimit dhe fakulteteve në programet me karakter profesional

Cikli i studimeve	Fakulteti	Kuotat	Regjistruar	Transferime	Program i dyte	Totali	Realizimi
Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore							
Program Profesional	Edukatore për zhvillimin e femijerise se hershme 0-3 vjec	50	40	0	0	40	80%
Program Profesional	Librar dhe Bibliotekar	40	13	0	2	15	38%
Program Profesional	Udherrefyes Turistik	40	15	0	1	16	40%
Fakulteti Ekonomik							
Program Profesional	Ndihmës Ekonomist	45	35	0	0	35	78%
Program Profesional	Asistent Administrativ	45	31	0	0	31	69%
Program Profesional	Asistent Menaxher ne Sherbimet Turistike	45	29	0	0	29	64%

Realizimi i kuotave për programet me karakter profesional është në masën 63 %


Grafiku i regjistrimeve për programet me karakter profesional për vitin 2021-2022



Klasifikimi i studentëve të rinj në programet me karakter profesional sipas gjinisë.

Sipas gjinisë pranimet e reja janë: Program profesional gjithsej studente 166 nga te cilet , 86 femra ose (51 %) dhe 80 meshkuj (ose 49 %)

(Grafiku ilustrues)




Studentë sipas Grupmoshave

18 vjecarë 28 studentë ose 26 % e pranimeve në Programe profesionale

19-20 vjecarë 32 studentë ose 21 %

Mbi 20 vjeç 106 studentë ose 63 %

(Grafiku ilustrues)



Studentë sipas vendbanimit per programet me karakter profesional

Rethi	Nr. i studentëve të rinj gjithsej
Gjirokastrë	61
Tepelene	26
Përmet	17
Fier	14
Lushnjë	2
Vlorë	3
Korce	1
Tiranë	6
Durrës	1
Berat	7
Krujë	1
Vorë	1
Dibër	1
Kelcyre	1
Sarandë	20

Numri i përgjithshëm i studentëve të rinj që ndjekin studimet në Universitetin tonë, në vitet e para për vitin akademik 2021-2022 , në të gjitha programet e ciklit të parë, programet profesionale dhe të ciklit të dytë **është 735 studente**, (dhe në 2020-2021 janë regjistruar **787 studente të rinj**).

Duke i krahasuar të dy vitet kemi pasur një ulje të numrit të studentëve të regjistruar në programet në fushën e mësuesisë në krahasim me vitin e kaluar dhe kjo vjen si pasojë e disa arsyeve.

Në lidhje me pranimet e reja nga ana e departamenteve duhet të punohet në përmirësimin e numrit të studentëve, kjo ngelet detyrë për të ardhmen.

Nisur nga vlerësimi i shifrave mbi regjistrimet në vitet e para për programet e studimit me kohë të plotë, edhe për këtë vit akademik, vihen re dukuritë e mëposhtme:

Së pari, paraqitet situata jo e qëndrueshme me regjistrimin e studentëve të ciklit të parë në vitet e para ku në raport me vitin paraardhës, kemi një rritje të lehtë por jo e njëtrajtshme në të gjitha programet në krahasim me kuotat e parashikuara nga ana jonë.

Ndërkohë, disa programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë për vitin e I-rë në këtë vit akademik nuk kanë qënë aktive, dhe janë mbyllur në zbatim të urdhërit të MAS nr. 305, 01.09.2021 si:

1. Bachelor në Matematikë-Fizikë
2. Bachelor në Fizikë dhe Teknologji Informacioni
3. Bachelor në Gjuhë Italiane
4. Master i Shkencave në Gjuhësi
5. Master i Shkencave në Letërsi
6. Master i Shkencave në Biologji Mjedisë dhe Zhvillimi

Gjatë viti akademik 2021-2022, këto programe studimi u aplikuan për mbyllje në zbatim të ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.

Së dyti, sërisht është ruajtur hapësira gjeografike e rajoneve nga vijnë studentët.

Një pjesë e konsiderueshme e studentëve të rinj vijnë nga rajonet e jugut të Shqipërisë, çka është një tregues se roli dhe kontributi i UGJ^{së} ka sa karakter rajonal po aq edhe kombëtar.

Së treti, nota mesatare e shkollës së mesme e studentëve të regjistruar në vitet e para në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë është tregues për kualitetin e studentëve në programet e studimit dhe prurjet e reja në disa programe studimi si psh: programet e mësuesisë që kanë njohur një rënie të numrit të studentëve.

Për vitin 2021-2022 u vu re në tërësi një përmirësim i rritjes së cilësisë të studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve, e ndikuar kjo edhe nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, i cili solli vendosjen e notës mesatare të pranimet të maturantëve në universitet mbi 6.5 për programet jo mesuesi dhe nota mesatare 7.5 për programet e mesuesisë.

Kapacitetet e universitetit janë edhe më të mëdha në drejtim të pranimit të studentëve të rinj, ndaj për të realizuar këtë objektiv mendojmë se disa nga arsyt janë kushtëzuar nga faktet e mëposhtme:

- Planifikimi i kuotave shumë të larta në programet e studimit në institucionet publike të Tiranës, e lidhur kjo me tendencën, gjithmonë në rritje, që kanë shumica e të rinjve dhe të rejave të rajonit tonë për të studiuar në Universitetet e Kryeqytetit apo dhe jashtë shtetit, pavarësisht se ç'program studimi do të ndjekin.
- Konkurrenca e pandershme, hapja e shumë universiteteve private dhe sidomos funksionimi i tyre mbi bazën e standarteve jo të njëjta me ato të universiteteve publike.
- Universiteti i Gjirokastrës e zhvillon aktivitetin e tij në një rajon që është prekur më shumë nga emigracioni. Ky faktor ka sjellë vetvetiu uljen e numrit të studentëve.
- Mangësitë në drejtim të reklamimit të shërbimeve që UGJ^{ja} mund të ofroj për studentët e rinj dhe përfitimet që ata mund të kenë nga studimi në programet mësimore në UGJ. Gjeografia e reklamimit ndoshta duhej të ishte më e madhe dhe të shtrihej edhe në rajone të tjera të Shqipërisë.

Nisur nga qëllimi për të siguruar një ecuri normale të procesit mësimor, në Universitetin tonë, duke filluar që nga ditët e para të mësimi i është kushtuar kujdes mbarëvajtjes së këtij procesi në të gjithë elementët e tij.

Për këtë nga Rektorati, fakultetet dhe departamentet janë organizuar kontrole të vazhdueshme lidhur me dokumentacionin e secilit pedagog dhe me programet përkatëse të disiplinave mësimore, për një ecuri sa më normale të gjithë procesit mësimor.

Në zbatim të Statutit, Rregullores, dhe udhëzimeve janë zhvilluar mbledhje nëpër departamente, për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe punës shkencore si dhe për të siguruar një disiplinë të lartë në punë nga ana e të gjithë stafit akademik.

Nga analizat që janë bërë në fakultete dhe departamente, vihet në dukje dhe vlerësohet në përgjithësi pozitivisht puna e të gjithë stafit akademik. Megjithatë, mendojmë që në këto analiza do të ishte mirë të gjenin vend më shumë shembujt konkretë pozitivë apo negativë mbi rentabilitetin e punës së stafit akademik, duke vjelur edhe mendimin e studentëve për të rritur edhe më tej frymën e progresit.

Kontrollet, vëzhgimet, bisedat me pedagogë dhe studentë, kontrolli i dokumentacionit etj. në vazhdimësi gjatë gjithë kësaj periudhe kanë mundësuar përgjithësisht ecurinë normale të këtij procesi, si në aspektin sasior (realizimin e orëve të programit) ashtu edhe në aspektin cilësor.

Megjithatë, mbarëvajtja e procesit mësimor varet nga kapacitetet intelektuale e profesionale të pedagogëve, përgatitja e tyre për orën e mësimi, baza materiale e didaktike, kushtet e mjedisit mësimor, por edhe nga niveli i përgatitjes së studentëve dhe përgatitja e tyre sistematike dhe e vazhdueshme.

Theksojmë se nga ana e pedagogëve në përgjithësi ka pasur angazhim serioz në procesin e mësimdhënies si në auditore ashtu edhe në procesin e mësimi në distancë i cili është për herë të parë te ne, por në disa raste të

veçanta janë vërejtur edhe probleme, nga kontrollet e vazhdueshme te rektoratit jane konstatuar thyerje disiplinore nga ana e pedagogëve të cilët, si pasojë e mungesës së studentëve apo dhe të pedagogëve në mësim, që kanë çuar në mos zhvillimin e orës së mësim. Në këto raste është tërhequr vëmendja si studentëve ashtu edhe pedagogëve në funksion të përmirësimit të situatës. Këto dukuri kanë qenë më të theksuara në disa programe studimi, ku grupet mësimore janë me numër minimal apo të vogël studentësh.

Në zhvillimin e procesit mësimor gjatë vitit 2021-2022 janë vërejtur elementë të përdorimit të metodave dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies si gjatë leksioneve, ashtu edhe gjatë seminareve dhe seancave laboratorike për pajisjen e studentëve me shprehitë e përgjithshme dhe të transferueshme, si:

- Caktimi i objektivave për procesin e mësimdhënies e mësim-nxënies.
- Realizimi i një mësimdhënie ndërvepruese e fokusuar tek studenti dhe përdorimi i një game të gjerë materialesh burimore dhe një stil shqyrtimi që kërkon procesin e të menduarit dhe të analizës e jo thjesht njohuri faktike.
- Rritja e rolit të studentit në procesin mësimor duke e shndërruar atë nga një subjekt pasiv në aktiv, kërkues dhe pjesëmarrës.
- Përdorimi i TIK në mësim.
- Angazhimi i studentëve në hartimin e eseve, në detyra kursi dhe në punën krijuese në lëndë të ndryshme.
- Pasurimi i përmbajtjes së seminareve, seancave të ushtrimeve e seancave praktike.
- Aplikimi i metodave rezultative të kontrollit të dijeve etj.
- Aplikimi i platformave të mësimi online të cilat u vunë në dispozicion nga universiteti.

Rezultate pozitive në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimnxënies ka dhënë dhe vlerësimi i vazhduar gjithë vjetor i studentëve, i cili merret parasysh sipas një përqindje të caktuar në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në ndihmë të realizimit cilësor të procesit mësimor dhe rritjes së nivelit mësimor-shkencor në të gjitha programet e studimit të universitetit luajti dhe luan një rol të rëndësishëm investimi bashkëkohor i sistemit informatik dhe rrjetit të internetit, si dhe pasurimi e kabineteve të informatikës me pajisje kompjutera bashkëkohore, duke plotësuar të gjitha nevojat e Universitetit. Sot në Universitetin tonë ka në shërbim të studentëve dhe pedagogëve 289 kompjutera, me shërbim interneti falas, 26 laboratorë e kabine si dhe një bibliotekë e pasur. Gjithashtu është punuar nga të gjithë pedagogët për të pajisur studentët me tekste e materiale të shkruara për disiplinat përkatëse. Bibloteka dixhitale ne rang kombëtar rriti gënimin e literaturës studimore . Të gjithë studentët tanë janë bërë pjesë e bibliotekës online U-library.

Në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies ka ndihmuar mjaft edhe pasurimi i laboratorëve me një bazë materiale të përshtatshme e funksionale. Për vitin e ardhshëm do të bëhen përpjekje të mëtejshme për plotësimin e kërkesave të departamenteve për bazë materiale si nga ana sasiore ashtu dhe cilësore.

Nga ana e studentëve këtë vit, në disa programe studimi, ka një pjesëmarrje më të kënaqshme se vitet e kaluara në leksione, por përpjekjet për përgatitjen e seminareve dhe e punëve laboratorike nuk janë ende në nivelin e kërkesave të kohës. Kjo reflektohet dhe në vlerësimet përfundimtare, të cilat në përgjithësi nuk kanë qenë në nivelin e duhur, qoftë nga ana sasiore, qoftë nga ana cilësore.

Gjithashtu në disa raste vërehet një dukuri negative ajo e shkëputjes së lektorit nga studentët dhe dërrasa e zezë, duke kaluar në një punë virtuale pa debate e analizë, por thjesht lexohet ligjërata, e trajtuar gati bruto në “slide”-t që projektohen në auditore. Sa më sipër është sugjeruar të punohet në forcimin e bashkëpunimit pedagog-studentë me metodat bashkëkohore të interaktivitetit në klasa.

Një problematikë e ndjeshme është edhe pjesëmarrja e ulët e studentëve në disa programe studimi në leksione, ushtrime e laboratore. Kjo është e lidhur me disa elementë, por mendojmë se politika e liberalizimit, sidomos në përqindjen e ndjekjes së tyre dhe mospenalizimin në fund të vitit, madje duke krijuar akses hyrje në provimet e vjeshtës, kanë influencuar në braktisjen e procesit mësimor. Për këtë ka sugjerime nga ana e stafit akademik, nisur edhe nga draftet e akteve nënligjore, që të bëhet e detyrueshme një përqindje e caktuar e frekuentimit të leksioneve nga studentët. Kjo do të rriste sensibilitetin dhe pjesëmarrjen e tyre në leksione, duke mundësuar në të njëjtën kohë si mbarëvajtjen e procesit mësimor ashtu edhe eliminimin e moszhvillimit të orëve të leksioneve në auditore. Duke parë vlerësimet e studentëve në fletore, ka raste kur vlerësimi i pyetjeve është në total, duke mos evidentuar vlerësimin analitik të studentëve për çdo pyetje. Edhe kjo dukuri duhet të eliminohet për të ardhmen.

Vlerësimi i studentëve në përgjithësi është pasqyruar direkt në procesverbalet e provimit.

Hapa pozitivë janë shënuar në drejtim të vënies në efikasitet të projektit të MASR-it për krijimin e Qendrës Shërbimeve Arsimore dhe Rrjetit Akademik Shqiptar, i cili ka realizuar dixhitalizimin e sekretarive mësimore dhe të procesit didaktik. Aktualisht në këtë pikë kanë lindur problematika që lidhen me hedhjen në kohë të rezultateve në sistem.

Për këto problematika në tërësi janë marrë të gjitha masat që mangësitë e konstatuara të eliminohen, si ato për faj të mosfunksionimit të vetë sistemit, dhe ato që lidhen në disa raste me moskorrektësinë në punë të disa prej pjesëtarëve të stafit akademik.

Me gjithë rezultatet që kemi arritur në procesin mësimor ka akoma vend për përmirësime të mëtejshme sasiore dhe cilësore:

Në seancat e ushtrimeve dhe në punët laboratorike të studentëve duhet të ofrohet literaturë dhe bazë materiale më e bollshme dhe bashkëkohore për demonstrime dhe përfitim shprehish pune.

Orët e praktikave, seminareve dhe ushtrimeve duhet të konceptohen të ndryshueshme për t’u përgjigjur nivelit të studentëve.

Realizimi i praktikave mësimore duhet të planifikohet si një proces mësimor më i detajuar me detyra ditore dhe jo përfundimtare për studentët.

Matja e punës në praktikë duhet të jetë e konkretizuar dhe jo teorike. Edhe për praktikën pedagogjike të kërkohen e të gjenden mekanizma kontrolli më efikase që t’ju mundësojnë studentëve impenjim në mësimdhënie dhe jo formalizëm. Kjo kërkon që shpërndarja, angazhimi i stafit dhe kontrolli të jenë më frytdhënëse në formimin e tyre si mësues të ardhshëm.

Pedagogët në realizimin e detyrave të procesit mësimor duhet të zbatojnë më me rigorozitet Statutin, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme, që dalin nga instancat përkatëse, sepse tek tuk vërehet një moskoherencë midis pavarësisë akademike të stafit akademik dhe detyrimeve ligjore që rrjedhin nga aktet normative të institucionit.

Për të finalizuar rezultatin e punës mësimore do të duhej një informacion më i detajuar mbi nivelet e kalueshmërisë e të cilësisë, për të cilat sekretaritë mësimore të prodhojnë në fund të vitit akademik një raport informacioni.

Informacion mbi bashkëpunime ndërinstytucionale dhe projekte ku merr pjesë Fakulteti (IAL-ja) ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; kontratën; datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit ; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

1. Marrëveshje bilaterale të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë:

Gjatë vitit akademik 2021-2022, referuar me prioritetin institucional, Ndërkombëtarizimin, Universiteti i Gjirokastrës, e ka zgjeruar bashkëpunimin me 9 (nëntë) institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Falë bashkëpunimeve me universitetet partnerë është mundësuar lëvizshmëria e personelit akademik për trajnim dhe mësimdhënie dhe studentëve për praktika mësimore dhe mësimnxënie në Universitete me të cilat UGJ ka marrëveshje bashkëpunimi.

Nr.	Data	Marrëveshje Bilaterale të Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë
1.	25.05.2021	Marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë
2.	16.04.2021	Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Europian të Tiranës.
3.	27.07.2021	Marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi me Universitetin e Salentos, Itali.
4.	21.09.2021	Marrëveshje dypalëshe me Universitetin e Maçeratës, Itali (ASPIC)
5.	07/12/2021	Organizata Salvos, Serbi
6.	28.03.2022	Universiteti Polis
7.	11.04.2022	Qendra e Teknologjisë Tiranë
8.	12.04.2022	Protokoll bashkëpunimi me Universitetin e Janinës
9.	22.06.2022	Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, Greqi

2. Mobilitetet

Thirrjet për pjesëmarrje dhe perfshirja në programin e mobilitetit, nga zyra e Zv/Rektores për Shkencën dhe Marrëdhëniet me Jashtë dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve Shkencore paraqitet në tabelën vijuese:

Pjesëmarrja e stafit akademik në programet e mobilitetit

Nr	Universiteti	Të dërguar	Të ardhur	Për të ikur	Për të ardhur
1.	IES RIBEIRA DO LUORO, SPANJE, (FAKULTETI EKONOMIK)	9	-	-	2
2.	UNIVERSITETI I MOLISES, ITALI, (FAKULTETI EKONOMIK / DEPARTAMENTI I HISTORIES, ANTROPOLOGJISE DHE GJEOGRAFISE)	3	2	-	-
3.	UNIVERSITETI I MACERATES, ITALI, (FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQERORE / STAF ADMINISTRATIV)	6	8	-	-
4.	UNIVERSITETI ARISTOTELE, SELANIK, GREQI (FAKULTETI EKONOMIK / FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQERORE)	2	-	-	-

2. Mobilitete te stafit akademik/administrative ne kuader te implementimit te projekteve

Nr.	Projekti	Universiteti	Të dërguar	Të ardhur
1	BKSTONE	Universiteti i Sarajevës	4	-
2	BKSTONE	Universiteti i Podgoricës	2	-
3	BKSTONE	Mursia, Cehegin	2	-
4	TECOMP	Universiteti i Korçës	4	-
5	TECOMP	Universiteti i Nis-it	5	-
6	TECOMP	Universiteti i Novi Sad-it	4	-
7	ENTRAL	Universiteti Turku, Finlande	6	-
8	ENTRAL	Universiteti Teknik i Dublinit	6	-
9	ENTRAL	Universiteti i Leonit	5	-
10	ENTRAL	Universiteti i Vlores	5	-
11	QUADIC	Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren	2	-
12	QUADIC	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	2	-
13	QUADIC	Universiteti “Haxhi Zeka” Pejë	3	-
14	QUADIC	UNISPRAG, Itali	2	-
15	QUADIC	Universiteti Teknologjik i Sofjes	2	-
16	QUADIC	Universiteti I Lubjanës, Slloveni	2	-
17	QUADIC	Universiteti Cote d’Azur i Nises, France	2	-

18	QUADIC	Universiteti i Mjekësisë Tiranë	3	-
19	QUADIC	Universiteti “Isa Buletini” dhe International Business College të Mitrovicës	2	-
20	QUADIC	Universiteti I Prishtinës, Heimerer College dhe UBT, Prishtinë	2	-
21	QUADIC	Universiteti European i Tiranës	2	-

3. Pjesëmarrja e studentëve në programet e mobilitetit

Nr	Universiteti	Të dërguar	Të ardhur	Për të ikur	Për të ardhur
1.	IES RIBEIRA DO LUORO, SPANJE, (FAKULTETI EKONOMIK)	4	-	-	-
2.	UNIVERSITETI I MOLISES, ITALI (DEP. I POLITIKAVE EKONOMIKE DHE TURIZMIT)	1	1	-	-

4. Pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në programet e mobilitetit, financuar nga Ambasada e SHBA në Tiranë

Nr	Programi	Staf akademik / Studentë	Të dërguar	Të ardhur
1.	Summer Work & Travel	Studentë	10	-
2.	English Language Fellow and Program	Staf akademik	-	1

5. Projektet

Si një institucion i arsimit të lartë, Universiteti i Gjirokastrës është gjithmonë aktiv në politikën e tij të jashtme, duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha Universitetet shqiptare, por edhe me Universitete të huaja përmes Marrëveshjeve të Bashkëpunimit dypalëshe, por gjithashtu edhe përmes bashkëpunimit në kuadër të projekteve. Prioritet i Universitetit të Gjirokastrës është përfshirja në programet evropiane dhe bashkëpunimi në programe studimesh të përbashkëta me universitete partnere, si një hap i mëtejshëm në përqafimin e standarteve të BE-së për Arsimin e Lartë.

6. Tabela mbi projektet ku UGJ është partner

Viti akademik 2021-2022								
Nr.	Emërtimi i Projektit	(1-kombëtar, 2-IPA, 3-Lloji i projektit Erasmus+, 4-të tjera)	Fusha e projektit (zgjidh një numër sipas opsioneve të dhëna në fund të tabelës)	Kodi i Projektit	(specifikoni Financimi i përfituar nëse lek OSE nga institucioni euro)	Statusi i IAL në projekt: udhëheqës/ partner	Nr. i stafit të brendshëm të institucionit të angazhuar në këtë projekt	A parashikon ky projekt si partner një kompani biznesi? (po/jo)
1.	Innovative Economic Ecosystem IN-ECO	IPA INTERREG	1	A2-2.2-4	116,855.20 Euro 116,580	PARTNER	31	PO
2.	Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematic Sciences TeComp	ERASMUS PLUS	1	598434-EPP-1-2018-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP	89.286 Euro	PARTNER Coordinator per Shqiperine	13	JO
3.	CheeseCult Rruga e djathit si një forcë nxitëse e trashëgimisë kulturore për zhvillimin e turizmit rural në zonën ndërkufitare	IPA INTERREG	1	A4-2.1-19	92.574,80 Euro	PARTNER	5	JO
4.	Virtualand Një eksperiencë gjithëpërfshirëse virtuale për faqet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore	IPA INTERREG	1	A4-2.1-20	95.997,50 Euro	PARTNER	8	PO

5.	STONE.ART Zhvillimi tematik ndërkufitar i turizmit përmes ruajtjes së zejtarisë së gurit	IPA INTERREG	1	A4-1.3-18	95.997,50 Euro	PARTNER	6	JO
6.	QUADIC Zhvillimi cilësor i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe menaxhimit të projektit	ERASMUS PLUS	1	609786-EPP- 1-2019-1- XK- EPPKA2- CBHE-JP	50.400,00 Euro	PARTNER	8	JO
8.	BKSTONE Platforma e Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor për përfundimin e modernizimit dhe rritjes së qëndrueshme të Gurit Natyror	ERASMUS PLUS	1	610483-EPP- 1-2019-1-AL- EPPKA2- CBHE-JP	62.300,00 Euro	PARTNER	11	JO
9.	ENTRAL Aftësi sipërmarrëse për një arsim modern në Shqipëri	ERASMUS PLUS	1	617886-EPP- 1-2020-1-FI- EPPKA2- CBHE-SP	52 795 Euro	PARTNER	24	PO

7. Projektet me fondet e AKKSHI-it:

Nr.	Emërtimi i projektit	Koordinatori	Studentë të përfshirë në projekt	Staf të përfshirë në projekt	Kohështirja e projektit
1.	Standartizimi i produkteve të blektorisë në Qarkun e Gjirokastrës dhe krijimi i një marke tregtare.	Dr. Eduina Guga		5	Tetor 2021 deri Tetor 2022
2.	Infrastruktura e Kërkimit Shkencor në FEUGJ.	Dr. Robert Çelo		7	Nëntor 2021 deri Shkurt 2022

Përfshirja e studentëve të UGJ –së në veprimtari të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare ka qënë dhe mbetet prioritet. Duhet përmenduar puna që është bërë nga zyra e marrëdhënieve me jashtë të UGJ, për përfshirjen e studentëve në aplikime semestrale për ndjekje të studimeve në universitetet partnere në kuadrin e programeve Credit Mobility nën kujdesin e zyrës së ERASMUS + në Shqipëri. Në qëllim të bashkëpunimit dhe me fakotret lokalë, Universiteti i Gjirokastrës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe me instiucione rajonale, studentët e profileve mësuesi dhe të tjera kryejnë praktikat profesionale.

Bashkëpunimi me faktorë lokalë.

Bashkia Gjirokastrë

Zyra rajonale e punësimit.

Drejtoritë Rajonale Arsimore.

Sistemin Rajonal Bankar.

Kompanitë dhe bizneset private rajonale.

Spitalin rajonal “Omer Nishani”.

Teatrin “Zihni Sako” Gjirokastrë (Bashkia), etj.

Pedagogët dhe studentët e Fakultetit Ekonomik janë pjesëmarrës dhe kanë kontribuar në një sërë seminaresh e aktiviteteve organizuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, takimesh me biznesin për problemet e ndryshme ekonomike, etj

Rritja e rolit të UGJ-së në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social, duke ofruar krahas mësimi dhe veprimtari të ndryshme praktike si konsulencë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera, mbetet një pikë jo shumë e kënaqshme (pavarësisht nga disa arritje), për vetë faktin se duhet të jetë në nivelin e duhur bashkëpunimi me komunitetin, bizneset, organet e qeverisjes vendore.

8. POLITIKAT E KËRKIMIT SHKENCOR

Krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, Universiteti “Eqrem Çabej” si çdo universitet publik shqiptar, përpiqet të realizojë më sukses dhe dy misionet e tjera: kërkimin shkencor dhe misionin e tretë atë të bashkëpunimit me sektorët publikë e privat të rajonit, përmes transferës së teknologjisë së informacionit, edukimit të vazhdueshëm dhe angazhimit social.

UGJ si një institucion akademik dhe kërkimor – shkencor, do të vazhdojë të jetë një qendër e fuqishme për arsimimin dhe kërkimin shkencor.

Aktiviteti kërkimor- shkencor në UGJ bazohet, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbështetur në politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga MASR, i orientuar nga reformat social – ekonomik, nga tregu i punës si dhe nga standartet e reja të integrimit evropian.

Kërkimi shkencor, si tërësia e veprimtarive që krijojnë dije, përbën një të drejtë të personelit akademik që ushtrohet në kushtet e lirisë akademike, e cila garanton pavarësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Universiteti ofron kushte të përshtatshme dhe mbështet me çdo mënyrë prodhimin e dijes së re, bazë dhe të zbatuar, duke përqendruar vëmendjen në cilësinë dhe në origjinalitetin e punës kërkimore.

Kërkimi shkencor është një nga misionet kryesore të UGJ dhe së bashku me transferimin e teknologjive dhe inovacionin vlerësohen si faktorë themelorë për një ekonomi të orientuar nga dijet.

Riorganizimi dhe reformimi i kërkimit shkencor në UGJ konceptohet dhe vlerësohet si faktor themelor për reformimin e veprimtarisë akademike, kërkimore e shkencore dhe njëherazi përcaktues për vendosjen e standarteve europiane.

Njësitë kryesore dhe bazë që janë pjesë përbërëse të UGJ kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, sipas natyrës dhe objektivave specifike të institucionit.

Strategjia e UGJ për kërkimin shkencor

Kërkimi shkencor në UGJ është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësim-nxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore.

Synim i mëtejshëm është kthimi i UGJ në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal.

UGJ synon të bëhet një qendër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave të arsimit të lartë.

Risë standartin e kërkimit duke: promovuar standartet më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe integritetin etik në punën kërkimore; orientuar kërkimin në të gjitha fushat dhe kategoritë që i përgjigjen zhvillimit social ekonomik të rajonit; përcjellë debatet publike për edukimin nëpërmjet kontributit të pavarur të mbështetur në punën kërkimore duke mirëpritur dhe mbështetur partneritetin me agjencitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim që të promovojë të mirat publike në edukim;

UGJ synon që të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës jug-lindore, vendeve të bashkimit European dhe më gjerë vendeve anëtare të OCDE-së.

UGJ synon organizimin dhe ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët.

UGJ synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standarteve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratoreve, etj.

Mbi këto parime, UGJ është shumë i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, proceseve akademike dhe zhvillimit të stafit dhe kërkimit përmes mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. Këto synime, UGJ përpiqet t'i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Strategjia e UGJ për kërkimin shkencor parashtron:

Të identifikojë Objektivat e kërkimit shkencor, fushta prioritare në bashkërendim me politikat sektoriale të zhvillimit si dhe Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit (në fushat e shkencave natyrore, teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane), të cilat (këto të fundit), zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik. Ky prioritet është në funksion të arritjes së objektivave të caktuara në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rendësi për përparimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të rajonit dhe vendit. Të realizojë vlerësimin e veprimtarisë kërkimore –shkencore të njëjësive bazë.

Raportin vjetor të institucionit për KSH.

Kërkimi akademik në UGJ ka si qëllim prodhimin dhe organizimin e dijes, zhvillimin e teorive të reja dhe promovimin e forcimin e veprimtarive kërkimore në shërbim të mjedisit akademik, të bazuara në metodologji të reja e të mirëfillta shkencore; Zhvillim dhe inovacion pedagogjik, i cili ka të bëjë me futjen dhe përdorimin e metodologjive pedagogjike, mjeteve të edukimit dhe materialeve e teknikave mësimore inovative.

Kërkim të orientuar drejt praktikës - kërkimi që prodhon dije të reja dhe që kontribuon nga ana e tij në përparimin e efektshëm të praktikës së menaxhimit. Kjo kategori mbështetet në metodologji të bazuara në vëzhgime të thelluara dhe nga afër të situatave komplekse të biznesit, raste studimore, anketime ose racionalizim të përvojës së akumuluar menaxheriale dhe konsultative.

UGJ është angazhuar tërësisht në kërkimin që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të Universitetit, por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tij, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të Shqipërisë duke u përpjekur të ruajë balancën në zhvillimin e trinomit arsim - kërkim - inovacion, në përputhje me kriteret dhe standartet e BE-së.

Objektivat:

Vënia e veprimtarisë kërkimore shkencore të universitetit në funksion të:

- a. rritjes së cilësisë së procesit të arsimit;
- b. zhvillimit të vazhdueshëm.

Të përdorë perspektivat ndërkombëtare krahasuese në edukim, duke zhvilluar vlerat e drejtësisë sociale, shanseve të barabarta dhe të mirën e përbashkët;

Krijimi i një komuniteti akademik (në nivel departamenti, fakulteti e më gjerë) ;

Integrimi real i mësimdhënies me kërkimin shkencor duke e konsideruar këtë si domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar;

Rritja e fondit (buxhetit) në favor të kërkimit;

Vazhdimi me ritme të shpejta i kualifikimit të pedagogeve pa gradë.

Përfshirje më e gjërë të stafit në projektet kërkimore-shkencore kombëtare e ndërkombëtare;

Të inkurajojë krijimin e një gjenerate të re kërkuesish shkencorë në fushat e politikave sociale, mjedisore dhe ekonomike.

Vendosje të kërkimit në funksion të komunitetit, mjedisit e shoqërisë në tërësi.

Rritja e cilësisë dhe e numrit të botimeve të përgatitura nga anëtarët e departamenteve (artikuj, monografi, tekste mësimore, etj.) si dhe cilësisë së tyre.

Zgjerimi dhe forcimi i marrëdhënieve të partneritetit me institucionet vendore, arsimore (Drejtorinë Arsimore, shkollat etj), bankat, spitalin, bizneset e qarkut, institucione kërkimore-shkencore, trajnuese, botuese etj.

Zgjerimi i kapacitetit të Bibliotekës.

Botimi i të paktën dy revistave shkencore (periodikë) të UGJ-së.

Angazhimi për të siguruar lidhjet ndërkombëtare, sidomos me Universitetet Evropiane për të aplikuar në projekte të përbashkëta për ngritje kapacitetesh në Erasmus +, Horizont 2020, etj, për të siguruar më shumë mundësi trajnimi për stafin akademik dhe administrativ, për mbështetje në pajisje dhe laboratore sipas prioritetit të nevojave që do të përcaktohen. Përfshirja në bashkëpunim me Universitete të rajonit dhe Evropës për të siguruar mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve.

Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit dhe shqyrtimi i mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta të studimit me universitete të huaja.

Hartimi i një kalendar vjetor të aktiviteteve shkencore-kulturore (konferenca kombëtare e ndërkombëtare, seminare, simpoziume, lektoriume, leksione të hapura, referime shkencore, ëorkshop-e etj.

Orientimi dhe përafrimi sa më madh i veprimtarive shkencore-kulturore në UGJ, me kalendarin e ngjarjeve ndërkombëtare (sipas përcaktimit të OKB, bashkëngjitur) si dhe kalendarin e ngjarjeve të veçanta (mbarë)kombëtare, si për domethënien që kanë, ashtu edhe impaktin mediatik.

Pasqyrimi i aktiviteteve në kohë reale në faqen zyrtare të UGJ, mediatizimi i aktiviteteve dhe gjithë veprimtarisë së UGJ në të gjitha format e mundshme (media, media sociale, ëeb-e), për rritjen e impaktit, propagandimin e ofertës UGJ, si dhe për rritjen e imazhit publik të Universitetit “Eqrem Cabej”.

Të sjellë më afër komunitetin e biznesit me botën akademike, të ofrojë konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, teknologjinë e informacionit, kërkimin, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije.

Politikat në UGJ për Kërkimin Shkencor.

Senati i Universitetit harton dhe miraton strategjinë bazë të kërkimit shkencor, strategji që shërben si rrëfyese për të tre Fakultetet e UGJ. Kjo strategji përcillet në të gjitha departamentet dhe konkretizohet me planifikime specifike gjatë vitit akademik, me realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar; me studime e projekte për zhvillim si dhe në veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave të gjithsecilit, duke mbështetur veprimtarinë e stafit akademik për aftësimin dhe kualifikimin e tij jo vetëm në procesin e mësimdhënies por dhe atë shkencor.

Në vijim kërkohet të krijohet një raport i drejtë dhe efektiv midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formohen shprehi të punës dhe të metodave kërkimore shkencore tek studentët, duke i aktivizuar ata deri edhe në përfshirjen e tyre në grupe studimore e projekte që kanë departamentet, fakultetet ose universiteti.

Strukturat përgjegjëse për KSH

Një ndër synimet më të rëndësishme të Universitetit është Jetëzimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2014-2019. Sipas Ligjit dhe Statutit të Ugj, kërkimi kryhet nga njësitë bazë koordinuar nga zyra e Dekanit. Njësitë bazë pranë Fakulteteve, të cilat kanë detyrimin llogaridhënës pranë Dekanit të Fakultetit, hartojnë plane pune, informacione dhe raporte semestrale e vjetore, në përputhje me strategjinë e universitetit për kërkimin shkencor, prioritetet e MASR në fushën e kërkimit shkencor, prioritetet e rajonit për zhvillim, të cilat depozitohen pranë Dekanit të Fakultetit. Pra stafi akademik i UGj-së kryen punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë njësive bazë si kërkues shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektesh kërkimore.

Ndërsa në nivel universiteti puna kërkimore koordinohet dhe orientohet nga Zv/Rektori për Kërkimin Shkencor mbështetur nga zyra e Marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve e cila:

Harton programin dhe planin e punës për çdo vit akademik ku pasqyrohen drejtimit kryesore të veprimtarisë së saj, të miratuar nga Senati akademik;

Paraqet për miratim në Senatin akademik projekte kërkimore dhe mësimore duke mbajtur parasysh standardet bashkëkohore;

Nxit individualisht pedagogët dhe drejtuesit e njësive bazë për punë kërkimor-shkencore, si dhe nëpër projekte në shkallë universiteti, njësie kryesore apo njësie bazë;

Bashkërendon dhe koordinon veprimtaritë kërkimore të departamenteve, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik;

Promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të universitetit.

Punon për marrëdhënie dhe projekte të përbashkëta ndëruniversitare me të tjera institucione të arsimit të lartë, institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit;

Kontribuon në përfshirjen e personelit akademik të universitetit në projekte ndëruniversitare apo institucionale;

Drejton dhe orienton politikat e veprimtarisë botuese të UGJ, ku përfshihen dhe dy revistat shkencore periodike.

Përgjatë dhe në fund të çdo viti akademik, raporton për veprimtarinë kërkimore-shkencore pranë Senatit akademik ku dhe kryhen vlerësimet përkatëse.

Ky raport ndihmon në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit për faktin se përmban një analizë të hollësishme që vjen si rezultat i analizave të vecanta në çdo fakultet dhe njësi bazë.

Në qëllim të ndërkombëtarizimit të universitetit, për të zhvilluar projekte ndërkombëtare, partneritete strategjike dhe lehtësim aplikimesh për grante kërkimore etj, është ngritur Zyra për menaxhimin e Veprimtarisë Kërkimore-shkencore, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;

Kërkimet shkencore në universitet bëhen nga njësitë bazë apo grupet mësimore-kërkimore dhe mund të jenë:

Kërkime shkencore bazë pa përdorim të menjëhershëm praktik;

Kërkime shkencore të aplikuara që janë në lidhje të ngushtë me nevojat dhe interesin publik.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies, si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të departamenteve dhe fakulteteve të UGJ është përqëndruar në këto drejtime:

Hartimin e planeve dhe programeve të reja mësimore:

Ristrukturimi i planeve dhe programeve ekzistuese: Gjatë vitit 2020-2021 u bë një punë serioze, duke angazhuar të gjithë stafin akademik të departamenteve, për përmirësimin dhe ristrukturimin e planeve dhe programeve mësimore dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master Profesional”

Zhvillimi i kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe ligjit të arsimit të lartë.

Pjesëmarrja në veprimtari jashtë universitare të lidhura jo vetëm me performancën arsimore.

Forcimi i punës kërkimore-shkencore të stafit, me qëllim arritjen e objektivave profesionale dhe atyre të kualifikimit shkencor të personelit akademik të Fakultetit;

Përditësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve mësimore dhe ligjëratave më të reja bashkëkohore të shkencës.

Përdorimin e metodave dhe teknologjive më të reja në mësimdhënie.

Hartimi dhe përgatitja e teksteve universitare dhe dispencave mësimore.

Përgatitja e shkurtuar e programeve mësimore në dy gjuhesh (i gjithë stafi i Departamentit).

Vazhdimi i prezantimit të ciklive të leksioneve në trajtën e skripteve.

Ekspedita për hulumtime dhe grumbullim materiali kërkimor dhe zhvillim analizash laboratorike (stafi akademik). Për mbarëvajtjen më të mirë të procesit mësimor, të pajisjes së studentëve me njohuri bashkëkohore dhe me shprehje të kompetencave të domosdoshme për të ardhmen e tyre duhet:

Më shumë investime për përmirësimin e bazës materiale laboratorike me aparaturë bashkëkohore;

Përmirësim të mjediseve funksionale laboratorike.

Një vëmendje duhet të tregohet në përfshirjen e studentëve në aktivitete specifike të projekteve.

Përforsimi i punës në aspektin e tretë të veprimtarisë universitare: ndërveprimi me biznesin dhe komunitetin përveç dy aspekteve të tjera: mësimdhënies dhe kërkimit. Një pikë e fortë do të ishte lidhja e universitetit me qendrat e punësimit shtetërore dhe private duke siguruar një sistem efektiv veprimi.

Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara brenda dhe jashtë vendit, veprimtari të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera vendore, kombëtare apo ndërkombëtare.

Universiteti “Eqrem Cabej”, përmes studimit dhe kërkimit shkencor, synon të realizojë qëllimin e vet nëpërmjet kryerjes së punës studimore e kërkimore, trajnimeve, kurseve e konsultave, shërbimeve, veprimtarisë botuese dhe realizimit të projekteve të nivelit të lartë në të mirë dhe interes të publikut.

Krahas punës për zhvillimin me korrektësi dhe cilësi të mësimdhënies, personeli akademik i FESHSH i ka kushtuar një vëmendje mjaft të madhe veprimtarisë kërkimore-shkencore (individuale dhe në grup) me qëllim kualifikimin e mëtejshëm shkencor.

UGJ synon të bashkëpunojë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhet pjesëmarrës aktiv në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit.

Universiteti ynë, duke synuar të konvertohet në qendër rajonale të edukimit dhe të zhvillimit, përpiqet të realizojë objektivat e veta në këtë drejtim.

Veprimtaria kërkimore-shkencore si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të UGJ është përqëndruar në këto drejtime:

Aktiviteti Kualifikues.

Vazhdimi i punës kërkimore-shkencore.

Vazhdim i punës kualifikuese për grada e titujt, etj.

Aktiviteti Botues : Artikuj, recenca shkencore për periodikë kombëtarë / ndërkombëtarë.

Referime dhe pjesëmarrje në Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Udhëheqje e temave të diplomës në Master profesional.

Pjesëmarrje në projekte.

Më poshtë paraqitet pasqyra përmbledhëse e kualifikimit dhe të aktivitetit kërkimor –shkencor të stafit akademik të brendshëm angazhuar në tre Fakultete: FSHN, FESHSH dhe FE si dhe tabela përmbledhëse e stafit akademik të brendshëm të UGJ-së për vitin akademik 2021-2022.

**TABELA PËRMBLEDHËSE E KUALIFIKIMIT TË STAFIT AKADEMIK TË
BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË UGJ-SË (2021-2022).**

Të brendshëm:

Titulli, grada	FESHSH	FE	FSHN	Totali
Prof. dr.	5	0	1	6
Prof. Asoc.	11	1	8	20
Lektor	23	15	10	48
Asistent Lektor	17	5	10	32
Gjithsej	56	21	29	106

Staf akademik i brendshëm 106.

Të jashtëm:

Titulli, grada	FESHSH	FE	FSHN	Totali
Prof. dr.	7 (7 Ftuar)	5 (5 Ftuar)	2 (2 Ftuar)	14
Prof. Asoc.	4(4 Ftuar)	1(1Ftuar)	0	5
Lektor	7(2F)	3	2 (1 Ftuar)	12
Asistent Lektor	12	13(1Ftuar)	21 (1 Ftuar)	46
Gjithsej	30	22	25	77

Staf akademik i jashtëm 77 nga këta 24 të ftuar dhe 53 me kohë të pjesshme.
Viti akademik 2020-2021 staf akademik i larguar 4%.

Duhet evidentuar se kualifikimi i stafit në UGJ mbetet në nivele të kënaqshme. Një pjesë e mirë e tyre kanë kryer kualifikime jashtë vendit, falë kjo lidhjeve të shumta dhe mundësive që janë krijuar nga bashkëpunimet e UGJ-së me universitetet e tjera homologë brenda dhe jashtë vendit.

SIPAS FAKULTETEVE AKTIVITETI KËRKIMOR SHKENCOR PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 REZULTON:

1. FAKULTETI I SHKENCAVE TE NATYRËS

Raporti i veprimtarisë mësimore e kërkimore të FSHN, është hartuar bazuar mbi raportet e departamenteve përkatëse, si dhe në ndjekjen e përditësuar të realizimit të procesit mësimor e kërkimor, në vëzhgime, në analiza dhe kontrole, si dhe në vlerësimin e dokumentacionit ligjor nga strukturat drejtuese të fakultetit.

Më poshtë paraqiten të dhëna për aktivitetin kualifikues, botues, pjesëmarrës dhe referues (me gojë ose poster) në konferenca dhe aktivitete tjetër shkencor nga anëtarët e stafit akademik të FSHN sipas departamenteve:

Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit

1. Aktiviteti Kualifikues.

- Vazhdim i punes kualifikuese per titull Prof.dr. (S. Malo, S.Oruci, G. Paspali. M. Terpo)
- Vazhdim i punes kualifikuese per titull Prof.asoc (E. Hysaj, A. Qendro, A.Çomo).
- Përfundimi me sukses dhe fitimi i titullit Doktor (A. Como).
- Prezantime ne vazhdueshmeri te punes kerkimore dhe shkencore ne te gjitha aktiviteti e mundshme brenda dhe jashtë vendit.
- Gjate vitit 2022 u persos puna ne vazhdimin per permiresimin e kurikulave dhe te ligjeratave eshte zhvilluar nje pune shume e mire per hartimin e plote te programeve lëndore dhe te cikleve te leksioneve. Kjo pune eshte realizuar nga stafi i departamentit tone ne bashkepunim me pedagogë te ftuar nga Universiteti i Tiranës.
- Kualifikimi individual ka qene pjese e punes gjithe vjetor te stafit. Aktualisht nga 8 anetar qe ka departamenti 1 eshte prof, 4 jane prof asoc, 3 jane Dr. Pjese e veprimtarise vjetore ka qene dhe pjesmarrja aktive dhe pasive ne konferenca nderkombetare e kombetare brenda dhe jashte vendit si dhe botimi ne revista shkencore nderkombetare e kombetare e cila ka qene e planifikuar.
- Nje nga fushat e veprimtarisë kërkimore ku rezultatet janë manifestuar është botimi i punimeve kerkimore në fusha te ndryshme duke i prezantuar ne revista shkencore dinjitoze brenda dhe jashtë vendit, dhe kongrese nderkombetare. Kete vit numuri i artikujve dhe pjesmarrjes ne konferenca kombetare dhe n/kombetare nuk ka qene i kenaqshem, ndoshta kjo e ndikuar dhe nga shpenzimet e larta qe ato kane. Megjithate per tu rritur akoma dhe me tej niveli dhe cilesia e punes kerkimore dhe

shkencore duhet qe patjeter të gjenden rruge dhe mjetet e duhura financiare per ecurine pozitive te ketij aspekti. Nga ana e Pergjegjesit të Njesisë Bazë të Biologji-Kimisë eshte kerkuar nje mbeshtetje më praktike dhe me efikase nga ana e institucioni.

2. Aktivitet tjetër shkencor

- Rishikimi ne strukture dhe permbatje i programeve lëndore te disiplinave/moduleve qe perfshihen ne programet e studimit te ciklit te dyte (i gjithe stafi i departamentit)
- Ekspedita per hulumtime dhe grumbullim materiali kerkimor dhe zhvillim analizash laboratorike (stafi akademik).
- Kryerja e hulumtimeve dhe studimeve ne bashkepunim me studentet e programit Bachelor. Pergatitja per hulumtime dhe grumbullim materiali kerkimor dhe zhvillim seancash laboratorike online per lendet qe kane laboratore.
- Pjesëmarrja ne vazhdimet në projekte kërkimore kombëtare, por kjo kërkon dhe sigurim financimi te planifikuar nga sektori i kërkimit shkencor në rang universiteti.
- Njësia Bazë synon perfshirjen e studenteve ne grupe pune kerkimore per te qene pjese aktive e kerkimit universitar, kjo sidomos per studentet e programit te ciklit te dyte Master i Shkencave. Kjo do t'i shërbejë dhe per promovimin e veprimtarise se departamentit nepermjet pjesmarrjes ne diskutime mediatike, aktivitetet universitare dhe me gjere.
- Nderkohe një pjesë e mirë e stafit të fakultetit zhvillon procesin mësimor në programe të tjera studimi si në Ciklin e Ulët, Parashkollor. Në këto degë janë përmirësuar programet lëndore (syllabuset) dhe planet kalendarike. Por në tërësi realizimi i procesit mësimor ka akoma vend për përmirësime të mëtejshme cilësore dhe sasiore. Kështu në seancat ushtrimore dhe laboratorike studentëve duhet që t'u ofrohet literaturë dhe bazë materiale më e bollshme për demonstrime dhe përfitim shprehish pune, mos furnizimi në kohë deri ne mungese i të cilave, ka sjellë jo pak vështirësi. Ne fillim te vitit akademik janë organizuar veçanërisht në Departamentin e Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, diskutime per shfrytëzimin sa me te mire te bazes materiale laboratorike ne funksion te permbushjes se programit mesimor sa me cilesor. Kjo eshte pasqyruar ne menyren e organizimit te seancave laboratorike duke ndertuar seanca me fleksible ne permbatje dhe me te realizuara dhe ne kete menyre programi eshte bere me i prekshem nga studentet por dhe shumë më praktik. Oret e praktikave dhe ushtrimeve duhet te konceptohen variabël për tju përgjigjur nivelit të studentëve. Realizmi i praktikave laboratorike eshte organizuar dhe planifikuar si një proces mësimor më i detajuar me detyra studentore ditore dhe jo përfundimtare. Matja e punës në praktikë eshte bere me konkrete dhe kjo eshte realizuar falë pervojës së grumbulluar duke ju ofruar nje strukture shume me kompetitive dhe qe mundeson kontrollin indirekt te

punes se pavarur te studenteve. Kjo eshte gjetur si zgjidhje nga menyra e organizimit te praktikave me zhvendosje nga kontrolli direkt i stafit te pedagogeve.

Departamenti i Matematikës , Informatikës dhe Fizikes

1. Rezultatet e punës kërkimore shkencore:

- Gjatë vitit akademik 2021-2022 ka vijuar puna për perfeksionimin e ciklit të leksioneve në strukturë, përmbatje dhe mënyrën e realizimit të tyre si në auditore ashtu edhe në përdorimin e formave elektronike të mësimin, për disiplina të programeve të ciklit të parë Bachelor dhe të ciklit të dytë Master në Mësuesi.
- Përmirësimi i programeve mësimore është zhvilluar tërësisht konform kërkesave të udhëzimeve dhe ligjeve përkatëse.
- Kualifikimi individual, që ka të bëjë me përfshirjen e personelit sipas statusit të kualifikimit në procesin e avancuar të formimit profesional të tyre përkatesisht në doktoraturë, dhe fitimin e titujve akademik *Prof.asoc* dhe *Prof.*
- Kualifikimi individual ka qënë pjesë e punës vjetorë të stafit. Aktualisht nga 10 anëtarë të stafit akademik të Departamentit, 3 janë *Prof.asoc*, 3 janë *Doc.Dr*, 2 janë *Dr.*, 2 janë *M.Sc* (në pritje të pranimit në shkollëne doktoraturës).
- Pjesë e veprimtarisë vjetore ka qënë dhe pjesëmarrja aktive (me prezantime) dhe pasive në konferenca ndërkombëtare e kombëtare brenda dhe jashtë vendit si dhe botimi në revista shkencore ndërkombëtare e kombëtare.

2. Aktiviteti Kualifikues.

- Vazhdim i punes kualifikuese për titull *Prof.* (K.Naka, K. Zoto,)
- Vazhdim i punes kualifikuese për titull *Prof.Asoc.* (Dh. Terpo, A. Isufati, R. Mano, A. Sinani, I. Kokalari)
- Në pritje për regjistrim dhe fillim të studimeve në shkollën e doktoratës (K.Lili, I. Bilo).

3. Aktivitet tjetër shkencor

Ka vazhduar veprimtaria si anëtar bordesh editoriale në periodikë brenda vendit:

- Bordi Editorial “Kërkime Universitare”: seksioni “Matematika dhe Shkencat e Natyres”.
- Bordi Editorial “International Journal of Mathematical, Engineering, Biological and Applied Computing”
- Revieëer “Journal of Social Mathematical & Human Engineering Sciences”
- Bordi Editorial “Mathematics and Statistics” (Horizon Research Publishing USA)
- KomitetitshkencorikoferencësNdërkombëtare “Innovations in Science and Education” March 16, 2022, Prague, Czech Republic.

- Anëtarë të departamentit janë dhe anëtarë Komisionet e Provimeve të Shtetit në profesionet: “Mësues në Matematikë Informatike” dhe “Mësues në Informatikë”.
- Pjesëmarrje në projekte dhe trajnime të stafit akademik: Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës ka vazhduar të implementojë si partner, projektin ndërkombëtar Erasmus+ TECOMP. Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

4. Synimet për të ardhmen(vitin akademik 2022-2023) në kuadër të veprimtarisë kërkimore:

- Vazhdimin e punës për përmirësimin në mënyrë sa më shkencore dhe bashkëkohore të cilësisë së përmbatjes së leksioneve
- Pjesëmarrja në vazhdimësi në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Vazhdimi më me intesitet të studimeve dhe botimeve sipas fushave përkatëse të punimeve shkencore në revista prestigjioze brenda dhe jashtë vendit.
- Ndjekja në vijueshmëri e procesit të kërkimit shkencor sipas planeve të aktivitetit të hartuar nga secili pjestar i stafit.
- Megjithatë i gjithë stafi i departamentit është në një proces të vazhdueshëm pune kërkimore me kërkime, analiza, pjesëmarrje në konferenca shkencore, botime në periodikë shkencorë, referime, etj në do të synojmë që puna kërkimore, krijuese e tyre të jetë sa më aktive duke ju mundësuar kushte sa më të përshtatshme
- Do të synojmë që stafi të motivohet për tu përfshirë sa më shumë në projekte lokale, rajonale, ndërkombëtare, individuale apo në bashkëpunim të kërkimit shkencor.
- Do të synojmë përfshirjen e studentëve në grupe pune kërkimore për të qënë pjesë aktive dhe vijueshmërie e kërkimit universitar, kjo sidomos për studentët e programeve të ciklit të dytë.
- Do të synojmë gjetjen e rrugëve efikase për promovimin e veprimtarisë së departamentit nëpërmjet pjesëmarrjes, aktiviteteve universitare dhe më gjerë.

Departamenti i Infermierisë

Ky vit ka qënë viti i diplomimi të brezit tëdytë të studentëve të programit të studimit të ciklit të dytë “Master profesional në shkencat infermiore”. Në këtë aspekt stafi akademik po vazhdon punën për të përmirësuar bazën didaktike shkencore (ciklet e leksione) për të qënë sa me koherent me informacionin.

1. Aktiviteti Kualifikues.

- Vazhdim i punës kualifikuese për titullin Prof. (M. Agolli)
- Vazhdim i punës kualifikuese për titull Prof.Asoc (Z. Vllaho, L. Mezini, Gj. Semini)
- Vazhdimi i punës në kuadër të disertacionit të doktoratës (D. Rami, Zh. Graçi)
- Në pritje për regjistrim dhe fillim të studimeve në shkollën e doktoratës (A. Xhemali, M. Llavdaniti, P. Barjami, B.Late).
- Kualifikimi individual ka qënë pjesë e punës vjetore të stafit. Nga 11 anëtarë të stafit akademik te Departamentit për vitin akademik 2021-2022, 1 është Prof.asoc, 1 është Doc.Dr, 1 është Dr, 1 është PhD, 1 është Master Ekzekutiv (në pritje të pranimit në shkollën e doktoratës), 1 është mjek me Specializim Afatgjatë (në pritje të pranimit në shkollën e doktoratës), 2 janë në fazën përmbyllëse të doktoratës dhe 3 janë M.Sc (në pritje të pranimit në shkollën e doktoratës).

2. Aktivitet tjetër shkencor

- Pjesë e veprimtarisë vjetore ka qënë dhe pjesëmarrja aktive në konferenca ndërkombëtare e kombëtare (kryesisht online) brenda dhe jashtë vendit si dhe botimi në revista shkencore ndërkombëtare e kombëtare.

Probleme të evidentuara nga analizat me departamentet e FSHN

- Të shikohet mundësia e financimit të pjesëmarrjes së pedagogëve në konferenca të ndryshme ndërkombëtare apo botimeve shkencore në revista të njohura.
- Rritja e aksesit online në revista të specializuara me abonim dhe financimi i kërkimit shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte kombëtare apo ndërkombëtare. Kjo lidhet ngushtë edhe me sigurimin e fondeve për investime kapitale, sepse siç dihet pajisjet kërkimore kërkojnë burime financiare të larta, veçanërisht për labororet didaktike e kërkimore të Biologji-kimisë dhe Fizikës. Në këtë aspekt ka ndikuar pozitivisht (edhe pse jo në masën e pretenduar) frekuentimi / shfletimi i bibliotekës digjitale <https://ulibrary.rash.al/> nga ana e stafit akademik dhe studentëve të UGJ.
- Nje problem eshte dhe organizimi i provimeve dhe riprovimeve ne programin e studimit te master profesional Biologji Kimi, ku dhe rregullorja e tyre nuk eshte pasqyruar sakte duke krijuar veshtiresi organizimi dhe mbarevatje te procesit.
- Per te finalizuar rezultatin e punes mesimore do te duhej nje informacion i detajuar mbi nivelet e kalueshmerise dhe te cilesise per te cilat duhej qe sekretaria mesimore te prodhoj ne fund te vitit akademik nje raport informacioni.

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PËR AKTIVITETIN KËRKIMOR - SHKENCOR
TË PERSONELIT AKADEMIK
TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS
(Viti Akademik 2021-2022)

Nr.	Emertimi I zerave	Nen/zerat	Sasia ne n/zera	Sasia ne total	Verejtje
1.	Artikujshkencore	Brenda vendit	6	21	3 ne process botimi
		JashteVendit Me FaktorImpakti	7		
		Pa faktorImpakti	8		
2.	Referime ne Konferencashkencore	Kombetare	1	8	
		Nderkombetare	7		
3.	Referime ne Konferenca te botuara ne Proceedings	Kombetare	0	8	
		Nderkombetare	8		
4.	Tekste universitare				
5.	Tekste parauniversitare				
6.	Tekst-maket universitar		6	6	
7.	Cikleleksionesh		12	12	
8.	Monografi				
9.	Udheheqjeshkencore	Doktorature			
		Master Shkencor/Profesional			
		Diplome Bachelor			
10.	Oponence	Bachelor, Master/Profesional&Shkencor			
		Doktorature			
11.	Pjesmarrje ne aktivite shkencore (pa referim)	Konferenca			
		Workshope			
		Seminaretj.			
12.	Leksione te hapura ne UGJ / Universitete te tjera				
13.	Trajnimistafitakademik				
14.	Trajnimetemesuesve		3	3	
15.	Aktivite te organizuar ne UGJ		6	6	
16.	Aktivite te organizuar me aktore te tjere(university, gendra kerkimi dhe locale)				
17.	Plane mesimore	Hartimetereja (aplikim)	1		
		Permiresime			
18.	Programe mesimore	Hartime te reja			
		Permiresime			
19.	Artikuj shkencore ne publicistike	Ne revista e gazeta shkencore			
20.	Pjesmarrje ne projekte		7	7	
21.	Studente te perfshire ne projekte, etj				
22.	Analizashkencore (re-vieë)				
23.	Pjesmarrje ne borde editorial periodikesh	Brenda vendit	3		
		Jashtevendit	4		
24.	Recensa shkencore per artikuj shkencore	Brenda vendit			
		Jashtevendit			
25.	Artikujshkencorederguar per botim ne procesrecense	Brenda vendit	3	7	
		Jashtevendit	4		
26.	Pjesemarresaktive ne rrjetetnderkombetareteinstitucionevetekerkimimdhezvillimit				
27.	Pjesmarrje ne Juri vleresimi	Ne Juri Doktoratash (Oponente)	1	1	
28.	Studime Postdoktorale	Jashte vendit			
29.	Tituj dhe grada te fituara (ose ne proces)	Profesor		4	
		Prof.asoc.	1		
		Dr. (ne process)	3		
		Docent			
		Master			

Krahas punës për zhvillimin me korrektësi dhe cilësi të mësimdhënies, personeli akademik i FSHN i ka kushtuar një vëmendje mjaft të madhe veprimtarisë kërkimore-shkencore (individuale dhe në grup) me qëllim kualifikimin e mëtijshëm shkencor.

Veprimtaria kerkimore-shkencore si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të departamenteve të FSHN është përqëndruar në këto drejtime:

- Paraqitja e arritjeve të punës kërkimore nëpërmjet botimeve në revista shkencore apo referimeve në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- Zhvillimi i kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe ligjit të arsimit të lartë.
- Pjesëmarrja në veprimtari jashtë universitare të lidhura me performancën shkencore.

2. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE E FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE (VITI AKADEMIK 2021-2022)

Gjatë vitit akademik, FESHSH organizoi dhe realizoi etapën përfundimtare të punës, përse i përket 4 (katër) projekteve ndërkombëtare:

A. NJBEMM , në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës ka vazhduar aktivitetet me partnerët e projektit.. Universitet leader, Universitetin e Nis (Serbi). CALL FOR PROPOSALS 2018 – EAC/A05/2017 - Erasmus+ Programme (2017/C 361/04)

Titulli: Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences

Project Partner: UNIVERSITY OF NIS Serbia Partner Countries, UNIVERSITY OF BELGRADE Serbia Partner Countries , UNIVERSITY OF NOVI SAD Serbia Partner Countries, UNIVERSITY OF KRAGUJEVAC Serbia Partner Countries, EQEREM CABEJ UNIVERSITY GJIROKASTER Albania Partner Countries, FAN S. NOLI UNIVERSITY KORCE Albania Partner Countries UNIVERSITY OF OVIEDO Spain Programme Countries, MATEJ BEL UNIVERSITY BANSKA BYSTRICA Slovakia Programme Countries, GHENT UNIVERSITY Belgium Programme Countries, UNIVERSITY OF GRANADA Spain Programme Countries, UNIVERSITY OF OSTRAVA Czech Republic

Pozicioni: Dr. Doc. Mimoza ÇARKA; Dr. Loreta MAMANI, pjesëmarrës në grupin e punës.

Krahas trajnimeve nga ky project u përgatitën cikle leksionesh me karakter pedagogjik dhe psikologjik, duke u fokusuar kryesisht me teknikat dhe metodat më të suksesshme të universiteteve partnere. Pasurimi I kurrikulave me këto elemente ishte një nga realizimet e objektivave.

Materiali i përshtatur për kurrikulat e IAL: TeComp: Forcimi i kompetencave të Mësimdhënies, kompetencat dixhitale dhe pedagogjike.

B. ENTR-AL Entrepreneurial skills for a modern education in Albania

Project No: 617886-EPP-1-2020-1-FI-EPPKA2-CBHE-SP

Pozicioni: Dr. Doc. Mimoza ÇARKA; Dr. Loreta MAMANI, pjesëmarrës në grupin e punës.

C. Aplikim për një projecte kombëtare nga NJBEMM.

NJBEMM me drejtuese projekti Prof.asoc. Mimoza Çarka fiton një Project kombëtar me fondet e Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë me titull: “Ndikimi i personalitetit dhe disiplinës pozitive në orientimin e karrierës tek nxënësit , në Qarkun e Gjirokastrës”

D. Në bashkëpunim me NJB GJLQG është fituar projekti “Aplikimi i metodave evropiane në zhvillimin në degë të ndryshme”. , I cili u aplikua në kuadër të urdhërit të MAS , nr. 4360 prot. Datë 28.06.2022 “Për zhvillimin e infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore të IAL-ve publike, në kuadër të marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e vendeve të BE-së dhe të tjerë.

-Pjesëmarrje në projekte të mobilitetit (Erasmus 2020-2022). Departamenti i Gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit grek, ka zgjeruar bashkëpunimin e tij me struktura analoge në universitete të ndryshme në Greqi dhe Qipro si psh, me Universitetin e Janinës, të Kozanit, të Patrës, të Kretës, të Komotinisë etj në Greqi, Universiteti i Hapur dhe publik në Qipro, apo me fondacione të tilla si “Onasi” Greqi, “Leventis” në Qipro, në financime projektesh nga burime të tjera private. Përfaqësimi i Departamentit në organizime ndërkombëtare për arsimin dhe kulturën greke etj.

Valbona Duri: Angazhim në projekte **KA2** :

- Prof.asoc. Valbona **DURI, koordinatorë institucionale për projektin QUADIC (2020-2023)**, Erasmus +.
- Angazhim si staf akademik në projektin Erasmus + , **ENTRAL**.
- Angazhim si staf akademik në projektin Erasmus +, **BKSTONE**

Angazhim në projekte **KA1**:

- Trajnim si staf akademik në Universitetin “ Aristoteli”, Selanik gjatë periudhës 30/05 – 03/06 2022.

Xhuliana Zdrava: Projekti “Sustainable economic tourism – the keys of Gjirokastra Municipality” – periudha Dhjetor 2023 dhe në vazhdim. Financuar nga RESEARCH EXPERTISE FROM THE ACADEMIC DIASPORA (READ).

Taci J. Leksion i mbajtur ne projektin “**BKSTONE TESTING COURSES – Balkan Stone Course on Placement and VET**”, 16-18 Maj 2022.

-Fjorentin Ismaili:

1. Projekti ndërkombëtar: “Rrjetit Lokal për Turizmin Kulturor Kreativ dhe Inovativ” – periudha Nëntor 2022-Qershor 2023. Mbështetur nga UNOPS. Pjesëmarrje si specialist turizmi.
2. Projekti “TourAZZO: Promovimi dhe rritja e vlerës së trashëgimisë kulturore si nxitëse e turizmit dhe zhvillimit social-ekonomik në Durrës” – periudha Nëntor 2022-Qershor 2023. Financuar nga Bashkimi

Evropian në kuadër të programit EU4Culture, të zbatuar nga UNOPS dhe në koordinim me Ministrinë e Kulturës. Pjesëmarrje si specialist turizmi.

3. Projekti “Sustainable economic tourism - the keys of Gjirokastra Municipality” – periudha Dhjetor 2023 dhe në vazhdim. Financuar nga RESEARCH EXPERTISE FROM THE ACADEMIC DIASPORA (READ).

Sinani A. “HIGHER EDUCATION – ENTERPRISE PLATFORM FOR FOSTERING, MODERNIZATION AND SUSTAINABLE GROWTH IN NATURAL STONE INDUSTRY IN WESTERN BALKAN. BKSTONE NATIONAL WORKSHOP, 10 Maj 2022.

Sinani A. Leksion i mbajtur ne projektin “BKSTONE TESTING COURSES – “AN INTRODUCTION TO STONE AS A BUILDING MATERIAL AND ITS APPLICATION IN DIFFERENT PHASES OF CONSTRUCTION” Balkan Stone Course on Placement and VET”, 16-18 Maj 2022.

Informacion mbi kërkimin shkencor në FESHSH ose mbi projekte kur merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:

i) Politikat e kërkimit shkencor;

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në fushat e studimit dhe të kërkimit shkencor ndjek një strategji, e cila është në funksion të zbatimit të politikave tërësore të universitetit dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Strukturat përgjegjëse, për realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore-kërkimore kanë mbështetur kërkimin shkencor, si me kapacitetet të logjistikës që zotërojnë, ashtu edhe përmes nxitjes apo llogaridhënies, për pjesëmarrjen aktive të stafit akademik dhe të studentëve, në projekte kërkimore-shkencore, studime, konferenca etj. Pavarësisht nxitjes dhe ndihmesës, që kanë dhënë organet dhe autoritetet drejtuese, peshën bazë të këtij kërkimi shkencor, në rang fakulteti e kanë përbërë dhe e përbëjnë njësitë bazë dhe grupet mësimore-kërkimore.

Për faktin që këto shpenzime do të mbulohen tërësisht nga të ardhurat dytësore, është planifikuar një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2023. Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për çdo zë pasi jemi në këtë situatë, ku kemi trashëguar një sasi tepër të vogël të adhurash krahasuar me vitet e mëparshme dhe radikalizimi në tërësi i limiteve të përdorimit të të ardhurave, i cili do të çojë në trashëgimin e një rezerve shumë të vogël të të ardhurave. Duke qnë se Institucioni ndodhet ne një situatë të vështirë financiare kemi planifikuar në shifra reale.

Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për çdo zë si më poshtë:

1. Në zërin kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati etj...është parashikuar nga përllogaritjet në vlerën 5.670.000 lekë.
 - a) për pagesat e anëtarëve të Senatit Akademik (për nëntë muaj),
 - b) për pagesat e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj).

Në zërin kosto të seancave të Bordit të Adiministrimit dhe të Senatit Akademik kemi parasysh se numri i senatorëve është 21 anëtarë ndërsaumri i antarëve të Bordin e Administrimit është 7.

2. Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore është planifikuar një vlerë prej 2.000.000 lekë nisur nga rekomandimet e grupit të ekspertëve për akreditim. U pa e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore me impakt universitar për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, qytetit dhe të Rajonit të Jugut e gjitha

kjo mbështetur në nenin 99, pika 6 të ligjit nr.80/2015 "Per Arsimin e Larte dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

3. Në zërin Diploma studenti parashikohet në vlerën prej 960.000 lekë. Kjo vlerë është planifikuar nisur nga numri i studenteve si dhe kërkesat e viteve të mëparshme.
4. Në zërin akreditimi i programeve mësimore kemi planifikuar në vlerën prej 3.200.000 lekë si rezultati rekomandimeve të lëna nga grupi i akreditimit.
5. Në zërin energji, si shpenzim me karakter tarifor është parashikuar një vlerë prej 2.000.000 lekë për ambjentet ekzistuese
6. Në zërin ujë përsëri si shpenzim me karakter tarifor është planifikuar në vlerën 200.000 lekë por duke pasur parasysh se, në qoftë se do të duhen fonde në vazhdim do të alokojmë sipas nevojave.
7. Për zërin telefon parashikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas vkm-së nr.864 datë 23.07.2010 "Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik" të ndryshuar, ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përllogaritet në total 500.000 lekë vlerë e cila nuk e tejkalon 2% e vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, siç kërkohet në këtë vendim. Nga praktika e viteve të kaluara ka rezultuar se ky fond nuk konsumohet totalisht pasi nga punonjësit përfitues të këtij shërbimi nuk konsumohet e gjithë vlera mujore e përcaktuar për secilin.
8. Në zërin Shërbimi postar, parashikohet në vlerën 115.000 lekë për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.
9. Në zërin abonim për shërbim interneti kemi planifikuar në vlerën prej 120.000 lekë duke pasur prioritet shërbimet që ofrohen nëpërmjet internetit.
10. Në zërin dezinfektimi i ambjenteve kemi planifikuar në vlerën prej 40.000 lekë duke pasur parasysh situatën disi të përmirësuar prej pandemisë nga Covid -19 *(edhe këtu mund të shtesë të fondeve në varësi të situatës që mund të krijohet si pasojë e pandemisë)*.
11. Në zërin sigurimi i detyrueshëm i mjeteve kemi planifikuar në vlerën prej 192.000 lekë kemi parasysh siguracionin vjetor faktik si dhe ndryshimet që mund të ndodhin gjatë vitit 2023.
12. Në zërin rimbushje fikse zjari kemi planifikuar në vlerën prej 120.000 lekë për rimbushjen e fikseve të zjarit.
13. Në zërin aktivitete shkencore, kumtesa të ndryshme, kërkime shkencore, konferenca kombëtare, veprimtari lokale, projekte etj kemi planifikuar 3.000.000 lekë për ti dhënë përparësi kërkimit shkencor, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare .
14. Në zërin shërbime të printimit dhe publikimit parashikohet në vlerën prej **120.000** lekë. Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;
 - a) rritjen e numrit të studentëve.
 - b) rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit të Gjirokastrës dhe më gjerë.
 - c) rritjen e kontributit në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

Do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e një periodiku "Kërkime Universitare" për vitin 2023, fletpalosje etj. Gjithashtu kemi planifikuar këtë vlerë pasi mund të kemi bashkëpunime me institucione të ndryshme për zhvillimin e konferencave shkencore si dhe për t'i paraprirë vështirësisë financiare të ekzekutimit të këtyre shpenzimeve planifikojmë

mbi eksperiencat e viteve të kaluara, me qëllim mos pengimin e bashkëpunimit të institucionit tonë me partnerë të tjerë, apo edhe promovimeve institucionale të paparashikuara më parë.

15. Në zërin kosto reklamimi dhe publikimi kemi parashikuar vlerën prej 300.000 lekë.

Një vëmendje e veçantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- a) rritjen e numrit të studentëve.
- b) rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit të Gjirokastrës dhe më gjerë.
- c) rritjen e kontributit në jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

16. Në zërin Kancelari, bojra **parashikohet** në vlerën përkatësisht nga **1.200.000 lekë** për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera etj. Një peshë të konsiderueshme zënë tonerat e printerave dhe fotokopjuesve të cilat kanë një kosto të lartë në treg. Në çdo Njësi Bazë kemi si printera (ku në çdo Njësi Bazë përbëhet nga një numër i konsiderueshëm staf akademik) ashtu edhe fotokopjues. Gjithashtu edhe zyrat e administratës janë të paisura me printera e fotokopje për të cilat duhet të planifikojmë disa bojra në vit në varësi të kërkesave si dhe volumit të punës që ka çdo zyrë.

17. Në zërat e tjerë parashikohet në vlerat si më poshtë :

Materiale pastrimi 700.000 lekë, mirëmbajtje kompjuterike, fotokopjuesish e printerash 120.000 lekë, materiale hidraulike, elektrike e ndërtimi 500.000 lekë, mirëmbajtje kondicioner 120.000 lekë. Krahasimisht me vitin 2022 është parashikuar në këtë vlerë pasi jemi përpjekur të reduktojmë në maksimum shpenzimet.

18. Në zërin mirëmbajtje mjete transporti: parashikohet në vlerën prej 400.000 lekë. Ashtu si edhe më parë peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve siç edhe ju kemi vënë në dijeni e zë automjeti i tipit furgon pasi është blerë prej vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit për shkak të vjetërsisë dhe përdorimit të shpeshtë. Me të ardhurat që realizon institucioni, nuk mund të planifikohet blerja e një mjeti të ri, pasi edhe nga vlerësimi i tregut për blerjen e këtyre mjeteve të transportit do të ketë një kosto të konsiderueshme, shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij. Në këto kushte planifikojmë vetëm për mirëmbajtjen e mjeteve që kemi aktualisht (*planifikuar nga buxheti i shtetit*). Gjithashtu është planifikuar edhe për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të transportit si dhe taksat vjetore në vlerën prej 192.000 lekë.

19. Në zërin Sistemim dhe blerje materiale për ambjentet e jashtme parashikojmë në vlerën prej 400.000 lekë. Planifikohet në këto vlera për mirëmbajtjen në vazhdimësi të ambjenteve të jashtme

20. Në zërin dieta brenda e jashtë vendit (bileta avjoni), ekspedita është parashikuar në një vlerë totale prej 2.460.000 lekë, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme, si dhe për praktikat mësimore të studentëve. Këto praktika do të planifikohen të bëhen në terren, duke përballuar lëvizjen e studentëve jashtë qytetit me transport urban dhe pagesë hoteli për akomodimin e tyre në rast se do të ketë intenerare të tilla.

21. Në zërin shërbime të ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim,etj) kemi parashikuar vlerën prej 300.000 lekë .Kemi planifikuar këtu për shpenzimet bankare dhe pjesa tjetër parashikohet për kryerjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike (të mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjeno-

sanitare), hostim të faqes së UGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifikisht për një vit buxhetor.

22. Në zërin Shpenzime për pritje përcjellje kemi planifikuar një fond prej 500.000 lekë duke marrë parasysh edhe shpenzimet në vitet e mëparshme në Universitet.

23. Në zërin karburant parashikohet në vlerën prej 4.320.000 lekë, nisur kjo nga:

1. sasia e karburantit që kemi gjendje,
2. krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve, duke ju përgjigjur edhe kërkesave të studentëve për ngrohje,
3. sasia e nevojshme për mjetet e transportit,
4. situata ekonomike e tanishme.

24. Në zërin "Ilaçe dhe materiale laboratorike për bio-kiminë" parashikohet në vlerën 288.204 lekë. Është bërë parashikimi nga eksperiencia e viteve të kaluara dhe kërkesave të njësive bazë, për të përballuar nevojat për produkte mjekësore gjatë zhvillimit të praktikave në terren si dhe materiale të tjera për zhvillimin e punës laboratorike në funksion të procesit mësimor si nga Njësia Bazë e Infermierisë ashtu edhe nga Njësia Bazë i Biologji-Kimisë.

25. Për zërin "Trasferta të jashtme" 605 , parashikohet në vlerën prej 500.000 lekë për arsye të aderimit të institucionit në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit, porë kjo si një domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit në të ardhmen. Kemi planifikuar abonime të cilat kanë qënë të përvitshme dhe janë konsideruar prestigjoze për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhornimin me literaturë bashkohore të stafit akademik, për zhvillimin e karrierës së mëtejshme të tyre. Abonimi në organizatën Universitare Ndërkombëtare "International Association of Universities " në vlerën 1.700 Euro prej shumë vitesh, ku kemi edhe të drejtë votimi për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa për antarësimin e Departamentit të Matematikës të Universitetit në periodikun Ndërkombëtar "Springer", në vlerën 367.5 €.

Kemi parashikuar edhe abonimin në ëbsite <http://ëëë.tradingeconomics.com/analytics>, ku vlerësohet nga Njësia Bazë si një database i plotësuar me informacione ekonomike, shkencore të të gjitha fushave dhe që mund të përdoret nga të gjithë antarët e personelit akademik të Universitetit dhe jo vetëm nga Departamentet e Ekonomikut në vlerën 2.000 euro në vit. Nëse gjatë vitit pranë zyrës së Administratorit do të paraqiten kërkesa nga Departamentet për abonime të tjera, ato do të trajtohen me përparësi.

3-INVESTIME

Fonde për investime nga të ardhurat dytësore janë planifikuar në vlerën prej 12.320.000 lekë nga të ardhurat dytësore të ndarë sipas zërave jepen në tabelën e mëposhtme :

Nr	Objekti i Prokurimit	Investime
1	Libra për bibliotekën dhe për studentët	3.120.000
2	Blerje kondicionere	1.200.000
4	Rikonstruksion i ambjenteve dhe blerje pajisje	8.000.000
	Totali i investimeve	12.320.000

3. INVESTIME

1. Në zërin libra për bibliotekën dhe studentët është parashikuar blerja e një sasie librash për bibliotekën që do t'ju shërbejë stafit akademik dhe studentëve në vlerën prej 3.120.000 lekë. Rritja e fondit të librave përmbush edhe një nga rekomandimet e lëna nga grupi i ekspertëve të akreditimit institucional.
2. Në zërin blerje aparate kondicionere planifikohet një fond prej 1.200.000 lekë për blerje kondicionerë sipas kërkesave dhe nevojave të Njësitë Bazë si dhe strukturave të tjera të institucionit.
3. Në zërin rikonstruksioni godinave parashikohet një fond prej 8.000.000 lekë për mirëmbajtjen e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme.

Në total, për vitin 2023 planifikojmë në projekt buxhetin e institucionit në shumën prej 377.056.000 lekë, nga të cilat 287.395.000 lekë janë nga buxheti shtetit dhe 89.661.000 lekë janë nga të ardhurat e institucionit. Gjatë hartimit të projektbuxhetit të Ugj-ë kemi pasur si prioritet përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, jetës akademike, mbështetjes studentore, aktiviteteve të ndryshme dhe promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

PARASHIKIMI I ZËRAVE BUXHETORE PER VITIN 2023

Nr	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria Ekonomike	Viti 2023	Viti 2023	
			Total	Në mijë lek	
I	Granti dhe të Ardhura		Në mijë lek	Buxhet	Ardhura
	Paga personeli,ore supelementare,orë Part Time	600+604	260,281	234,960	25,321
	Sigurime shoqërore	601	27.521	27.521	0
A	SHUMA	600 + 601	288.502	263.181	25.321
	Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit.	602	31.045	0	31.045
	Trasferte për pjesëmarrje në konferenca	605	500	0	500
B	SHUMA	602+605	31.545	0	31,545
C	Bursa për studentët	606	14.500	14.500	0
D	Invstime nga te ardhurat (rikonst,print,kondic, Librat)	231	32.795		12.320
	Granti , investime		24.789	24.789	0
	(Projket,Superviz.,kolaudator,leje)	230	5.400	5.400	
E	Shuma investime granti230+231	230+231	42.509	30.189	12.320
	TOTALI		377.056	307.870	69.186
	Kërkimi shkencor	230	480	480	0

Duke u mbështetur në bazën ligjore të cituar në krye të materialit si dhe në strategjinë e Universitetit, puna jonë do të konstistojnë në :

1. Rritjen e cilësisë së mësimdhënies;
2. Ritjen e impaktit të Institucionit në rajon dhe më gjerë.

duke vendosur prioritete bazuar edhe në kërkesat e strukturave përkatëse për të krijuar kushte për realizimin e objektivave. Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj jemi në pritje të miratimit të projekt buxhetit.

- **PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2021.**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit Nr.137 datë 16.11.2020 “ Për Buxhetin e Vitit 2021” ; Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MASR dhe M.F.E “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”,propozojmë detajimin e buxhetit në total për vitin 2021. Fondet e akorduara nga ana e M.AS.R-së në formë “Granti të Mësimdhënies për vitin 2021”, në grupin e shpenzimeve korente janë në vlerën prej **168.647.232** lekë.Këto fonde janë miratuar nga ana Juaj si më poshtë:

I SHPENZIME NGA BUXHETI I SHTETIT 2021

1-Pagat.Për stafin akademik dhe personelin mbështetës planifikohet fond page në vlerën prej **138.802.182** lekë kjo nisur nga realizimi i vitit 2020 në mbështetje të VKM-së Nr. 268 datë 29.03.2017, “Për disa ndryshime në VKM. Nr.748 datë 11.06.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit Akademik të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, i ndryshuar”, të VKM-së Nr. 329 datë 11.05.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", të VKM-së Nr. 187 datë 08.03.2017 "Per miratimin e strukturës së pagave të nëpunësve civilë ,nëpunësve ... në institucionet në varësi të ministrave të linjës ", të VKM-së Nr. 202 datë 15.03.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe disa institucioneve buxhetore " të ndryshuar dhe të udhëzimeve përkatëse. Ky planifikim është bërë duke patur parasysh faktet si më poshtë :

- strukturën organike aktuale,
- numrin e pedagogëve sipas të titujve që mbajnë aktualisht, si dhe kualifikimet e mundshme të tyre me studime pasuniversitare ,
- ndryshimet e mundshme në strukturë,

2-Sigurime shoqërore. Sipas ligjit në fuqi për “Sigurimet Shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, vlera vjetore e këtyre kontributeve e llogaritur (16.7% të fondit të pagës) planifikohet fond prej **27.443.990** lekë.

3-Bursat e studentëve. sipas V.K.M.-së nr. 903 datë 21.12.2016"Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar me V.K.M. Nr. 450, datë 22.5.2017 i ndryshuar me V.K.M. Nr. 697, datë 21.11.2018 i ndryshuar me V.K.M. Nr. 784 datë 26.12.2018 e V.K.M. Nr. 755 datë 30.11.2019 planifikohet fondi në vlerën prej **2.401.060** lekë.

Për të planifikuar buxhetin në total si me fonde nga buxheti ashtu edhe me fonde nga të ardhurat , propozojmë që fondet e akorduara nga Buxheti ti lemë sipas zërave të cituar më lartë dhe pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIME NGA BUXHETI I SHTETIT 2021	
Paga	138.802.182
Sigurime shoqërore	27.443.990
Bursa	2.401.060
TOTAL	168.647.232

Nga viti 2020 janë trashëguar fonde nga Buxheti i shtetit sipas zërave:

- 1-Në zërin sigurime shoqërore në vlerën prej **2.056.010 lekë**
- 2- Në zërin transferime korrente jashtë shtetit në vlerën prej **232.913 lekë,**
- 3- Në zërin bursa për studentët në vlerën prej **1.356.036 lekë.**
- 4- Në zërin transferime tek 604 në vlerën prej **60 lekë.**

Në total për vitin 2021trashëgohen **3.645.019** lekë.

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit në 2021 së bashku me fondet e trashëguara për vitin 2021 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme :

SHPENZIME NGA BUXHETI I SHTETIT NË TOTAL	
Paga	138.802.242
Sigurime shoqërore	29.500.000
Bursa	3.757.096
Transferime me jashte shtetit	232.913
TOTAL	172.292.251

Duke krahasuar realizimin e zërave të buxhetit të vitit 2020, me buxhetin e akorduar për vitin 2021, vërejmë se ky fond është i pamjaftueshëm. Ky fakt na imponon që pjesën tjetër të shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin normal të Institucionit ti planifikojmë nga të ardhurat.

Për zërin “Trasferta të jashtme” 605, planifikohet një fond prej **232.913** lekë për arsye të aderimit të institucionit tonë në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit, parë kjo si një domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit në të ardhmen. Kemi planifikuar dy abonime të cilat kanë qënë të përvitshme dhe janë konsideruar prestigjoze nga ana jonë për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhurnimin me literaturë bashkohore të stafit akademik, për zhvillimin e karrierës së mëtijshme të tyre. Abonimi në organizatën universitare ndërkombëtare “International Association of Universities” në vlerën 1500 Euro prej shumë vitesh, ku kemi edhe të drejtën e votimit për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa për abonimin në rrjetin MathSciNet të Njësisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës të Universitetit apo edhe për abonime të tjera që mund të kemi në vazhdim.

II - Propozime për shtim fondi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2021.

Duke patur parasysh nga njëra anë se fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit në Universitet nuk plotësojnë nevojat e këtij Institucioni kërkohet dhe është më se e nevojshme akordimi i fondeve shtesë në të kundërt rrezikohet seriozisht aktiviteti administrativ i Universitetit. Buxheti i akorduar në vitin 2021 është në vlerën prej 168.647.232 lekë. Krahasuar me buxhetin e vitit 2020 i cili ishte në vlerën prej 198.695.478 lekë rezulton se fondi i vitit 2021 është më pak fonde 30.048.246 lekë.

Nga ana tjetër duke parë nevojat e institucionit dhe të ardhurat që planifikojmë të krjohen në 2021 ku egziston risku i realizimit propozojmë që Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të drejtohen MASR-së për të akorduar fonde shtesë nga buxheti i shtetit në vlerën 7.708.803 lekë për bursat e studentëve dhe 29.618.981 lekë për paga. Në total të kërkohet fond shtesë 37.327.784 lekë. Prandaj propozojmë për miratim fondet që janë akorduar dhe ato që planifikojmë që të krijohen dhe në një moment të dytë planifikojmë fonde të tjera sipas situatës dhe bëjmë korrigjimet përkatëse, pasi të marrim përgjigje nga MASR veprimet.

III-SHPENZIME NGA TË ARDHURAT DYTËSORE TË INSTITUCIONIT.

Të ardhurat e trashëguara dhe ato që do të krijohen gjatë vitit 2021 planifikohen për paga,bursa, investime e shpenzime operative.Planifikimi i tyre ka pasur si prioritet hartimin e buxhetit sa më real dhe përfaqësues për të gjitha njësitë e Universitetit,sipas tabelës së mëposhtme:

SHPENZIME TË DOMOSDOSHME TE INSTITUCIONIT	
Paga	62.000.000
Shpenzime operative	36.003.757
Studime projektme investime	22.826.460
Bursa për studentët	7.708.803
TOTAL	128.539.020

Vlera e planifikuar për përdorim nga të ardhurat për vitin 2021 është **128.539.020 lekë**.

SHPENZIME TË MBULUARA ME FONDE TE INSTITUCIONIT	
Paga	32.381.019
Shpenzime operative	36.003.757
Studime projektme investime	22.826.460
TOTAL	91.211.236

Pasqyrojmë në formë analitike situatën konkrete të të ardhurave me qëllim planifikimin e saktë të shpenzimeve të vitit 2021.

Në vitin 2020 realizimi i të ardhurave është **33.298.983** lekë.

Nga viti 2019 u trashëguan **63.085.552,77** lekë të ardhura .

Gjatë vitit 2020 janë përdorur **68.094.482** lekë nga të ardhurat .

Nga viti 2020 për vitin 2021 janë trashëguar fonde në vlerën prej **28.290.053,77** lekë .

Për vitin 2021 planifikojmë krijim të ardhurash në vlerën 62.921.182 lekësh.**Në total do të mund të përdorim për shpenzime nga të ardhurat 91.211.236 lekë.Krijimi i të ardhurave gjithmonë mbart në vetvete rriskun e realizimit.** Për vitin 2021 trashëgohet një pjesë e vogël të ardhurash krahasuar me nevojat që ka institucioni Burimi kryesor i krijimit të të ardhurave dytësore janë pagesa e tarifës së shkollimit nga studentët. Për vitin akademik 2020-2021 ashtu si edhe një vit më parë , në vitin akademik 2019-2020 studentët e ciklit të parë të studimeve përfitojnë nga V.K.M. Nr. 778 datë 26.12.2019 .Një pjesë e konsiderueshme e studentëve janë përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit sipas vendimeve të KM (Nr 269 datë 29.3.2017 të

ndryshuar me V.K.M Nr. 40 datë 23.01.2019) të cilat janë duke u zbatuar nga hyrja në fuqi e tyre ,duke ndjekur politikat sociale për studentët, për tu përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit apo për pagesën në masën 50% të saj. Për vitin akademik 2019-2020 janë shqyrtuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit 169 studentë në ciklin e parë të studimeve ,si dhe 39 studentë në ciklin e dytë të studimeve.Kjo ka sjell automatikisht uljen në një masë të ndjeshme të ardhurave në universitet në vlerë prej 4.400.000 lekë .Për vitin akademik 2020-2021 vazhdon procesi i pranimit të dokumentacionit për trajtimin e studentëve me bursë apo përjashtimin nga tarifa .Deri tani janë trajtuar na Bordi i Administrimit 102 studentë nga të cilët 82 studentë që studiojnë në ciklin e parë të studimeve dhe 20 studentë të ciklit të dytë ,duke pakësuar të ardhurat në vlerën prej 1.710.000 . Kur trajtimi studentëve është akoma në proces kjo shifër do të rritet edhe më shumë dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në planifikim që ne kemi bërë paraprakisht.

STUDENTË TË PËRJASHTUAR NGA TARIFA E SHKOLLIMIT NË VITE

Nr	Viti akademik	Totali i studenteve	Bachelor	Master profesional	Master shkencor	Shuma lekë
1	2016-2017	91	64	23	4	2.579.539
2	2017-2018	132	120	12	0	2.940.000
3	2018-2019	175	148	27	0	2.835.100
4	2019 - 2020	208	169	39	0	4.400.000
5	2020 - 2021	102	82	20		1.710.000

SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE DYTËSORE PËR VITIN 2021

Nisur nga situata konkrete financiare e deritanishme si dhe planifikimin e sasisë të të ardhurave dytësore për vitin 2021 do të paraqesim për miratim buxhetin të mbështetur në nevojat reale për funksionimin e institucionit,**kushtëzuar nga realizimi i të ardhurave .** Është bërë ky planifikim i buxhetit për të mbështetur funksionimin normal të Institucionit.

Politikat që ndërmerren nga ana jonë do të konsistojnë në:

- Përbushjen e të gjitha standarteve mbi të cilat do të bëhet akreditimi i institucionit tonë.
- Vazhdimin e ristrukturimit të arsimit dhe aftësimit profesional, duke nxitur rolin e studentëve për tu përshtatut me nevojat reale të tregut të punës.

- Integrimin e veprimtarisë kërkimore - shkencore me atë të mësimdhënies në nivele reale, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin profesional të studentit , por edhe për të patur një impakt pozitiv në zhvillimin e rajonit .

Për vitin 2021,duke iu referuar politikave të mësipërme dhe gjendjes financiare të institucionit shpërndarja e të ardhurave për përdorim do të planifikohet mbi bazën e kriterëve si më poshtë :

- Mbështetjen financiare të procesit të Akreditimit .
- Për financimin e aktiviteteve (ose shpenzime) me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Financimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit mbi baza reale dhe për nevoja të domosdoshme të funksionimit të tij.
- Financime për qeverinë studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social, apo bashkëpunues me qeverinë studentore të universiteteve të tjera.
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucionit dhe të sistemit të të dhënave që është implementuar me vite në Universitet.
- Financim për aktivitete shkencore të Njësisë Bazë ku nga produktet e tyre do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë institucioni ,studentët si dhe komuniteti i qytetit dhe i Qarkut të Gjirokastrës .

1.PAGA

Duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave nevojitet për tu shpenzuar për paga është planifikuar në vlerën prej **32.381.019 lekë** me qëllim për të përballuar :

- pagën e punonjësve të institucionit për muajt që nuk mund të sigurohet pagesa nga Buxheti i Shtetit .
- pagesën e orëve të pedagogëve të jashtëm e të ftuar.
- pagesën e orëve suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës mësimore sipas udhëzimit Nr.29 datë 10.09.2018 të MASR-së të ndryshuar.

Ky fond është planifikuar më i lartë se vitet e kaluara pasi nisur nga fondi i akorduar nga buxheti i shtetit nuk mbulon në masë të madhe që të sigurojë likuidimin e tyre.

Vështirësia financiare e institucionit , na detyron të propozojmë që të reduktohen mundësisht sa më shumë :

Universiteti “Eqrem Çabej”, Lagjja “18 Shtatori”, Rruga “Studenti”, 6001.

- pagesa e orëve mbi ngarkesën mësimore
- reduktimi i ngarkesës mësimore për pedagogët e jashtëm
- ulja e numrit të pedagogëve të jashtëm , për ato lëndë që mund të mbulohen me staf akademik të brendshëm.

2 .SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT

Në planifikimin e shpenzimeve nga të ardhurat dytësore janë përcaktuar limite të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm , kushtëzuar nga sasia e të ardhurave që parashikohen të realizohen.

Duke analizuar vështirësinë financiare të financimit nga të dy burimet si nga Buxheti i Shtetit ashtu edhe nga të ardhurat dytësore , por edhe domosdoshmërinë e kryerjes së shpenzimeve për funksionimin normal akademik dhe administrativ të institucionit, planifikimi i fondeve i detajuara sipas zërave është :

2.1SHPENZIMET OPERATIVE TË DETAJUARA SIPAS TABELËS

Nr	Objekti i Prokurimit	Planifikimi 2021
1	Karburant	4,080,000
2	Diploma studenti	960,000
3	Sherbime te printimit dhe publikimit	1,440,000
4	Kancelari, boje fotokopje,printeri,antivirus,sëice,rutera mikrotik ëireles kamera per kmpjuter	2,400,000
5	Materiale pastrimi e higjeno sanitare(maska dezinf. etj)	960,000
6	Mirembajtje kompjuterash fotokopje e printera,	240,000
7	Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi	600,000
8	Ilace dhe materiale per laboratorike	120,000
9	Mirembajtje mjet transporti (dy mjete)	480,000
10	Sigurimi i detyrueshem i mjeteve autoveture M-Benz,furgon M-benz	192,000
11	Abonim per sherbim interneti	120,000
12	Mirembajtje te aparateve kondicionere	198,000
	Pleh organik dhe inorganik	

Universiteti “Eqrem Çabej”, Lagjja “18 Shtatori”, Rruga “Studenti”, 6001.

13		48,000
14	Dezinfektim i ambjenteve	146,043
15	Dezinfektim i ambjenteve	108,987
16	Bileta avioni	960,000
17	Mirembajtje taracave	480,000
18	Sistemim dhe blerje materiale per ambjentet e jashteme (peme dekorative ,uje dekorativ,vazo lulesh ,veshje druri)	960,000
19	Rimbushje bombola gazi	84,000
20	Mirembajtje sistem alarmi	120,000
21	Mirembajtje kamerave te sigurise	120,000
22	Energji	2,000,000
23	Uje	200,000
24	Telefon	700,000
25	Sherbim postar	115,000
26	Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim,akreditim programesh, etj)	2,000,000
27	Kosto legale (Implementimi i programit alfa)	276,727
28	Kosto te seancave te bordeve ,senati	4,095,000
29	Dieta (brenda ,jashte,ekspedita)	3,500,000
30	Shpenzime per Qeverine Studentore	3,500,000
31	Shpenzime pritje e percjellje	700,000
32	Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca,projekte te ndryshme etj.	3,500,000
33	Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivitete, shfaqje etj)	600,000
	TOTALI	36,003,757

Për faktin që këto shpenzime do të mbulohen tërësisht nga të ardhurat dytësore, është planifikuar një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2021. Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për çdo zë si më poshtë:

1-Në zërin karburant është planifikuar fondi prej **4.080.000** lekë, kjo nisur nga:

- sasinë e karburantit që kemi gjendje.
- krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve, duke ju përgjigjur edhe kërkesave të studentëve për ngrohje.
- sasinë e nevojshme për mjetet e transportit.

2- Në zërin Diploma për studentë është planifikuar fondi prej **960.000** lekë.

3-Në zërin Shërbime të printimit dhe publikimit është planifikuar fondi prej **1.440.000** lekë. Do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e periodikëve “Kërkime Universitare” për vitin 2021, prodhimi i fletpalosje, posterave etj. Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë nevojave për procesin e akreditimit si dhe promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- rritjen e numrit të studentëve.
- rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit të Gjirokastrës dhe më gjerë.
- rritjen e kontributit për cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

Gjithashtu kemi planifikuar në këtë vlerë në kuadrin e bashkëpunime me institucione të ndryshme për zhvillim të konferencave shkencore si dhe bashkëpunimit të institucionit tonë me partnerë të tjerë.

4-Në zërin Kancelari, boje fotokopje, printeri, antivirus, sëice, ruter, mikrotik ëireles, kamera për kompjuter, etj: është planifikuar fondi prej **2.400.000** lekë për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera etj. Një peshë të konsiderueshme zënë tonerat e printerave dhe fotokopjuesve, pasi për cdo Njësi Bazë kemi nga 2- 4 printera (ku mund të ketë edhe nga 10-15 persona) dhe nga një fotokopjues. Gjithashtu edhe zyrat e administratës janë të pajisura me printera e fotokopje për të cilat duhet të planifikojmë të paktën nga dy- tre bojra në vit në varësi edhe të volumit të punës që ka çdo zyrë. Duke qenë se mësimi

zhvillohet on line duhet që të planifikojmë për të blerë edhe sëice,rutera ,mikrotik ëireles, kamera për kompjuter ,etj.

5-Në zërat e tjerë kemi planifikuar si më poshtë :

Materiale pastrimi e higjeno sanitare(maska dezinf. etj) **960.000 lekë , mirëmbajtje**

kompjuterike, fotokopjuesish e printerash 240.000 lekë, materiale hidraulike, elektrike e ndërtimi 600.000 lekë, mirëmbajtje kondicioner 198.000 lekë.Krahasimisht me vitin

2020,është parashikuar pothuajse në vlerë të njëjtë apo edhe më pak ,për arsye të reduktimit në maksimum të shpenzimeve të këtyre zërave dhe duke përdorur me efektivitet pajisjet si ato të reja dhe ato që janë në përdorim.

6-Në zërin “Ilace dhe materiale për laboratorë” është planifikuar fondi prej **120.000 lekë**

sipas eksperiencës së viteve të kaluara si dhe kërkesave të Njësizë Bazë të infermierisë dhe Bio-Kimisë për të përballuar nevojat për ilace mjekësore gjatë zhvillimit të praktikave në terren si dhe materiale të tjera për zhvillimin e punës laboratorike në funksion të procesit mësimor nga këto njësi..

7-Në zërin mirëmbajtje mjete transporti: është planifikuar fondi prej **480.000 lekë.** Ashtu si

edhe më parë peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zë mjeti furgon pasi është mjet që është blerë prej vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit.Në kushtet e sotme të sasisë së të ardhurave që realizon institucioni, nuk mund të planifikohet blerja e një mjeti të ri, sepse do të ketë një kosto të konsiderueshme, shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij.Gjithashtu kemi planifikuar edhe fondin prej 192.000 lekë për sigurimin e detyrueshëm të mjetëve të transportit .

8-Në zërin Abonim për shërbim interneti : është planifikuar fondi prej **120.000**

lekë.Interneti është më i domosdoshëm se kurrë më parë si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia e Covid -19 për ti ardhur në ndihmë si stafit akademik,studentëve ashtu edhe stafit mbështetës.

9-Në zërin Dezinfektim i ambjenteve është planifikuar fondi prej **108.987 lekë.**Momentalisht

vazhdojmë me kontratën që kemi të lidhur nga viti 2020 .Edhe për vitin 2021 dezinfektimi është i domosdoshëm si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia e Covid -19.

10-Në zërin Mirembajtje taracave janë planifikuar fonde në vlerën **480.000 lekë.**

11-Në zërat energji, ujë janë shpenzime me karakter tarifor dhe është parashikuar në vlera të tilla në bazë të faktit që ne kemi realizuar në 2020. Në zërin e energjisë elektrike është planifikuar fondi prej **2.000.000 lekë** për ambjentet ekzistuese. Meqënëse planifikojmë të bëhet rikonstruksioni i objektit tek godina B, do të jetë i domosdoshëm shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike për kryerjen e punimeve në këtë objekt. Për ujin është planifikuar fondi prej **200.000 lekë** duke pasur parasysh realizimin e vitit 2020 por që në qoftë se do të duhen fonde në vazhdim do të alokojmë sipas nevojave .

12-Në zërin telefon parashikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas **VKM-së Nr.864 datë 23.07.2010”Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”** , ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përlllogaritet në total **700.000 lekë** vlerë e cila nuk e tejkalon 2% e vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, sic kërkohet në këtë vendim. Nga praktika e viteve të kaluara ka rezultuar se ky fond nuk konsumohet totalisht pasi nga punonjësit përfitues të këtij shërbimi nuk konsumohet e gjithë vlera mujore e përcaktuar për secilin.

13-Në zërin Shërbimi postar, është planifikuar fondi prej **115.000 lekë** për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.

14-Në zërin Rimbushje bombola gazi , është planifikuar fondi prej **84.000 lekë**. Bombolat e gazit duhet të jenë të mbushura me gaz dhe të kolaudohen për ti pasur në gadishmëri për cdo situatë.

15- Në zërin Mirëmbajtje sistem alarmi dhe mirëmbajtje kamerave të sigurisë është planifikuar fondi prej **120.000 lekë** për secilin zë e kushtëzuar kjo nga vetë rëndësia që ka funksionimi i tyre 24 orë .

16-Në zërin dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita është planifikuar fondi prej **4.460.000 lekë**, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme, si dhe për praktikat mësimore të studentëve. Planifikojmë këto fonde pasi dihet tashmë se praktikantët që bëhen në terren, kërkojnë lëvizjen e studentëve jashtë qytetit me transport urban dhe pagesë hoteli për akomodimin e tyre në rast se do të ketë intenerare të tilla.

17-Në zërin Shërbime të ndryshme është planifikuar fondi prej **2.000.000 lekë** nga të cilat 50.000 lekë kemi planifikuar për shpenzimet bankare dhe pjesa tjetër parashikohet për kryerjen e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike të funksionimit të institucionit (te mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjieno –sanitare), hostim të faqes së UGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifike për një vit buxhetor.

18-Në zërin kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati etj është planifikuar fondi prej **4.095.000 lekë** nga përlogaritjet

-për mbledhjet e senatit (për nëntë muaj),

-për mbledhjet e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj).

19-Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore: është planifikuar fondi prej **3.500.000 lekë**.

Nga ana jonë planifikohet ky fond për të mbështetur qeverinë studentore për të financuar veprimtaritë e tyre, sipas nenit 99, pika 6 e ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", si dhe duke qenë një nga rekomandimet e grupit të ekspertëve për akreditim. Është parë e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore me impakt universitar për të qenë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, qytetit dhe të rajonit të jugut.

20-Në zërin Shpenzime për pritje përcjellje është planifikuar fondi prej **700.000 lekë** duke marrë parasysh edhe shpenzimet në vitin 2020 në Universitetin, si dhe duke shpresuar në normalizimin e situatës.

21-Në zërin aktivitete, kërkime shkencore, konferenca kombëtare, veprimtari lokale, projekte etj është planifikuar fondi prej **3.500.000 lekë** për ti dhënë përparësi kërkimit shkencor, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare .

22- Në zërin Kosto reklamimi dhe publikimi është planifikuar fondi prej **600.000 lekë**

Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- rritjen e numrit të studentëve.
- Promovimin dhe rritjen e impaktit pozitiv të Institucionit në komunitetin e rrethit të Gjirokastrës dhe më gjerë.

2.2 SHPENZIME PËR INVESTIME TË DETAJUARA SIPAS TABELËS

Fonde për investime nga të ardhurat dytësore planifikojmë në vlerën prej **22.826.460 lekë** të ndarë sipas zërave që jepen në tabelën e mëposhtme :

1	Rikonstruksioni i klasave 401.402.403 godina B dhe mobilimi I tyre	1,784,916
2	Supervizimi Rikonstruksioni I klasave 401.402.403 godina B dhe mobilimi I tyre	47,278
3	Kolaudator Rikonstruksioni I klasave 401.402.403 godina B dhe mobilimi I tyre	14,986
4	Libra per biblioteken	3,840,000
5	Blerje aparate kompjuterike(kompjutera, lap top, printera, fotokopje etj)	5,400,000
6	Mjete didaktike	120,000
7	Rikonstruksioni i godinave	8,200,000
8	Supervizor rikonstruksionin e godinave	95,000
9	Kolaudator rikonstruksionin e godinave	22,000
10	Rimbursimi I TVSH -së së projekteve me finacim te huaj	2,959,679
11	Blerje kondicionere	240,000
12	Supervizim lyerje	91,609
13	Kolaudim lyerje	10,992
	TOTALI	22,826,460

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2021 është bërë mbi bazën e nevojave të evidentuara dhe kërkesave të ardhura nga Njësitë Kryesore referuar kërkesave të Njësive Bazë të depozituara pranë Zyrës së Administratorit me argumentimet përkatëse. Për realizimin e investimeve nga ana jonë planifikojmë:

1-Në zërin rikonstrukcion i klasave 401.402.403 dhe mobilimi i tyre tek godina B është planifikuar fondi prej **1.784.916** lekë, për arsye se është prokuruar procedura në vitin 2020. Punimet do të fillojnë dhe do të përfundojnë këtë vit .Gjithashtu planifikohet për supervizorin dhe kolaudatorin sepse natyra e punimeve është e tillë që shoqërohet me supervizim dhe kolaudim të tyre.

2-Në zërin libra për bibliotekën është planifikuar fondi prej **3.840.000** lekë për blerjen e një kontigjenti të konsiderueshëm librash për bibliotekën që do tju shërbejë stafit akademik si edhe studentëve . Shtimi i titujve të librave përmbush edhe një nga kushtet për akreditimit institucional.

3- Në zërin blerje aparate kondicionere: është planifikuar fondi prej **240.000** lekë për blerje kondicionerë sipas kërkesave dhe nevojave të Njësive Bazë si dhe kërkesave të Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve.

4-Në zërin mjete didaktike mësimore, është planifikuar fondi prej **120.000** lekë për përmirësimin e nivelit të mësimdhënies dhe të konkretizimit të orës mësimore në praktikë.

5-Në zërin rikonstrukcioni i godinave është planifikuar fondi prej **8.200.000** lekë. Gjithashtu është planifikuar edhe supervizimi dhe kolaudimi i rikonstrukcionit .

6-Në zërin Blerje aparate kompjuterike(kompjutera, lap top, printera, fotokopje etj) është planifikuar fondi prej **5.400.000** lekë,kjo në bazë të kërkesave që kanë ardhur nga Njësitë Kryesore referuar kërkesave të Njësive Bazë.

Gjithashtu në shpenzime për vitin 2021 kemi planifikuar edhe vlerën prej **2.959.679** lekë për rimbursimin e TVSH –së për projektet me financim të huaj ,sipas kërkesave të ardhura nga Përgjegjësi i zyrës së projekteve,për të cilat do të kërkojmë financim nga Ministria e Financave.

Në total, për vitin 2021 planifikojmë për të plotësuar nevojat e institucionit në shumën prej **263,503,487** lekë, nga të cilat **172.292.251** lekë janë nga buxheti shtetit dhe **91,211,236** lekë nga të ardhurat e institucionit, duke pasur si përparësi përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, jetës akademike, mbështetjes studentore, aktiviteteve të ndryshme dhe promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

PARASHIKIMI I ZËRAVE BUXHETORE PËR VITIN 2021

	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria Ekonomike	Totali	Buxhet	Ardhura
1	Paga personeli, ore supelementare, orë ped te jashtem e te ftuar	600	171,183,261	138,802,242	32,381,019
2	Sigurime shoqërore	601	29,500,000	29,500,000	-
	SHUMA	600 + 601	200,683,261	168,302,242	32,381,019
1	Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit.	602	36,003,757		36,003,757
2	Trasferte për pjesëmarrje në konferenca	605	232,913	232,913	0
	SHUMA		36,236,670	232,913	36,003,757.
1	Bursa për studentët	606	3,757,096	3,757,096	
1	Invstime nga te ardhurat (rikonstruksione, paisje kompjuterike, libra, etj)	231	22,544,595		22,544,595
2	Studime projekttime (Superviz, kolaudator)	230	281,865		281,865
	SHUMA 230+231		22,826,460	-	22,826,460
	TOTALI		263,503,487	172,292,251	91,211,236

Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë të Ligjit të Buxhetit të Shtetit ,në strategjinë e Universitetit do të punojmë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies duke krijuar kushte sa më të favorshme për të rritur impaktin e Institucionit në rajon dhe më gjerë duke u mbështetur dhe u bazuar në kërkesat e strukturave përkatëse.

REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2021.

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 32, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.137 datë 16.11.2020 “Për Buxhetin e Vitit 2021”, Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20,09,2019 të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, të zbatimit të buxhetit, konform miratimeve, nga Bordi i Administrimit të Universitetit “Eqrem Cabej”, konfirmuar pjesërisht dhe nga Dega e Thesarit Gjirokastër, është përgatitur për miratim veprimtaria financiare e institucionit nëpërmjet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2021 për si më poshtë:

Për vitin 2021 aktiviteti financiar është bazuar në dy burimet e financimit si më poshtë :

- 1-Financimin nga Buxheti i Shtetit në vlerën prej 168.647.232 lekë në fillim të vitit.
- 2-Financimin nga të ardhurat e Institucionit në vlerën prej 74.896.232 lekë.

Financimit nga buxheti i shtetit në vlerën prej 168.647.232 lekë i akorduar në fillim të vitit 2021 iu shtua në vazhdim edhe vlera prej 15.000.000 lekë. Gjithashtu janë financuar edhe dy projekte nga AKSHI në vlerat përkatësisht prej 1.445.310 lekë dhe 2.624.840 lekë si dhe për rimbursimin e T.V.SH. në vlerën prej 2.164.736 lekë.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve me fonde nga Buxheti i Shtetit të ndarë sipas zërave të jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtesa	Viti 2021		
		Plani Viti 2021	Realizimi Viti 2021	% e Realizimit me planin fillestar

1	Fondi i pagave	153.321.832	153.321.772	100%
2	Sigurime shoqërore	29.500.000	28.150.001	95%
4	Bursa e transferime	3.757.096	3.757.094	100%
5	Transferime fond i vecante	480.410	480.410	100%
	Gjithsej shpenzime	187.059.338	185.709.277	99%

Për 2021 është përballuar nga Buxheti i Shtetit :

1- Pagat e punonjësve akademikë dhe administrativ, sipas strukturës organike të miratuar, si dhe nga fondi i pagave gjatë vitit 2021 janë dhënë shpërblime për raste të veçanta (dalje në pension) në vlerën prej 480.410 lekë. Ky fond është realizuar në masën 100%.

2- Pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi është realizuar në masën 95% .

Fondet nga Buxheti i Shtetit të akorduar për vitin 2021, nuk kanë qënë të mjaftueshme për të përballuar pagat e të gjithë vitit, pasi pagat e punonjësve të muajit nëntor likujduar në muajin dhjetor për vlerën 11.151.620 u paguan nga të ardhurat si edhe sigurimet shoqërore e shëndetësore në vlerën prej 1.611.651 lekë. Në muajt shkurt edhe mars është shpenzuar në vlerën prej 1.713.498 lekë po nga të ardhurat e Institucionit për pagat.

Siç shihet edhe nga tabela, realizimi i shpenzimeve me fonde nga Buxheti i Shtetit ka fonde të papërdorura por janë trashëguar si më poshtë :

1-Zëri sigurime shoqërore në vlerën prej **1.350.000 lekë**

2- Zëri transferime korrente jashtë shtetit në vlerën prej **232.913 lekë**,

3-Financim nga AKSHI projekte në vlerën prej **1.266.313 lekë**.

4-Financim nga nga AKSHI projekte në vlerën prej **2.624.840 lekë**.

5-Financim për T.V.SH për projekte me financim të huaj në vlerën prej **590.449 lekë**.

Në total nga fondet e buxhetit trashëgohen **6.064.515 lekë** për vitin 2022. Ky informacion mund edhe të ndryshojë se nuk është bërë rakordimi përfundimtar me thesarin për pjesën e fondeve që trashëgohen nga Buxheti i Shtetit.

Për financimin e shpenzimeve nga të ardhurat dytësore për vitin 2020, jemi bazuar në

1. Të ardhura e krijuara për Universitetin në vitin 2021 sipas tabelës së mëposhtme, Si dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2020.

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2021
1	Tarifa Shkollimi	42.689.177
2	Vërtetime ,etj	4.539.590
3	Tarife regjistrimi	71.200
	SHUMA	47.299.967

Sic shihet edhe nga tabela e mësipërme për vitin 2021, të ardhurat janë realizuar në vlerën **47.299.967** lekë gjithsej, nivel ky me i lartë i krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo ka ardhur si rrjedhim i ndryshimit mënyrës së pagesave nga studentët të kësteve të tarifës së shkollimit .Ky ndryshim u bë me vendim të Bordit të Administrimit pasi burimi kryesor i të ardhurave për institucionin janë të ardhurat nga studentët të krijuara kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe tarifat e regjistrimit të tyre.

Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë viteve të fundit ato kanë pësuar luhatje në masë të konsiderueshme, pavarësisht nga hapja e programeve të studimit “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”, sepse pothuajse në të gjitha programet e studimit të Universitetit.

-numri i studentëve të regjistruar ka pasur luhatje përkatësisht :

për vitin akademik 2015-2016 1770 studentë

për vitin akademik 2016-2017 1626 studentë

për vitin akademik 2017-2018 1454 studentë

për vitin akademik 2018-2019 1521 studentë

për vitin akademik 2019-2020 1501 studentë

për vitin akademik 2020-2021 1489 studentë

-megjithëse duket një rritje e lehtë apo një ulje e numrit të studentëve nga viti në vit , gjithmonë ka studentë që rregjistrohen dhe nuk frekuentojnë procesin mësimor e për rrjedhojë nuk paguajnë as tarifën e shkollimit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në të ardhurat e planifikuara të Institucionit .

-një pjesë e tarifës së shkollimit të studentëve është arkëtuar që në muajt nëntor-dhjetor 2020,

- trajtimi i një numri të madh studentësh , të cilët vijnë kryesisht nga shtresa sociale në nevojë, me prindër invalid apo edhe vetë studentët me PAK, fëmijët e të përndjekurve politik, për rrjedhojë nuk e paguajnë ose e paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit sipas sistemit të studimit përkatës. Në vitin 2021 realizimi i të ardhurave ishte në masën 47.299.967 lekë .

Nga viti 2020 janë trashëguar 28.290.051 lekë të ardhura.

Gjatë vitit 2021 janë krijuar 47.299.967 lekë nga të ardhurat

Gjatë vitit 2021 janë përdorur 74.896.232 lekë nga të ardhurat.

Për vitin 2022 trashëgohen 693.786,59 lekë të ardhura .

Duke parë të ardhurat e krijuara në vite si më poshtë:

Viti 2018 40.870.305 lekë

Viti 2019 32.703.468 lekë

Viti 2020 33.298.983 lekë

Viti 2021 47.299.967 lekë

Vihet re një rritje për 2021 por kjo është rrjedhojë e pagesës së kështit të parë të studimeve për studentët që ndjekin ciklin e studimeve në master nga 10.000 lekë i planifikuar në 30.000 lekë i ndryshuar me vendim të B.A.

Shpenzimet nga të ardhurat e Institucionit janë në vlerën prej 74.896.232 lekë e ndarë sipas zërave jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtesa e shpenzimeve	Viti 2021		
		Planifikimi	Realizimi	% e Realizimit me planin fillestar
1	Fondi i pagave	41.095.360	41.095.360	100%
2	Shpenzime Operative e abonime	26.265.200	16.582.239	62%
3	Investime	11.786.234	11.197.820	95%
4	Sigurime shoqerore e shendetesore	1.611.651	1.611.651	100%
5	Bursa	4.409.162	4.409.162	100%
	Shuma	85.167.607	74.896.232	88%

I- Financimi nga të ardhurat dytësore për pagat

Këtu janë përfshirë pagat e punonjësve për muajin nëntor që u likujdua në dhjetor , orët suplementare sipas udhëzimit përkatës i MASR nr 29 date 10.09.2018, paga për orët e pedagogëve të jashtëm e të ftuar , si dhe orët jashtë kohës normale të punës për punonjësit mbështetës.Me fondin e mësipërm të pagave janë mbuluar të gjitha shpenzimet sipas shkresave të ardhura nga Njësitë kryesore dhe Njësitë Bazë për punonjësit efektiv dhe ata të jashtëm e të ftuar për vitin 2021,pas miratimit në BA,si dhe pagat e muajit nëntor paguar në dhjetor.

II-Financimi nga të ardhurat dytësore për shpenzimet operative dhe të tjera :

Shpenzimet operative për vitin 2021 janë mbështetur vetëm nga të ardhurat e institucionit. Fondi i realizuar për shpenzimet operative dhe të tjera është në masën lekë 16.582.239.Gjatë vitit janë bërë rialokime të ndryshme, brenda limitit të përdorimit.Këto rialokime pasi janë dërguar për miratim në BA-it dhe pas marrjes së miratimit prej BA-së.Shpenzimet sipas zërave të detajuara janë dhënë tek tabela e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve. Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave me të gjitha ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga Bordi i Administrimit.

Për zërin e shpenzimeve operative si edhe për investimet e planifikuara siç shihet financimi nga të ardhurat përbën burimin e vetëm për shpenzimet operative.Fondet që akordohen nga Buxheti i Shtetit nuk mjafton për mbulimin e pagave dhe sigurimeve .Detyrimisht planifikohet nga të ardhurat e krijuara për shpenzime operative e investime .Me të ardhurat e trashëguara si dhe një pjesë të të ardhurave të krijuara u financuan shpenzimet për kontratat e prokuruar, për shpenzimet me blerje me vlerë të vogël,për tarifat shtetërore fikse që institucioni paguan çdo muaj ,si edhe për investimet.Shpenzimeve të planifikuara nga të ardhurat e institucionit, si edhe nga Buxheti i Shtetit u është dhënë rëndësi e veçantë përdorimi me efektivitet të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme . Rregjistri i realizimeve është si më poshtë:

	Objekti i Prokurimit	Fondi limit i parashikuar				
		Plan Investime	Plan Shpenzime		Fakt Shpenzime	
		Te ardhura	Plan Buxhet	Plan te ardhura	Fakt Buxhet	Fakt te ardhura
1	Karburant			4,080,000		-
2	Diploma studenti			960,000		724,344
3	Sherbime te printimit dhe publikimit			1,440,000		842,676
4	Kancaleri, boje fotokopje,printeri,			1,628,773		1,628,773
5	Materiale pastrimi e higjeno sanitare(maska dezinf. etj)			872,400		872,400
6	Mirembajtje kompjuterash fotokopje e printera, antivirus,sëice,rutera mikotik ëireleskamera per kmpjutera			216,000		-
7	Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi			477,600		477,600
8	Ilace dhe materiale per laboratore			-		-
9	Mirembajtje mjet transporti (dy mjete)			358,800		297,000
10	Sigurimi i detyrueshem i mjeteve autoveture M-Benz,furgon M-benz			192,000		170,858
11	Abonim per sherbim interneti			120,000		102,852
12	Mirembajtje te aparateve kondicionere			186,000		93,600
13	Pleh organik dhe inorganik			48,000		-
14	Dezinfektim i ambjenteve prokuruar			146,043		146,043
15	Dezinfektim i ambjenteve			649,563		87,857
16	Bileta avioni			-		-
17	Mirembajtje taracave			405,597		405,597
18	Sistemim dhe blerje materiale per ambjentet e jashteme (peme dekorative ,uje dekorativ,vazo lulesh ,veshje druri)			576,000		576,000
19	Rimbushje bombola gazi			84,000		84,000

20	Mirembajtje sistem alarmi			-		-
21	Mirembajtje kamerave te sigurise			120,000		-
22	Energji			2,000,000		2,062,693
23	Uje			200,000		210,053
24	Telefon			700,000		575,024
25	Sherbim postar			115,000		105,360
26	Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim ,akreditim programesh ,etj)			2,000,000		1,986,533
27	Kosto legale (Implementimi i programit)			-		-
28	Kosto te seancave te bordeve ,senati			4,095,000		2,596,500
29	Dieta (brenda ,jashte,ekspedita)			2,959,424		1,414,536
30	Shpenzime per Qeverine Studentore			-		-
31	Shpenzime pritje e percjellje			700,000		407,940
32	Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca,projekte te ndryshme etj.			-		-
33	Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivitete, shfaqje etj)			600,000		420,000
34	Trasferta te jashtme 605		232,913	-		-
35	Publikime(perfeksinim I faqes Zyrtare te UGJ			120,000	-	115,200
36	Blerje bojra (printer,fotokopje, etj)			120,000		118,800
37	Marrje me qera pajisje për përkthimin sistemit simultant			60,000		60,000
	TOTALI 602 (9450)		232,913	26,230,200		16,582,239
1	Kerkime shkencore(Standartizimi I produkteve te blegtorise ne qarkun e Gjirok dhe krij I nje marke tregetare)602(9770)		1,445,310	35,000		178,997

1	Rikonstruksioni i klasave 401.402.403 godina B dhe mobilimi I tyre	1,783,644				1,783,644
2	Supervizimi Rikonstruksioni I klasave 401.402.403 godina B dhe mobilimi I tyre	47,278				-
3	Kolaudator Rikonstruksioni I klasave 401.402.403 godina B dhe mobilimi I tyre	14,986				-
4	Libra per biblioteken	3,811,877				3,811,877
5	Blerje aparate kompjuterike(kompjutera, lap top, printera, fotokopje etj)	3,696,000				3,696,000
6	Mjete didaktike	-				-
7	Rikonstruksioni i godinave	-				-
8	Supervizor rikonstruksionin e godinave	-				-
9	Kolaudator rikonstruksionin e godinave	-				-
10	Rimbursimi I TVSH -së së projekteve me finacim te huaj		2,164,736			2,164,736
11	Blerje kondicionere	240,000				-
12	Supervizim lyerje	91,609				91,609
13	Kolaudim lyerje	10,992				-
14	Projekti stone art	1,814,692				1,814,692
15	”(Blerje paisje laboratorike) “Infrastruktura e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies në FEUOGJ”	275156	2,624,840			-
	Shuma e investimeve	11,786,234	4,789,576	-	-	13,362,558
	Totali					30,123,794

Nga tabela e mësipërme duket sikur realizimi i prokurimeve në disa zëra është në masë 100% po në fakt pas procedurave të prokurimit fondet i kemi alokuar dhe përdorur për nevoja të tjera.

Parashikimi dhe realizimi i fondeve në total për vitin 2021 jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtesa	Plani Viti 2021	Realizimi Viti 2021	% e Realizimit me planin fillestar
1	Fondi i pagave	194.417.192	194.417.192	100%
2	Sigurime shoqërore	31.111.611	29.761.652	96%
3	Shpenzime operative	26.265.200	16.582.239	63%
4	Bursa e transferime	8.168.258	8.168.258	100%
5	Investime e studime projekte	11.786.234	11.197.820	100%
	Gjithsej	271.748.495	260.127.161	95%

Në thesar për vitin 2021 janë çelur edhe fonde për projektet me financim të huaj në vlerën prej 17.283.073 lekë.

DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2022.

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MASR dhe M.F.E “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “ Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”,propozojmë detajimin e buxhetit të dërguar nga ana e M.AS.R-së për fondet grand të miratuara për vitin 2022, në grupin e shpenzimeve korente, i cili është akorduar në vlerën prej **182.351.255** lekë .Sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, keni miratuar si më poshtë:

1-Paga.Për stafin akademik dhe personelin mbështetës planifikohet fond page në vlerën prej **141.461.255** lekë.

2-Sigurime shoqërore. Sipas ligjit në fuqi për “Sigurimet Shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, vlera vjetore e këtyre kontributeve e llogaritur (16.7% të fondit të pagës) planifikohet fond prej **28.650.000** lekë.

3-Bursat e studentëve. Sipas V.K.M.-së nr. 903 datë 21.12.2016"Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar me V.K.M. Nr. 450, datë 22.5.2017 i ndryshuar me V.K.M. Nr. 697, datë 21.11.2018 i ndryshuar me V.K.M. Nr. 784 datë 26.12.2018 , V.K.M. Nr. 39 datë 26.1.2019 e V.K.M. Nr. 755 datë 30.11.2019. planifikohet fondi sipas çeljes në buxhet në vlerën prej **12.240.000** lekë.

Për vitin 2022 institucioni ndodhet në krizë për përballimin e nevojave për funksionimin normal të tij.

Nga buxheti i shtetit kemi trashëguar :

1- Zëri sigurime shoqërore në vlerën prej **1.350.000** lekë

2- Zëri transferime korrente jashtë shtetit në vlerën prej **232.913** lekë,

3-Financim nga projektet e AKSHIT në vlerën prej **1.266.313 lekë**.

4-Financim nga projektet e AKSHIT në vlerën prej **2.624.840 lekë**.

5-Financim për T.V.SH për projekte me financim të huaj në vlerën prej **590.449 lekë**.

Këto fomde në momentin që do të mbarten do bëhet edhe likuidimi i tyre .

Në total nga fondet e buxhetit trashëgohen **6.064.515 lekë** për vitin 2022.Ky informacion mund edhe të ndryshojë se nuk është bërë rakordimi përfundimtar me thesarin për pjesën e fondeve që trashëgohen nga Buxheti i Shtetit.

Në planifikimin e shpenzimeve nga të ardhurat dytësore janë përcaktuar limite të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm , kushtëzuar nga sasia e të ardhurave që parashikohen të realizohen edhe për shpenzimet operative. Duke analizuar vështirësinë financiare të financimit nga të dy burimet si nga Buxheti i Shtetit po ashtu edhe nga të ardhurat dytësore , por edhe domosdoshmërinë e kryerjes së disa shpenzimeve për funksionimin normal akademik dhe administrativ të institucionit, planifikimi i fondeve të detajuara sipas zërave janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Nr	Objekti i Prokurimit	Shpenzime	
		Plan buxheti	Plan te ardhura
1	Kosto te seancave te bordeve ,senati		5.670.000
2	Shpenzime per Qeverine Studentore		0
3	Diploma studenti		960.000
4	Akreditimi i programeve mësimore		3.200.000
5	Energji		2.000.000
6	Uje		200.000
7	Telefon		500.000
8	Sherbim postar		115.000
9	Abonim per sherbim interneti		120.000
10	Dezinfektim i ambjenteve		0
11	Sigurimi i detyrueshem i mjeteve autoveture M-Benz,furgon M-benz		192.000
12	Rimbushje bombola gazi		0
13	Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca,projekte te ndryshme etj		0

Universiteti “Eqrem Çabej”, Lagjja “18 Shtatori”, Rruga “Studenti”, 6001.

14	Shërbime të printimit dhe publikimit një buletin		0
15	Blerje uniforma për ekipin perfaq të UGJ		0
16	Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivitete, shfaqje etj)		0
17	Kancelari		1.200.000
18	Bojra(bojë fotokopje,printer)		1.200.000
19	Materiale pastrimi		700.000
20	Mirëmbajtje kompjuterash, fotokopje, printera,antivirus zv suice ,ruter mikrotik ëireless		0
21	Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi		0
22	Mirembajtje mjet transporti (dy mjete)		400.000
23	Mirembajtje te aparateve kondicionere		0
24	Sistemim dhe blerje materiale per ambjentet e jashteme		0
25	Dieta jashte vendit		960.000
26	Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore bashki, hostim etj)		0
27	Kosto legale (mirembajtje kontrate etj)		0
28	Dieta (brenda ,jashte,ekspedita)		1.500.000
29	Trasferta te jashtme 605	232.913	0
30	Shpenzime pritje e percjellje		200.000
31	Karburant		1.200.000
	Totali i shpenzimeve operative	232.913	20.317.000

Për faktin se institucioni ndodhet në vështirësi financiare si dhe këto shpenzime do të mbulohen tërësisht nga të ardhurat dytësore, është planifikuar në disa zëra pa vlerat përkatëse sepse institucioni momentalisht megjithëse i ka të domosdoshme për tu kryer si shpenzime nuk mund të planifikojë fonde .Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për çdo zë si më poshtë:

1-Në zërin kosto të seancave të bordeve, mbledhje senati etj është parashikuar nga përlogaritjet në **vlerën 5.670.000** lekë.

- c) -për pagesat e anëtarëve të Senatit Akademik (për nëntë muaj+ 3 muajnga 2021),
- d) - për pagesat e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj+6 muaj nga 2021).

2-Në zërin Diploma studenti parashikohet në vlerën prej **960.000** lekë. Kjo vlerë është planifikuar nisur nga numri i studenteve si dhe kërkesat e viteve të mëparshme.

3-Në zërin akreditimi i programeve .Këtu kemi planifikuar në vlerën prej **3.200.000 lekë** për akreditimin e katërmbëdhjetë programeve për ciklin e parë të studimeve dhe katër programe të ciklit të dytë të studimeve .

4-Në zërat energji, ujë janë shpenzime me karakter tarifar dhe është parashikuar në vlera të tilla edhe nga ndryshimet që kanë pësuar këto tarifa gjatë viteve të kaluara. Në zërin e energjisë elektrike është parashikuar një vlerë prej **2.000.000** lekë për ambientet ekzistuese.Kemi planifikuar në këtë vlerë nisur nga realizimi i këtij zëri në të vitet e mëparshme.Por nëqoftë se do të fillojë të bëhet rikonstruksioni i objektit të ish shtëpisë së ushtarakëve, do të jetë i domosdoshëm shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike për kryerjen e punimeve në këtë objekt si dhe vënia në funksionim i godinës vitin tjetër për rrjedhojë kjo vlerë mund të ndryshojë. Për ujin është planifikuar në vlerën **200.000** lekë por duke pasur parasysh se, në qoftë se do të duhen fonde në vazhdim do të alokojmë sipas nevojave .

5-Për zërin telefon parashikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas **VKM-së Nr.864 datë 23.07.2010”Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”** , ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përllogaritet në total **406.340** lekë vlerë e cila e tejkalonme 93.660 lekë, 2% e vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, sic kërkohet në këtë vendim.

6-Në zërin Shërbimi postar, parashikohet në vlerën **115.000** lekë për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.

7-Në zërin Kancelari dhe zërin bojra : Parashikohet përkatësisht në vlerën **1.200.000 lekë** për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike,kurse për tonera kemi planifikuar edhe **1.200.000 lekë** sepse kërkesat nga Njësitë kryesore kanë qenë në rritje. Një peshë të konsiderueshme zënë tonerat e printerave dhe fotokopjuesve.Në çdo Njësi Bazë kemi si printera (ku në çdo Njësi Bazë përbëhet nga një numër i konsiderueshëm staf akademik),ashtu edhe fotokopjues. Gjithashtu edhe zyrat e administratës janë të pajisura me printera e fotokopje

për të cilat duhet të planifikojmë disa bojra në vit në varësi edhe të volumit të punës që ka çdo zyrë.

8-Në zërin materiale pastrimi parashikohet 700.000 lekë .

Krahasimisht me vitin 2021, është parashikuar në këtë vlerë për arsye të reduktimit në maksimum të shpenzimeve.

9-Në zërin dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita është parashikuar në një vlerë totale prej **2.460.000** lekë, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme, si dhe për praktikantët mësimorë të studentëve në qoftë se përmirësohet situata epidemiologjike nga Covid-19.

10-Në zërin Shpenzime për pritje përcjellje kemi planifikuar një fond prej **200.000** lekë duke marrë parasysh edhe shpenzimet në vitet e mëparshme në Universitet.

11-Në zërin karburant parashikohet në vlerën prej **1.200.000** lekë, nisur kjo nga:

5. sasia e karburantit që kemi gjendje
6. krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve, duke ju përgjigjur edhe kërkesave të studentëve për ngrohje.
7. sasia e nevojshme për mjetet e transportit.
8. situata ekonomike e tanishme

12-Për zërin “Trasferta të jashtme” 605 , parashikohet në vlerën prej **232.913** lekë nga Buxheti i Shtetit për arsye të aderimit të institucionit tonë në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit tonë, parë kjo si një domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit tonë në të ardhmen. Kemi planifikuar abonime të cilat kanë qënë të përvitshme dhe janë konsideruar prestigjoze nga ana jonë për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhurnimin me literaturë bashkohore të stafit akademik, për zhvillimin e karrierës së mëtejshme të tyre . Abonimi në organizatën universitare ndërkombëtare “International Association of Universities ” në vlerën 1.500 Euro prej shumë vitesh, ku kemi edhe të drejtë votimi për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa të tjera që mund të paraqiten pranë zyrës së Administratorit nga Departamentet për abonime të tjera, ato do të trajtohen me përparësi.

3-INVESTIME

Fonde për investime nga të ardhurat dytësore janë planifikuar vetëm në emërtesa pa vlera për arsye se planifikohen nga të ardhurat dytësore .

	Objekti i Prokurimit	Investime	
1	Libra për bibliotekën dhe për studentët		0
2	Blerje kondicionere		0
	Totali i investimeve		0

Parashikimi i nevojave për shpenzime operative dhe investime për vitin 2022 është bërë duke pasur si përparësi likuidimin e pagave dhe pastaj cdo shpenzim tjetër. Mbi bazën e nevojave të evidentuara në institucion me argumentimet përkatëse por sipas krijimit të të ardhurave do të bëhet edhe realizimi i parashikimeve.

Në total, për vitin 2022 planifikojmë në shumën totale prej **249.251.168** lekë, nga të cilat **183.934.168** lekë janë nga buxheti shtetit dhe **65.317.000** lekë nga të ardhurat e institucionit, duke pasur si përparësi përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, jetës akademike, mbështetjes studentore, aktiviteteve të ndryshme dhe promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë, duke krijuar kushte sa më të favorshme për këtë qëllim.

PARASHIKIMI I ZËRAVE BUXHETORE PER VITIN 2022

Nr	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria Ekonomike	Viti 2022	Viti 2022	
			Total	Në lek	
I	Granti dhe të Ardhura		Në mijë lek	Buxhet	Ardhura
	Paga personeli	600	186.461.255	141.461.255	45.000.000
	Sigurime shoqërore	601	30.000.000	30.000.000	0

	Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit.	602	20.317.000	0	20.317.000
	Trasferte për pjesëmarrje në konferenca	605	232.913	232.913	0
C	Bursa për studentët	606	12.240.000	12.240.000	0
D	Invstime nga te ardhurat (kondic, Librat)	231	0		0
	TOTALI		249.251.168	183.934.168	65.317.000

REALIZIMI I ZËRAVE BUXHETORE PER 11- MUJORIN E VITIT 2022

Nr	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria Ekonomike	Viti 2022	Viti 2022	
			Total	Në lek	
I	Granti dhe të Ardhura		Në mijë lek	Buxhet	Ardhura
	Paga personeli	600	176.234.024	159.226.082	17.490.651
	Sigurime shoqërore	601	26.862.989	26.795.894	67.095
	Shpenzime për funksionimin mësimor dhe administrativ të institucionit.	602	14.535.233	836.206	13.699.028
	Trasferte për pjesëmarrje në konferenca	605	640.630	216.170	424.460
C	Bursa për studentët	606		9.171.155	0
D	Invstime nga te ardhurat (kondic, Librat)	231	0		0
				2.964.266	
	TOTALI		230.891.007	199.209.773	31.681.234

TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

I- CIKLI I PARË I STUDIMEVE ME KOHE TË PLOTE PROGRAMI PARË

a-Viti i parë për çdo program studimi : 10.000 lek + 200 lek (takse st) = 10.200 lek

b-Viti i dytë për çdo program studimi : 10.000 lek + 200 lek (takse st) = 10.200 lek ,

Nqs mesatarja e vitit të parë është 6 apo më e lartë dhe nuk ka detyrime të prapambetura atëhere paguhet tarifa 10.000 lekë ,përndryshe paguhet tarifa 20.000 lekë.

c-Viti i tretë për çdo program studimi :10.000 lek + 1700lek (diplomë, listë notash,sup.,taksë st.) = 11.700 lek

Nqs mesatarja e vitit të dytë është 6 apo më e lartë dhe nuk ka detyrime të prapambetura atëhere paguhet tarifa 10.000 lekë ,përndryshe paguhet tarifa 20.000 lekë

CIKLI I PARË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË- PROGRAMI I DYTË

Nr .rendor	Degët	Tarifa shkollimit	Detyrime universitetit	Vlera totale
1	Degët	55,889	200	56,089
2	Histori-Gjeografi	55,889	200	56,089
3	Gjuhë – letërsi shqipe	55,889	200	56,089
4	Administrim Publik	55,889	200	56,089
5	Kontabilitet Financë	55,889	200	56,089
6	Turizëm	55,889	200	56,089
7	Mësuesi për arsimin fillor kl I -V	55,889	200	56,089
8	Mësuesi për arsimin parashkollor	67,865	200	68,065
9	Gjuhë Angleze	67,865	200	68,065
10	Histori dhe Gjuhë Italiane	67,865	200	68,065
11	Gjuhë Letërsi dhe Qytet. Grek	101,845	200	102,045
12	Teknologji Informacioni	101,845	200	102,045
13	Matematikë- Informatikë	101,845	200	102,045
14	Biologji Kimi	116,958	200	117,158
15	Infermeri e përgjithshme	116,958	200	117,158
	Programe me karakter profesional 2-vjecar			
1	Edukator për zhvillimin e femijerise se hershme 0-3 vjec	55,889	200	56,089
2	Librar dhe bibliotekar	55,889	200	56,089
3	Udherrefyes turistik	55,889	200	56,089
4	Ndihmes ekonomist	55,889	200	56,089
5	As admintrativ	55,889	200	56,089
6	Asistent menaxher ne sherbimet turistike	55,889	200	56,089

7	Edukator per zhvillimin e femijerise se hershme 0-3 vjec	55,889	200	56,089
---	--	--------	-----	--------

Nqs mesatarja e vitit të parë është 6 apo më e lartë dhe nuk ka detyrime të prapambetura atëhere paguhet tarifa e mësipërme ,përndryshe paguhet dyfishi i tarifës

II- CIKLI I DYTË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË- PROGRAMI I PARË

1- Master professional : Regjistruar për Vitin akademik 2022-2023 në vit të parë,program I parë studimi

Nr .rendo r	Deget	Tarifa shkollimit	Detyrime universiteti t	Vlera totale
1	Master Profesional ne mesuesi Arsimi Fillor	60,000	1,900	61,900
2	Master Profesional për Mësues Ndhmës në Edukimin Gjithëpërfshirës	60,000	1,900	61,900
3	Master Profesional në Kontabilitet Financë	120,000	1,900	121,900
4	Master Profesional në Administrim Publik	120,000	1,900	121,900
5	Master Profesional në Turizem	120,000	1,900	121,900
6	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Histori-Gjeografi	120,000	1,900	121,900
7	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi	120,000	1,900	121,900
8	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë Angleze	120,000	1,900	121,900
9	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë dhe Qytetërim Italian	120,000	1,900	121,900
10	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek	120,000	1,900	121,900
11	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë-Fizikë	120,000	1,900	121,900
12	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Biologji-Kimi	120,000	1,900	121,900
13	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë - Informatikë	120,000	1,900	121,900
14	Master profesionalne mesuesi për Arsimin fillor në Gjuhën Greke	60,000	1,900	61,900

15	Master profesional për shkencat infermierore	60,000	1,900	61,900
----	--	--------	-------	--------

II-CIKLI I DYTË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË- PROGRAMI I DYTË

2- Master profesional : Regjistruar për Vitin akademik 2022-2023 në vit të parë,program i dytë studimi

Nr .rendo r	Deget	Tarifa shkollimit	Detyrime universiteti	Vlera totale
1	Master Profesional ne mesuesi Arsimit Fillor	72,000	1,900	73,900
2	Master Profesional për Mësues Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës	72,000	1,900	73,900
3	Master Profesional në Kontabilitet Financë	144,000	1,900	145,900
4	Master Profesional në Administrim Publik	144,000	1,900	145,900
5	Master Profesional në Turizem	144,000	1,900	145,900
6	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Histori-Gjeografi	144,000	1,900	145,900
7	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë-Letërsi	144,000	1,900	145,900
8	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë Angleze	144,000	1,900	145,900
9	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë dhe Qytetërim Italian	144,000	1,900	145,900
10	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Gjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek	144,000	1,900	145,900
11	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë-Fizikë	144,000	1,900	145,900
12	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Biologji-Kimi	144,000	1,900	145,900
13	Master në mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë - Informatikë	144,000	1,900	145,900
14	Master profesionalne mesuesi për Arsimin fillor në Gjuhën Greke	72,000	1,900	73,900
15	Master profesional për shkencat infermierore	72,000	1,900	73,900

III-CIKLI I DYTË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË- PROGRAMI I PARË

1- Master shkencor : Regjistruar për Vitin akademik 2022-2023 ne vit te pare ,program I pare studimi

Nr .rendor	Deget	Tarifa shkollimit	Detyrime universiteti	Vlera totale
1	Master Shkencor ne Arkeologji dhe Administrim I Pasurive Arkeologjike	130,000	1,900	131,900
2	Master Shkencor në Finance kontabilitet	130,000	1,900	131,900

III-CIKLI I DYTË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË- PROGRAMI I DYTË

2- Master shkencor : Regjistruar për Vitin akademik 2022-2023 në vit të parë ,program i dytë studimi.

Nr .rendor	Deget	Tarifa shkollimit	Detyrime universitetit	Vlera totale
1	Master Shkencor ne Arkeologji dhe Administrim I Pasurive Arkeologjike	158,400	1,900	160,300
2	Master Shkencor në Finance kontabilitet	158,400	1,900	160,300

Për studentët e tjerë të rregjistruar më parë sipas viteve tarifat do te jenë ashtu si që janë miratuar më parë

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARE E BORDIT TE ADMINISTRIMIT

PROF. ASOC MERITA ISARAJ



KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR BEKTASH MEMA

